



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 18 PRILL 2013**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 18. APRILA 2013. GODINE**

**PRILL - APRIL
2013**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për organet qeveritare për Shoqërinë e informacionit,
5. Debat parlamentar lidhur me ndërmarrjen “Trepça”, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës,
6. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për shërbimin civil të Republikës së Kosovës.

Dnevni red

1. Vreme za deklarisanje izvan dnevnog reda,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodne sednice,
4. Drugo razmatranje o vladinim organima o informatičkom društvu,
5. Parlamentarna debata u vezi preduzeća “Trepča” prema zahtevu PG LDK-a,
6. Razmatranje izveštaja Komisije za obrazovanje, kulturu, omladinu, sport, javnu administraciju i medije o nadgledanju sprovođenja Zakona o civilnoj službi Republike Kosova.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

I hap punimet e mbledhjes plenre të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit me kryetarët e grupeve parlamentare.

Vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Deklarime jashtë rendit të ditës

Deputetin Bekim Haxhiu e ka fjalën.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot para jush do ta paraqes një shqetësim të shumë qytetarëve, por edhe të familjeve të Kosovës për një fenomen, i cili është në rritje e sipër - për fenomenin e vetëvrasjeve, i cili pas luftës ka dhënë shifra mjaft të mëdha të rritjes.

Sipas statistikave, prej përfundimit të luftës e deri në vitin 2013, gjithsej 731 persona në Kosovë kanë bërë vetëvrasje, ndërsa afro 2 500 sish kanë tentuar të bëjnë vetëvrasje.

Arsyet apo shkaktarët që i shtyjnë personat e ndryshëm në vetëvrasje dallojnë nga individit në individ dhe nga shkaktarët, si socialë, psikologjikë dhe të tjerë.

Për mua mbetet shqetësues edhe numri i ish-ushtarëve të UÇK-së që u vetëvranë pas luftës dhe, sipas Shoqatës së Veteranëve të UÇK-së, deri në fillim të vitit 2013 janë 26 ushtarë të UÇK-së të vetëvranë, ndërsa sipas të tjerëve ky numër është 44 sish.

Ish-luftëtarët e UÇK-së së lavdishme, që nuk u trembën në luftë, sot, në kohë paqeje, po bëjnë vetëvrasje. Ky fenomen i dhimbshëm dhe tronditës i vetëvrasjeve të ushtarëve të UÇK-së dhe qytetarëve të tjerë të Kosovës është shqetësues si dukuri dhe e kërkon një trajtim serioz institucional.

Fenomenit i vetëvrasjes pëson rritje në çdo shoqëri të dalë nga lufta. Ky fakt është vërejtur edhe te ne, edhe te vende të tjera të dala nga lufta e fundit.

Rritja e numrit të vetëvrasjeve në shoqëritë e dala nga lufta ka të bëjë me pasojat e traumave të luftës, por edhe me shkaktarë të tjerë. Në shumë vende të dala nga lufta, ky fenomen ka arritur të zvogëlohet dhe shumë raste të vetëvrasjeve të parandalohen kur personat postraumatikë janë trajtuar nga institucione shëndetësore, apo në institucione ku ofrohen shërbimet e shëndetit mendor, apo edhe në qendrat tjera të rehabilitimit. Një praktikë e tillë do të duhej të ndiqej edhe te ne.

Përfaqësuesit e Shoqatës së Veteranëve të UÇK-së kishin parashtruar një kërkesë të tillë para dy vjetësh në takim me ministrin e Shëndetësisë, por prej bisedës së para dy vjetëve, Ministria e udhëhequr nga ministri Ferid Agani nuk ka bërë asgjë për ngritjen e kësaj qendre të rehabilitimit për veteranët e UÇK-së, e cila do të mund të shfrytëzohej edhe për qytetarët tjerë.

Andaj, kërkoj nga Ministria e Shëndetësisë që të angazhohet në këtë drejtim për avancimin e shëndetit mendor në gjithë Kosovën, si dhe për ngritjen e qendrës së rehabilitimit, që është kërkesë e veteranëve të UÇK-së dhe premtim i para dy vjetësh i ministrit Ferid Agani. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Hykmete Bajrami e ka fjalën.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Lidhja Demokratike e Kosovës shpreh shqetësimin e saj rreth procesit të privatizimit të PTK-së. Shpallja e fituesit dhe aprovimi nga Qeveria për privatizimin e 75% të aksioneve të PTK-së, me të vërtetë ka ngjallur shqetësim të madh ndërmjet edhe elektoratit, por edhe të zyrtarëve të LDK-së.

Ne konsiderojmë se procesi është përcjellë me manipulime të shumta. Kemi pasur tentativa të ndryshme, shtyrje të hapjes së ofertave, të cilat kanë lënë hapësirë për të kuptuar që procesi është përcjellë me manipulime dhe pazarllëqe të shumta.

Shitja e 75% të aksioneve për vetëm 277 milionë euro është një çmim shumë i ulët, kur dihet që kjo kompani vetëm në 5 vjetët e fundit i ka sjellë shtetit 420 milionë në formë të devidentave dhe 130 milionë në formë të tatimeve.

Për më tepër, nuk dihet saktësisht se kush janë aksionarët, nuk ka strategji. Qeveria ka dështuar që t'i bindë partitë opozitare dhe publikun e gjerë se cili është qëllimi i privatizimit.

Ne kur i kemi pyetur zyrtarët e Qeverisë, ata nuk kanë asnjë përgjigje se çka do të ndodhë me 277 milionët dhe lihet të kuptohet se këta 277 milionë do të investohen në asfalt, do të investohen në vetura luksoze të qeveritarëve të kësaj Qeverie, do të investohen në karburante dhe në faturat e telefonit. Dhe, kjo me të vërtetë është për shqetësim.

Ky është aseti më i çmueshëm dhe më fitimprurës i shtetit dhe privatizimi në këtë formë është komplet i papranueshëm për Lidhjen Demokratike të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Albin Kurti, në emër të Grupit.

ALBIN KURTI: Faleminderit, kryetar!

Deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Brenda dy muajve të ardhshëm, Qeveria e Kosovës synon ta nënshkruajë kontratën me konsorciumin 'Axos Capital Partners' dhe 'Najafi Companies LLC' për, siç u tha,

shumën e ofruar të tyre prej 277 milionë eurosh. Me atë kontratë shiten 75% e aksioneve të Telekomit të Kosovës.

Federata e Sindikatës së Punëtorëve të PTK-së është kundër kësaj shitjeje. Strategjia për privatizimin e Telekomit nuk ka ardhur për miratim përfundimtar në Kuvendin e Kosovës. Kjo është në kundërshtim me Ligjin mbi ndërmarrjet publike.

Po ashtu, përveçse në Kosovë nuk ka fare ligj për privatizimin, nuk ka as ligj për privatizimin e PTK-së. Në mungesë të bazës ligjore, legjitimitetit dhe transparencës, Qeveria nëpër vite orvatej që shitjen e Telekomit ta kontrabandonte nëpërmjet Ligjit për buxhetin.

Numeracioni dhe brezi frekuencor janë çështje të sovranitetit. PTK-ja është pasuri publike fitimprurëse dhe interes strategjik kombëtar. Prandaj, çfarëdo tendence nga cilado qeveri për shitjen e aksioneve të PTK-së, do të duhej minimalisht ta nënkuptonte edhe referendumin gjithëpopullor.

Shitja e PTK-së asnjëherë nuk u argumentua nëpërmjet programit ekonomik të Qeverisë, të njohur si vizioni Banjsko. Tri argumente të tjera janë përdorur për shitjen e PTK-së: e ashtuquajtura reformë strukturore, korrupsioni e moszhvillimi në PTK dhe tërheqja e investimeve të huaja në Kosovë.

Reforma strukturore është parim ideologjik neoliberal si zëvendësim për strategjinë zhvillimore ekonomike. Pas shitjes së ndërmarrjeve shoqërore u vazhdua edhe me shitjen e atyre publike. Mirëpo, privatizimi nuk është kurrfarë parakushti për ekonominë e tregut të lirë. Edhe ndërmarrjet private, edhe ato publike, mund të konkurrojnë të ekonominë e tregut të lirë. Privatizimi nuk është parakusht për liberalizimin e tregut. Madje, në Kosovë ka ndodhur e kundërta. Si në rastin e koncesionimit të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës dhe të shitjes së Distribucionit e Furnizimit të KEK-ut, po ashtu edhe në këtë të shitjes së Telekomit, privatizimi nuk ka shënuar liberalizim të tregut por, më parë, shndërrim të monopolit publik në atë privat. Pra, privatizimi në Kosovë nuk është liberalizim i tregut, por privatizim i monopolit.

Së dyti, korrupsioni në menaxhmentin e PTK-së është dështim i Qeverisë. Prandaj, një Qeveri që s'ia del dot me korrupsionin në një ndërmarrje, aq më pak do t'ia dalë me korrupsionin me rastin e privatizimit të asaj ndërmarrjeje!

Bile, edhe më shumë se dështim i Qeverisë, korrupsioni në PTK ishte qëllim i saj. Ky kryeministër gjithmonë ka pasur për synim shitjen e PTK-së. Prandaj, ai ka pasur nevojë për korrupsionin në PTK. Korrupsioni në PTK është gjithsesi më i vogël se korrupsioni kur të privatizohet PTK-ja. Dhe, le të mos harrojmë që përkundër korrupsionit, PTK-ja ishte rregullisht fitimprurëse duke sjellë për çdo vit dhjetëra miliona euro dividendë në Buxhetin e Kosovës. Atëherë, nëse qenka konstatuar korrupsioni në PTK, le të blejmë menaxhment të ri, e le të mos shesim pasuri e zhvillim, apo jo?

Njësoj, edhe mungesa e projekteve kapitale në PTK, edhe mbipunësimi partiak, edhe keqpërdorimi i tenderëve, edhe operatorët paralelë, ose i lejonte Qeveria, ose edhe i planifikonte ato. PTK-ja nga Qeveria është trajtuar si një lopë që është mjelë pa i dhënë ushqim dhe tash po shitet nga kjo Qeveri.

Mirëpo, unë dyshoj se kjo Qeveri, jo vetëm që po e shet, por edhe po e blen Telekomin. Ose, më saktë, Qeveria e shet, disa qeveritarë dhe kryeministri e blejnë. Prandaj, së treti, ne ende nuk mund të themi se këtu bëhet fjalë për kurrfarë investimesh të huaja, përderisa nuk e dimë se të kujt janë ato 277 milionë euro. Ne duhet ta dimë përbërjen dhe prejardhjen e këtij kapitali. Kush pra e ka blerë Telekomin? Të gjithë ata që thonë se nuk ka rëndësi se të kujt janë paratë dhe cila është origjina e tyre, ose nuk shqetësohen, edhe nëse Serbia e Rusia janë blerës, ose e dinë se kush janë blerësit e vërtetë, por po i fshehin ata.

PTK-ja po copëtohet që të shiten pjesët më të mira. Telekomit t'u jepet privatëve, kurse Posta t'i mbetet shtetit. Prandaj, siç e ka thënë themeluesi i Valës, Ismeti Hamiti, kjo shitje e Telekomit të Kosovës është privatizim i profitit e nacionalizim i humbjeve. Pa çizme të regjimit, nuk mbahet dot ky shpronësim i publikut dhe kjo shpërfillje e Kuvendit, sindikatës së punëtorëve dhe qytetarëve të Kosovës.

Nënshkrimi i Thaçit në marrëveshjen me Daçiçin në Bruksel është nënshtrim politik. Nënshkrimi i Thaçit a Beqajt në kontratën për shitjen e Telekomit është nënshtrim ekonomik. Këto nënshkrime le të mbeten nënshtrime personale të tyre. Sepse, në Kosovë nuk ka vend edhe për këso qeverisje, edhe për këtë popull. Njëri duhet të shkojë. Privatizimi i pasurisë së Kosovës, i kombinuar me pazaret me kriminelët e luftës, Daçiç e Nikoliq, është hyrje e sigurt në fashizëm. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Burim Ramadani, në emër të Aleancës.

BURIM RAMADANI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuara deputete të nderuar deputetë,

Më lejoni që ta ngre shqetësimin në emër të Aleancës edhe për një aferë ose një skandal të radhës të funksionimit të Ministrisë së Punëve të Brendshme në raport me qytetarët e Kosovës dhe në raport me plotësimin e kriterëve për liberalizimin e vizave të qytetarëve të Kosovës.

Ka të bëjë me sistemin e ri të certifikatave të lindjes, të cilat janë lëshuar në qarkullim ose në funksionim në shkurt të këtij viti si sistem gjysmak, jo komplet dhe jo i përfunduar, dhe si i tillë është në kundërshtim me standardet evropiane dhe në kundërshtim me kriteret për liberalizimin e vizave.

Kjo çka po ndodh tash është vërtet shqetësuese, sepse qytetarëve të Kosovës po u kthehen këto dokumente nëpër ambasada, të cilat janë brenda zonës Shengen, dhe në të njëjtën kohë arsyja është tepër e qartë. Këto certifikata të lindjes, që tashmë janë thjesht një ekstrakt, nuk ofrojnë të dhëna të plota për qytetarin e Kosovës, përkatësisht ofrojnë të dhëna gjysmake. Nëse e doni një shembull, është tepër e qartë: nëse një femër martohet

dhe e ndërron mbiemrin, në ekstraktin që e merr tash nuk e ka mbiemrin e vajzërisë. Kjo është e dhënë gjysmë dhe si e tillë nuk pranohet prej ambasadave dhe shteteve që janë në zonën Shengen. Kjo është një shkelje e mundësisë së qytetarëve të Kosovës edhe për të marrë viza, tash me regjim të vizave, por edhe shkelje e mundësisë së qytetarët e Kosovës të udhëtojnë pa viza.

Edhe nëse Komisioni Evropian dhe vendet e zonës Shengen duan ta mbyllin njërin sy për ne dhe për shkak të punës në total që të na japin një mundësi që të kemi liberalizim të vizave, shqetësimi i tyre është tepër i qartë. Si mund të ju japim juve liberalizim të vizave, kur ju vetë po i dëmtoni, në vend se t'i plotësoni kriteret, po shkon prapa. Ç'është kjo çështje? Është tepër e çuditshme se si një sistem i certifikatës së datëlindjes lëshohet në qarkullim i papërfunduar. Njëjtë sikur modeli i lëshimit të rrugëve ose i pranimi teknik i rrugëve, pa i pasur të gjitha elementet. Kjo është e njëjta logjikë. Është tepër e qartë se ky është kthim mbrapa, është edhe një kriter shtesë vetes për çështjen e certifikatave të lindjes.

Është e patejkalueshme pyetja e qartë për ministrin: A u bë boll? A u bë boll ministër, me këtë drejtim? A u bë boll me shpenzimin e parave të taksapaguesve, duke i vendosur kriteret të reja vetes, respektivisht duke u kthyer prapa? Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Goran Marinković.

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala predsedniče!

U više navrata govorili smo, pokrenuli pitanja zakonitog rada KEK-a. Čuli smo mnoge kritike, koje smo prenosili u ime građana, koje u ovom domu predstavljamo.

Reći ću, postojimo zbog građana i analnogno tome Kosovska energetska korporacija postoji zbog korisnika, one koji mi u Parlamentu predstavljamo.

Logično pitanje, zašto stoji toliko pritužbina na rad KEK-a? Da li je to zbog toga što je KEK jedina kompanija koja ima licencu za prodaju distribuciju električne energije, i da kao kompanija neretko zloupotrebljava svoj monopolski položaj?

Ne želim da ponavljam sve ono što je na račun KEK-a, a u negativnom smislu mnogo puta ovde u ovoj Sali, i na brojnim drugim sastancima, iza sedenjima izgovorena. Pre osvrta na gorući problem, o kome ću govoriti, moram da kažem i da je neprihvatljivo mali procenat zaposlenih Srba u toj kompaniji, i da još jednom podsetim da je u toj kompaniji, to jest Elektroprivredi, do 1999. godine, je radilo oko 7000 hiljada Srba, a danas u termoelektranama "Kosova A i B" nema nijednog pripadnika moje nacije. Stoji gospodo činjenica da je na adresu potrošača stiglo obaveštenje da je došlo do promene vlasničke strukture. To je dobro i za svaku pohvalu, ali kompanija KEK za distribuciju i snabdevanje nije časila da korisnicima dostavi obaveštenja da su u obavezi da plate i izmiru sve stare dugove na svojim računima.

Ne želim da prejudiciram bilo kakvo rešenje, ali moram upozoriti da je nesvakidašnje da smo svedoci uvećenih računa za struju. Protesti građana dovoljno govori o tom problemu,

ali upravo naduvani računi mi daju za pravo da postavim pitanje, da li su obaveštenja i iznosi dugova srpskih domaćinstava i potrošača realni, ili su kao januarski računi naduvani? Želim takođe da upozorim da se takvim postupkom KEK stavi u direktnu službu podstrekivanja iseljavanja preostalih Srba, i zato, ukoliko su najavljene akcije isključenje i utuženja ne stopira, mora snositi direktnu odgovornost. Posetiću vas da stari dugovi nastali u periodu, i da su iznosi koje stoje na računima od oka ispisanih da ne odgovaraju činjeničnom stanju. U procesu potpisivanja ugovora, kako kolektivnih, tako i individualnih, dobili smo uveravanja da se naplata tih iznosa odlaže, i da će se to pitanje rešavati, za šta se lično zalažem u tehničkim pregovorima sa Beogradom.

Neprihvatljivo je da nova kompanija postavi uslov korisnicima da moraju izmiriti dugove, inače će u suprotnom korisnici biti utuženi. Pitam vas, odakle će građani da plate te iznose? Ogromna većina njih, da ne kažem 95% korisnika, od 1999. godine nije bilo zaposleno, ili je zbog poznatih dešavanja ostalo bez posla. Sporni period u kome se navodno stvorena potraživanja, mora biti, uvažene kolege, rešavan kroz pregovore i mora se staviti na sto pitanje prebijanje duga između Srbije i Kosova. Po okončanju pregovora, predlažem da se posebno...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Arben Gashi e ka fjalën.

ARBEN GASHI: Faleminderit!

E kam fjalën në emër të Grupit.

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë dola për ta trajtuar një çështje sa i përket lirisë së shprehjes dhe lirisë së medias.

Nëse shohim në retrospektivë, në vitin 2007, kur Kosova nuk ishte ende shtet formalisht i pavarur dhe kur Hashim Thaçi nuk ishte kryeministër, vendi ynë radhitej i 60-ti në indeksin e lirisë së shtypit, ranglistë kjo që përgatitet nga Reporterët pa Kufij. Sot, kur Kosova është shtet i pavarur, Hashim Thaçi kryeministër, ne jemi në vendin e 85-të, pra 25 vende më poshtë. Freedom House, organizatë amerikane që mat lirinë në botë, na rendit si vend gjysmë të lirë dhe në radhë me shumë vende tjera diktatoriale.

Organizata tjera botërore, përfshirë Reporterët pa Kufij dhe raportet e Bashkimit Evropian, tregojnë se Kosova ka probleme esenciale me lirinë e shprehjes dhe të shtypit, me liritë politike, ekonomike dhe civile.

Ajo çfarë dua të shtroj këtu si pyetje është: Kur deputetët e Kuvendit të Kosovës e kishin shpallur pavarësinë më 17 shkurt të vitit 2008, a ishin betuar për ta miratuar një Kushtetutë që do ta mishëronte zotërimin e respektimit të drejtë dhe lirive të njeriut dhe lirive themelore, ashtu siç definohet me Kartën Evropiane për të Drejtat e Njeriut?

Unë pyes, a e kanë pasur në mendje këta deputetë, kur e kanë shpallur pavarësinë, deklaratën e cilës e pati lexuar Hashim Thaçi? Pra, a e kanë pasur në mendje ata deputetë

se Kosova e vizionit të tyre do të ishte Kosova e sotme, gjysmë e lirë, gjysmë e verbëruar, pra gjysmë diktatoriale?

Ajo çfarë ka ndodhur ditëve të fundit me sulmin ndaj një kompanie mediale “Koha” dhe gazetës “Koha Ditore”, gazetës “Zëri”, është vazhdimësi e qasjes diktatoriale që ka pushteti në Kosovë ndaj medias. Të gjithë e dimë për lidhjen dashurore ndërmjet PDK-së, Qeverisë së Kosovës dhe IPKO-së. Qiradhënësi i kryeministrit, pra pronari i banesës ku jeton kryeministri është aksionar nga IPKO, i cili ka deklaruar para disa ditësh për gazetën “Jeta në Kosovë” se ai e ka mik kryeministrin dhe gjithmonë ka qenë votues i PDK-së.

Një tjetër aksionar i IPKO-së, po ashtu është mik me kryeministrin. Është bërë ambasador në Uashington nga Qeveria Thaçi. Një tjetër aksionar mund të jetë deputet, mirëpo pak ka rëndësi kjo.

Lufta që IPKO po kryen ndaj një mediumi të pavarur siç është “KohaVizion”, duke përfshirë në listën e kanalit të platformës digjitale, nuk mund të konsiderohet ndryshe, vetëm si një luftë e Qeverisë dhe e PDK-së nëpërmjet zbatimit të politikave të veta biznese kundër lirisë së shtypit në Kosovë.

Kur IPKO-ja, e cila pothuaj se ka kryer monopol në ofrimin e shërbimeve kabllore, e ka vënë KTV-së këtë pozicion, paramendo se çka mund t’i ndodhë një qytetari...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Regjia, në emër të Grupit është!

ARBEN GASHI: A do të guxojë një qytetar i Kosovës të kundërshtojë? A do të guxojë të flasë? Çka do të ndodhë kur t’i ndalet rryma, uji apo tjera?

IPKO, nëpërmjet këtij veprimi kundër KTV-së, ka bërë sulm, jo vetëm ndaj lirisë së medieve, por ka bërë sulm ndaj Kosovës, ndaj vlerave themelore që e përcaktojnë këtë vend. Ajo e ka sulmuar lirinë e vendit.

Është obligim yni, ashtu siç është edhe obligim i IPKO-së, edhe i të gjitha kompanive që përdorin resurse kombëtare, që në këtë rast është resursi i transmetimit digjital, që urgjentisht ta zbatojnë kërkesën e Komisionit të Pavarur për Media për ta rikthyer “KohaVizionin” në vendin ku e meriton në platformë.

Të mos harrojmë se këtë Komision të Pavarur të Medieve e kemi krijuar ne si Kuvend dhe ne do të duhej të merrnim përsipër, të siguronim se vendimet e tij do të zbatohen.

Pse po sulmohet “Koha Ditore”, pse po sulmohet “Zëri”? Sepse, kanë mbetur zërat e vetëm të një gazetarie të pavarur, shpresa e vetme për rilindje morale në këtë vend të zhytur në krim dhe në depresion.

Prandaj, kërkoj nga Qeveria dhe PDK-ja..., t'i mbajnë duart larg lirisë së shtypit, "KohaVizionit", gazetës "Koha Ditore", "Zëri" dhe të gjitha medieve tjera.

Me gjithë të mirat dhe mangësitë që mund t'i kenë, janë ndër institucionet e pakta të mbetura të cilat kanë kredibilitet moral në këtë vend. Sidomos "Koha Ditore" dhe "KohaVizion" janë një institucion tashmë tradicional i Kosovës. Sulmi ndaj "Kohës" është sulm ndaj lirisë së shprehjes në Kosovë, është sulm ndaj Kosovës, pavarësisë së Kosovës. Nuk ka kuptim as pavarësia pa pavarësinë e medieve, si "Koha", "Zëri" dhe mediet tjera. Ata që frikësohen, ata që shantazhojnë, ata që penalizojnë, vetëm përpiqen ta tregojnë fytyrën e vërtetë, duke eliminuar mundësinë e deklarimit të vërtetës në Kosovë. Faleminderit!

KRYETARI: Nënkryetari Glauk Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Negociatat me Serbinë po përshkallëzohen gjithnjë e më tepër. Pas paralajmërimeve të javës së kaluar të kryeministrit se nuk do të ketë më negociata me Serbinë, sepse ajo e refuzoi marrëveshjen, para dy ditësh sërish u vendos shpejt e shpejt për një tjetër rund negociatash. Ky rund i negociatave u mbajt pa u informuar Kuvendi i Republikës së Kosovës për takimin e kaluar.

Një gjë është bërë tashmë krejt e qartë. Këto shtyrje të afateve dhe runde të vazhdueshme të negociatave po bëhen për hir të Serbisë. Po të kishte qenë puna që Serbia të vendosej para një marrëveshjeje përfundimtare dhe të pandryshueshme, atëherë negociatat me siguri që do të kishin përfunduar në rundin e tetë. Por, pikërisht ngaqë u mbajt rundi i nëntë, kurse Serbia ende nuk po e pranon marrëveshjen, kjo do të thotë se Kosova është ajo e cila shumë më shumë po i afrohet Serbisë, sesa anasjelltas.

Kryeministri ka thënë që deri më tash tri herë e kemi pranuar marrëveshjen. Kjo është shumë shqetësuese, sepse me siguri këtu nuk kemi të bëjmë me një marrëveshje që është tekstualisht e njëjta, por me drafte të marrëveshjeve, ku secila është e ndryshme prej asaj të mëparshmes. Pra, marrëveshjet vazhdimisht po ndryshojnë. Serbia vazhdimisht po kërkon më tepër, kryeministri Thaçi secilën prej tyre po e pranon, dhe kjo me siguri që duhet të jetë shqetësuese.

Tash, pasi Serbia nuk e pranoi as draftin përfundimtar, do të thotë asaj do t'i ofrohen edhe më shumë koncesione të tjera, kurse kryeministrin tonë e kemi atje që ta pranojë çdo draft.

Dhe, Serbia u relaksua edhe më shumë kur një diplomat i lartë ndërkombëtar e lëshoi deklaratën se Serbisë do t'i jepet fillimi i negociatave me Bashkimin Evropian, edhe nëse nuk nënshkruhet marrëveshja. Kjo e ka krijuar komoditetin edhe më të madh te Serbia për të kërkuar edhe më shumë, dhe ne po përfundojmë njëjtë sikur me logjikën e Planit të Ahtisarit, kur ne e pranojmë marrëveshjen, e cila edhe ashtu është e dëmshme për një pjesë të territorit të Kosovës, Serbia nuk e pranon; ne fillojmë ta implementojmë njëanshëm, dhe kur vjen deri te puna kur has sharra në gozhdë, siç thonë, atëherë

organizohen runde të tjera të negociatave për t'ia plotësuar edhe më shumë apetitet Serbisë.

Për shkak se ky proces i negociatave me Serbinë u karakterizua nga një mostransparencë e pashembullt, për shembull nuk i kemi pasur transkriptet, nuk i kemi pasur zbardhjen e bisedave disaorëshe, nuk i kemi draftet e këtyre marrëveshjeve, të cilat po pranohen njëra pas tjetrës, si dhe është karakterizuar nga një anashkalim i Kuvendit të Republikës së Kosovës...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Teuta Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Jemi në përvjetorin e 14-të përkujtimit të të gjitha masakrave në Kosovë, të kryera nga forcat serbe ndaj popullatës së pambrojtur shqiptare. Për më tepër, këto masakra kanë rezultuar edhe me zhdukje të njerëzve të gjallë, si dhe me zhdukjen e kufomave. Të gjithë jemi dëshmitarë të atij ankthi që përjetuan familjarët tanë, duke i kërkuar pareshtur më të dashurit e tyre. Ç'është e vërteta, ende edhe sot e kësaj dite nuk janë gjetur kufomat, ndërsa adresa dihet, por presioni duket të mos jetë i madh dhe aq i madh për t'i hulumtuar varrezat dhe për t'i gjetur kufoma tjera.

Konsideroj se për asnjë çast nuk duhet të lirohemi nga ky obligim yni njerëzor, qytetar dhe mbi të gjitha institucional.

Jemi në prag të datës 27 prill, e cila me vendimin e Kuvendit të Kosovës është shpallur Dita e të Zhdukurve të Kosovës, kur në emër të masakrës së Mejës e Korenicës kujtohen të gjithë të zhdukurit e Kosovës.

Lëndina e Lotëve në Meje është vendi ku çdo vit mbledhen familjarët e Kosovës me lot për faqe e halle plot, për ta gjetur forcën të njëri-tjetri për ta mbuluar dhimbjen që mbytet zemrat e tyre.

Unë vij nga ajo zonë, pra nga zona e Rekës së Keqe të Gjakovës, dhe nga ato familje që kemi përjetuar vuajtje të mëdha. Në secilin fshat të Rekës së Keqe ka të vrarë në masë, ka dëshmorë e martirë, në secilin fshat familjarët janë detyruar të ngrenë pllaka përkujtimore me xhepin e tyre të varfër dhe që të mos parcializohet numri i tyre, po kjo Meja, ku edhe kujtohen të gjithë të zhdukurit, ka nevojë për ngritjen e një kompleksi memorial. Kjo ditë e përbashkët e Kosovës për më shumë vite po mbahet nën patronatin e kryeministrit të vendit, dhe vetë kryeministri ka premtuar para masës se aty do të ngrihet një memorial historik, edhe për ta zbutur dhimbjen e familjarëve, edhe për ta shkruar kujtesën tonë historike, kurse premtimi kanë mbetur vetëm në fjalë.

Komuna e Gjakovës deri më tani e ka ndarë lokacionin, e ka përzgjedhur kompaninë dhe punimet po vazhdojnë. Dihet mundësia e komunave dhe buxheti i tyre, edhe pse vullneti për ta ngritur këtë memorial përkujtimor nuk ka munguar asnjëherë nga zyrtarët e saj.

Qeveria e Kosovës është e ftuar edhe kësaj radhe që të marrë pjesë në përvjetorin e 27 Prillit. Dhe, unë e pyes Qeverinë se çfarë do t'u thotë familjarëve atë ditë? Sa mirë do të ishte që Qeveria e Kosovës atë ditë të falënderohet nga familjarët për faktin se ata bënë diçka për ta, sepse familjarët dhanë shumë për lirinë e Kosovës.

Në Meje të Korenicës, më 27 prill të vitit 1999, janë rrëmbyer 376 shqiptarë të moshave...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Deputetja Afërdita Berisha-Shaqiri e ka fjalën.

AFËRDITA BERISHA-SHAQIRI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar qytetarë,

Vitin e kaluar, në fshatin Restelicë, komuna e Dragashit, pati ndodhur një fatkeqësi natyrore, me ç'rast e humbën jetën disa qytetarë. Përveç viktimave, kishte dhe shkatërrime, tri shtëpi plotësisht, dhe disa të tjera ishin shkatërruar në masë të madhe.

Në atë kohë, Qeveria e Kosovës kishte premtuar rindërtimin e shtëpive, si dhe vendosjen e pengesave që do t'i mbronin rrëshqitjet eventuale të borës gjatë stinës së dimrit.

Në këto zona të tilla malore të Sharrit, dimri shpeshherë mund të bëhet i ftohtë dhe me acar. Fatmirësisht, këtë vit, moti ka qenë më i butë, mirëpo nuk do të dimë se si do të jetë viteve të tjera. Prandaj, premtimet nuk duhet harruar dhe për këta banorë të përvuajtur të këtij fshati, posaçërisht për familjet e goditura.

Bile këta qytetarë, të frikësuar nga ajo që kishte ndodhur një vit më parë, kishin vendosur që vetë t'i vinin pengesat me mjetet e tyre.

Ajo çka unë dua të paraqes në këtë seancë është se këta qytetarë e kanë edhe një hall tjetër. Pos shumë e shumë halleve të tjerave, dëshirojnë të kenë informatë si qëndron gjendja në vendkalimin kufitar të fshatrave Restelicë, Krushë, Zlipotok, Brod, të cilat kanë pasur vendkalim në Strizemir, ku lidheshin me fshatrat e Maqedonisë, me qytetet Dibër dhe Tetovë.

Sipas fshatarëve, ky vendkalim do të ndikonte, pos tjerash, edhe në rritjen e sigurisë, ngase kohë pas kohe këtyre qytetarëve u vidhen bagëtitë, e me rritjen e frekuentimit të qytetarëve, do të rritej edhe siguria. Më parë ka pasur lëvizje të lirë të këtyre qytetarëve. Ata kolonin me letërnjoftim.

Shpresoj se Qeveria do të ketë parasysh dhe do t'i ndërmarrë hapat e duhur në këtë drejtim. Faleminderit!

KRYETARI: Dhe, deputetja e fundit për sot, Alma Lama e ka fjalën.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputete

Në datat 15 dhe 16 prill, në mënyrë simbolike, Kosova dhe Shqipëria përkujtojnë atë që mediet ndërkombëtare atëherë e patën quajtur eksod biblik.

Ishte momenti kur Serbia në '99-tën filloi ta zbatonte operacionin "Patkoi", kur ushtarët dhe paramilitarët serbë filluan t'i dëbonin me dhunë shqiptarët nga shtëpitë e tyre, në mënyrë që ta zbraznin Kosovën.

Rreth 1 milion shqiptarë u dëbuan nga shtëpitë e tyre dhe u nisën në dëshpërim të plotë rreth kufirit me Shqipërinë. Kalvari i vuajtjeve të tyre nuk do të merrte fund edhe për disa muaj, derisa Kosova të çlirohej, mirëpo ajo çfarë ndodhi ishte më shumë se historike për të gjithë ne. Shqiptarët e Kosovës, sapo e kaluan kufirin, gjetën atë që u kishte munguar për një shekull, gjetën njëri-tjetrin, gjetën mikpritje dhe bujari. Shqiptarët e Shqipërisë në Kukës dhe të gjitha rrethet e tjera hapën shtëpitë dhe zemrat e tyre, edhe pse në kushte të një varfërie të madhe. Tragjedia, moti, dhimbja ishte e përbashkët.

Ndarja 100-vjeçare nuk kishte mundur ta zbehte forcën që e mban të bashkuar një komb, e që është lidhja shpirtërore.

Natyrisht, mikpritja, bujaria dhe solidariteti njerëzor nuk janë as një e dhënë natyrore, e as e garantuar. Këto janë ndjenja dhe virtyte, të cilat kultivohen nga njeriu, kultivohen me vetëdije të plotë, derisa ato bëhen pjesë e kulturës. Çdo komb i qytetëruar përpiqet t'i kultivojë ndjenjat më të mira të natyrës njerëzore, t'i mirëmbajë ato.

E një nga këto ndjenja është edhe mirënjohja, mirënjohja për atë që ta shtrin dorën në ditët tua më të vështira, ashtu si shqiptarët e Shqipërisë ua shtrinë dorën shqiptarëve të Kosovës në ato ditë zie. E unë jam e bindur se në të njëjtën mënyrë do të kishin vepruar edhe shqiptarët e Kosovës në një situatë të ngjashme.

Natyrisht, gjatë gjithë këtyre viteve, kur ne u njohëm dhe larguam barrierat që regjimet na kishin vënë ndërmjet për të na ndarë, e kultivua këtë ndjenjë, mirëpo më shumë në mënyrë individuale. Unë mendoj se ka ardhur koha që tani pas 14 vjetësh, kjo ndjenjë të kultivohet edhe në mënyrë institucionale. Kosova i ka institucionet e saj të lira e të pavarura dhe ky Kuvend vetëm gjatë këtij mandati ka mbajtur disa seanca solemne për momentet më të rëndësishme të historisë.

Prandaj, unë do të kërkoja sot nga kryetari i Kuvendit që të organizojë një seance solemne për ta përkujtuar eksodin e përmasave biblike të pranverës së vitit 1999 dhe mirëpritjen shqiptare që e mrekulloi botën. Faleminderit!

KRYETARI: Me këtë është harxhuar koha për deklarime jashtë rendit të ditës. Fjalën e ka kërkuar ministri Besim Beqaj.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit!

I nderuar kryetar,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Unë dua t'i falënderoj deputetët që ma dhanë edhe një herë mundësinë ta shpjegoj procesin e privatizimit të Postës dhe Telekomit të Kosovës. Të flasim këtu vetëm për privatizimin e Telekomit dhe Valës, e jo Postës së Kosovës, siç po referohet shumë herë.

Dua të shpjegoj që ky privatizim është bërë me vendim të Kuvendit të Republikës së Kosovës, në harmoni me parimet kushtetuese dhe ligjore të Republikës së Kosovës, me një transparencë të plotë, me një proces i cili ka kaluar nëpër shumë filtra të marrjes së vendimeve me ekspertë nga niveli vendor dhe ai ndërkombëtar, me kompani të nivelit ndërkombëtar, të cilat kanë qenë këshilltarë ligjorë dhe këshilltarë të transaksionit, të cilët janë verifikuar në nivel edhe të kompanive që jashtëzakonisht kanë reputacion ndërkombëtarë, siç janë Hante End Wiliams, Lasard Reifeisen. Të gjithë janë ata të cilët kanë siguruar që ky proces të bëhet në bazë të parimeve dhe në bazën ligjore, por edhe në bazën e transparencës së plotë me standarde më të larta ndërkombëtare.

Procesi i privatizimit është udhëhequr nga një grup i ministrave, pra ka qenë Komisioni qeveritar për privatizim, me autorizim të Qeverisë për të proceduar dhe, sipas këtij vendimi, ne kemi ardhur deri në përfundimin e këtij procesi.

Dua të them që procesi i privatizimit, për të sqaruar për qytetarët e Republikës së Kosovës, është një proces, i cili më herët e ka ndarë Postën e Kosovës nga shërbimet e Telekomit dhe të Valës. Është proces i privatizimit të shërbimeve, e jo i asetëve fizike, të cilat i kanë pasur këto kompani të përbashkëta dhe të gjitha asetet fizike, pra përfshirë të gjitha ndërtesat janë pronë e Postës së Kosovës, një ndërmarrje kjo publike, e cila është e qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe për këto asete, privatizuesi do të bëjë pagesë deri në 10 milionë euro, dhe për shërbimet të cilat i ka, në formë të qirasë. Pra, flasim për asetet fizike, të cilat i kanë mbetur Postës së Kosovës, ndërmarrje e cila është në pronësi, dhe për të eliminuar subvencionimin e shërbimeve postare të Republikës së Kosovës është siguruar buxhet nga privatizuesi për 10 milionë euro në bazë vjetore, në mënyrë që kjo të funksionojë pa asnjë lloj problemi.

Dua ta them edhe një çështje tjetër se procesi i privatizimit ka pasur në dijeni dhe ka marrë në shqyrtim jashtëzakonisht serioz çështjen e punëtorëve të Postë-Telekomit dhe këta punëtorë janë të siguruar për kontrata trevjeçare dhe ato kontrata, të cilat kanë qenë afatshkurtra, do të transferohen për 3 vjet. Pra, askush nuk ka nevojë të ndihet, as i kërcënuar për eliminimin e vendit të punës së tij, por për më shumë edhe kontratat afatshkurtra janë transferuar kontrata 3-vjeçare dhe të gjitha kontratat afatgjata janë kontrata të cilat transferohen në bazë të Ligjit të punës, që nënkupton transferohen si

kontrata afatgjata edhe askush nuk ka mundësi ta eliminojë dikë nga puna, ta largojë dikë nga puna pa i respektuar këto rregulla të caktuara.

Kompanitë, të cilat kanë aplikuar në proces, ka qenë një proces në nivel ndërkombëtarë, i kemi pas 5 sosh të parakualifikuara, të cilat i kanë plotësuar kriteret e përcaktuara sipas ligjeve dhe sipas procedurave, të cilat janë plotësuar.

Sigurisht këto kompani, të cilat kanë pasur për obligim t'i ofrojnë dëshmitë, që janë parakualifikuar sipas procedurave, ato janë dëshmi evidente, të verifikuara edhe në nivele ndërkombëtare, edhe nga Banka Ndërkombëtare, të cilat japin garanci për realizimin e kësaj kontrate. Dhe dua të them që për kontraktuesit, në këtë rast për privatizuesin, faza e parë, e cila duhet të jetë mbyllja komerciale, është garancia bankare 3 milionë dhe kjo garanci bankare do të tërhiqet, nëse kompania nuk i plotëson kushtet e dorëzuara sipas procesit të parakualifikimit dhe mjeteve, të cilat është dashur të ngrihen.

Ndërsa nga momenti i nënshkrimit të kontratës deri në dorëzimin e kompanisë, pra deri në pagesën e parë të garancisë bankare, të cilën këto kompani e kanë ofruar, është 10 milionë euro, dhe ne kemi kërkuar. Në rast se kompania nuk ka fuqi financiare për ta bërë një pagesë të tillë, atëherë do t'i merret bondi, apo garancia bankare për 10 milionë eurosh.

Flasim për kompani, të cilat janë përcjellë edhe nga qeveritë e tyre, janë përcjellë edhe nga mekanizma të ndryshëm ndërkombëtarë. Prandaj, ky është realiteti, fituese është 'Axos Capital Partners' me parterët e vet, në bashkëpunim me 'Najafi Companies LLC' nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe e përkrahur teknikisht nga "British Telekom" nga Britania e Madhe, nëpërmjet kësaj.

Dua të them edhe një herë që BERZH-i, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, dhe IFC, pra Korporata Ndërkombëtare për Financim, pjesë e Bankës Botërore, janë në proces të negocimit me këto kompani për të bërë përkrahjen financiare të tyre, sepse i kanë dy muaj hapësirë për ta bërë një proces të tillë.

Ajo çka është jashtëzakonisht e rëndësishme është se ne kemi hyrë në një proces, në të cilin e kemi një partneritet strategjik me vendet, me resurset strategjike, por me partnerë strategjikë. Ata të cilët në çdo moment kanë përkrahur dhe mendoj që kjo ka qenë një detyrë e mirë e shtëpisë e bërë nga kompanitë, të cilat janë treguar si fituese dhe vlen të theksohet që në takimin e ministrit Hoxhaj është vlerësuar me potencial se Kosova po bëhet vend atraktiv për investime të huaja, posaçërisht nga vendet e Bashkimit Evropian.

Në këtë Kuvend është debatuar disa herë, në këtë Kuvend është marrë vendimi, në këtë Kuvend është sjellë një mocion, i iniciuar nga sindikalistët dhe ky mocion ka treguar edhe një herë që Kuvendi e ka dhënë konfirmimin e këtij procesi të privatizimit. Para një jave, 10 ditëve, është bërë edhe një debat tjetër për zhvillimin ekonomik. Janë afuar disa rekomandime dhe në ato rekomandime ka qenë edhe ndalimi i procesit të privatizimit dhe Kuvendi pra pë e ka dhënë vizën.

Prandaj, të nderuar qytetarë, ky është procesi, kjo është demokracia parlamentare dhe ne jemi të interesuar që, konform vendimeve të Kuvendit, transparencës së plotë, respektimit të Kushtetutës, respektimit të ligjeve dhe ekonomisë së tregut të vazhdojmë përpara, sepse në këtë formë krijojmë një mirëqenie afatgjatë për qytetarët e Republikës së Kosovës.

U përmend këtu edhe një herë çështja e privatizimit të Distribucionit. Është diskutuar shumë atë ditë në debatin për zhvillim ekonomik dhe dua të theksoj, sepse është kërkuar shpjegim për ato shkrime nëpër media, që procesi ka qenë jotransparent, sepse kemi konfirmim nga mekanizmat ndërkombëtarë.

Të nderuar deputetë,
Të nderuar qytetarë,

Kush dëshiron ta lexojë raportin e Ombduspersonit IFC-së, e ka në ueb-faqen e Ombduspersonit. Ky dokument është bërë zyrtar dhe dokument, i cili edhe një herë konfirmon që çdo procedurë ka qenë në harmoni me ligjet, me transparencën më të lartë ndërkombëtare dhe këtë dokument mund ta shihni edhe ju bëj thirrje të mos hedhim dilema te qytetarët me gjëra të cilat janë të pavërteta dhe të cilat nuk janë të konfirmuara. Pra, IFC-ia dhe Ombduspersonit i IFC-së, i cili ka pas për detyrë për ta audituar punën e IFC-së në Republikën e Kosovës, e ka konfirmuar dhe mund të gjeni në ueb-faqen e saj. Ministria e Zhvillimit Ekonomik e ka lëshuar edhe një deklaratë për shtyp, me të cilën çdo proces është bërë në harmoni me standardet më të larta ndërkombëtare.

Sa u përket borxheve të vjetra, të cilat u ngrehën nga deputeti Marinković, dua të them që Qeveria e Republikës së Kosovës e ka bërë një padi në nivel ndërkombëtar për ndërhyrjet energjetike të Republikës së Serbisë në Kosovë dhe është zgjedhur në favor dhe është konsideruar që i vetmi operator në Republikën e Kosovës është KOST-i, prandaj me këtë kontekst ne do ta trajtojmë. Kosova është një territor energjetik dhe si i tillë do të mbetet.

Ndërsa sa u përket borxheve, ne nuk do të bëjmë ndarjen e borxheve në baza etnike. Të gjitha borxhet e vjetra duhet të paguhën nga qytetarët, sepse ky është obligim qytetarë. Faleminderit!

KRYETARI: Albin Kurti e ka fjalën.

ALBIN KURTI: Faleminderit, kryetar!

Së pari, më 28 korrik të vitit 2010, Qeveria e Kosovës asokohe i ka përfshirë rekomandimet e Kuvendit në strategjinë për privatizimin e PTK-së. Në shtator të vitit 2010 e ka sjellë në Kuvend, mirëpo strategjia përfundimtare nuk është aprovuar asnjëherë për shkak se është shpërbërë Kuvendi dhe kemi shkuar në zgjedhje të jashtëzakonshme.

Tjetra? Shtrohet pyetja: I kujt është kapitali dhe cila është prejardhja e tij? Të kujt janë, ministër, këta 227 milionë euro? Dhe, korporatat e specializuara në lëmin e telekomunikacionit, u tërhoqën. Kemi përfunduar me fond investiv. Kjo që në mënyrë të popullarizuar po quhet AKSOS, për gjithë këtë konsorcium, këta janë menaxhues të

fondeve të të tjerëve. Kush janë ata të tjerë që e kanë grumbulluar këtë kapital 277 milionë euro dhe po e blejnë nëpërmjet jush PTK-në?

Tjetra? Ne nuk ju besojmë juve. Cila është lista e gjërave që janë shitur me rastin e privatizimit të 75% të aksioneve të Telekomit? Po ashtu, cila është lista e aseteve që janë shitur me rastin e privatizimit të Distribucionit dhe Shpërndarjes së KEK-ut? Asnjëherë nuk keni treguar çka u shit. Dhe, së fundi në këtë, përveç juve vetë dhe kryeministrit që jeni të përzier në këtë shpëlarje të shekullit, për bindjen tim, këtu janë edhe 'zhugollët', ata që ju financojnë juve si PDK, janë edhe lojërat e fatit, e ka edhe biznese të politikanëve që nuk janë në pozitë.

KRYETARI: Urdhëro, ministër, përgjigju!

MINISTRI BESIM BEQAJ: I nderuar deputet Kurti,

Kuvendi është shtëpia e popullit, vend i sovranit i cili merr vendime, dhe nuk merr vendime në baza të preferencave individuale, qoftë të një partie politike, e cila vendin në Parlament e ka konform fuqisë së votuesve të cilët e kanë besuar këtë parti: Prandaj, ju nuk keni nevojë të na besoni neve. Ne kemi nevojë të na besojë populli, i cili me votën e vet ka treguar se fuqia parlamentare e vendos çfarëdo lloj vendimi në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Prandaj, ne nuk punojmë për të na besuar ju, por punojmë për të na votuar dhe për të na besuar qytetarët e Republikës së Kosovës për të mirën e tyre, sepse ata e kanë dhënë verdiktin e vet sa i përket kësaj çështjeje.

Lidhur me vendimet e Kuvendit, po e them edhe një herë, demokracia parlamentare tregon që vendimet merren me shumicë. Ky proces është sjellë shumë herë dhe nëse dikush ka çfarëdo lloj dileme lidhur me ligjshmërinë, lidhur me lidhjen e dikujt në baza të hipotezave të rrugëve, të diskutimeve, të cilat bëhen nëpër kafene të ndryshme, ju lutem, janë organet e drejtësisë dhe ju si grup parlamentar mund ta ngrini këtë çështje dhe të pyetni në nivel çfarë të doni, kushtetues, për ligjshmërinë e këtij vendimi. Prandaj, nuk është mirë të humbni këtu kohë. Nëse keni argumente që ky është jo ligjshëm, urdhëroni. E keni rrugën, nëse keni argumente që dikush është i inkriminuar, por mos u merrni me çështje të rrugëve dhe çështjet e kafeneve, sepse nuk është në të mirën e popullit. Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, unë e kam vetëm një pyetje: Mbi bazën e cilit vendim të Kuvendit është bërë ky privatizim? Është mirë t'i sqaroni edhe deputetët, edhe opinionin, mbi bazën e cilit vendim dhe kur është marrë ai vendim? Është mirë të thuhet. Të ceket data e saktë?

MINISTRI BESIM BEQAJ: I nderuar kryetar i Parlamentit!

Vendimi është marrë. Nuk mund të flas me datë për shkak se nuk jam për t'u marrë me datat e vendimeve të Kuvendit. Është një vendim në Qeverinë paraprake, por, ju lutem - në vitin 2011, në buxhetin dhe në Ligjin për buxhet është vendosur neni 4, i cili thirret në Ligjin mbi ndërmarrjet publike dhe i cili thotë që privatizimi i PTK-së bëhet në bazë të Ligjit për ndërmarrjet publike, neni 19, dhe në shtesë thotë: "Konsiderohet si i aprovuar".

Ky Kuvend e ka aprovuar atë ligj, prandaj, nëse dikush ka dilemë për ligjshmërinë, qoftë kryetari, qoftë çfarëdo deputeti, urdhëroni procedoni, jeni deputetë dhe keni të drejtë në çdo kohë ta sillni edhe një herë dhe ne jemi të kënaqur nëse e sillni edhe një herë, edhe debatin për procesin e privatizimit, edhe për ligjshmërinë, edhe për të gjitha. Urdhëroni, ju e keni rrugën për të qenë. Është një vendim, i cili është marrë mbi vendimet e Qeverisë, vendim që është marrë nga Kuvendi dhe ky është proces plotësisht transparent, i cili u hap rrugë zhvillimeve dhe unë besoj se shqetësimet janë për ata të cilët nuk dëshirojnë që Kosovën ta shohin të zhvilluar dhe duke ecur përpara. Faleminderit!

KRYETARI: Ministër! Nuk është viti 2012. Është miratimi i buxhetit të vitit 2011, jo 2012. Më fal, kur ta kryejë unë mund ta merrni fjalën. Është buxheti i vitit 2011, nenin 4, dhe Ligji i buxhetit i vitit 2011 e ka pasur afatin e vet deri më 31 dhjetor 2011. Më 31 dhjetor 2011, këtij ligji i ka skaduar mandati dhe ka ardhur ligj i ri. Prandaj, është mirë të sqarohet më mirë opinioni se atij vendimi, që ka qenë i vendosur në nenin 4 të Ligjit për buxhetin e vitit 2011 i ka skaduar mandati dhe unë nuk e di që Kuvendi ka marrë vendim tjetër.

(Reagime)

Unë e krena. Kush e do fjalën, e kërkon. Urdhëro, ministër, e ke fjalën.

MINISTRI BESIM BEQAJ: I nderuar kryetar!

Qeveria disa herë i është përgjigjur ftesës së Kuvendit për të debatuar për këtë proces. Janë sjellë mocione për këtë proces dhe unë nuk e di në çfarë baze ligjore atëherë Kuvendi ka diskutuar dhe ka vendosur për mocionin nëse nuk ka pasur bazë ligjore, pra ka bërë shkelje edhe të ligjit për të debatuar për diçka që është jo ligjore, por edhe një herë i thërras të gjithë ata që kanë dilemë për ligjshmërinë e kësaj, janë rrugët ligjore dhe mund të kontestohet. Prandaj, urdhëroni kontestojeni në baza ligjore dhe normalisht ne jemi të obliguar për t'i respektuar vendimet e Kuvendit dhe vendimet të cilat dalin nga organet e drejtësisë. Faleminderit!

KRYETARI: Kryetari i Grupit Parlamentar të LDK-së, Ismet Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Si duket, ky ministër nuk i di rregullat. E para, ky nuk mund të na tregojë për çka mund të debatojë Parlamenti, e çka jo. Edhe disa vota që po i përmend, dihet si janë marrë. Prandaj, mos na shpjego për demokracinë, dhe kush kë e ka votuar, se e dimë çka ka ndodhur në zgjedhjet e fundit, e para.

E dyta, në vitin 2010, zoti ministër, është refuzuar privatizimi dhe për shkak të kësaj, ju, në mënyrë klandestine, e keni futur në buxhetin që e tha kryetari, në nenin 4, privatizimin në Buxhet të Kosovës dhe në këtë mënyrë realisht e keni kontrabanduar një proces, të cilit po ashtu i ka dalë afati. Është e vërtetë kjo, prandaj mos spekuloni. Le ta dinë qytetarët se po flisni gjëra të pavërteta. Asnjëherë ky Kuvend nuk ka marrë vendim për privatizimin e PTK-së.

Pastaj, ju e dini që kontratat e rëndësisë së tillë kërkojnë edhe votime edhe me 2/3. Juve nuk ju intereson kjo, sepse ju e dini që e vetmja gjë që ju intereson është të shitni sa të mundeni e kujt të mundeni, pa procedura të mirëfillta, e pa transparencë. Ty po të kërkohet hapur të na tregosh çka është shitur. Çka është shitur edhe te Distribucioni? Ti nuk e ke asnjë mundësi, në të vërtetë nuk ke vullnet dhe dëshirë t'i bësh transparente këto. Ky Kuvend ka të drejtë të dijë çka është shitur edhe te Distribucioni, çka po shitet në këtë rast edhe te Posta. çka po i fshihni?

Prandaj, kjo është normale, se ky Kuvend ka të drejtë t'i dijë këto gjëra dhe mos u hidhni pluhur syve qytetarëve, sepse këto gjëra nuk ju shiten. Ju shiteni atë që po mund ta shitni, por këtu nuk mund t'ua shitni si të vërteta qytetarëve, sepse po i fshihni gjërat. Bëjuni transparentë! Nëse është çdo gjë e keqe që e thoni ju, le të jetë transparente. Pse e gjithë kjo frikë? Dhe, mos harroni, debati për zhvillimin ekonomik, rezultati ka qenë 38:38. Shumë madhore është domethënë kjo. Çfarë fitimi i madh që ka qenë ky rezultat dhe ti e paske marrë lejen, në bazë të kësaj, që të privatizohet PTK-ja!

Mos, sepse në këtë mënyrë jeni duke i bërë dëm vendit, e dëmet më të mëdha po i bëni edhe me këto fjalë tash që po mundoheni t'i thoni e që nuk qëndrojnë fare. Mos flitni të pavërteta!

KRYETARI: Adem Grabovci e ka fjalën.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Është e vërtetë se Parlamenti di çka të diskutojë, por është shumë e vërtetë se nga këtu, ne si parlamentarë, kemi kërkuar që ta ruajmë pavarësinë e institucioneve të caktuara dhe është një e vërtetë e pamohueshme se Parlamenti, apo foltorja e Parlamentit, është shndërruar në prokurori, në gjykatore, dhe mbi bazën e shpifjeve, të trillimeve e keqpërdorimeve për interesa të caktuara të individëve të caktuar dhe krejt ky qëllim për ta bllokuar zhvillimin e vendit, apo ecjen e vendit përpara.

Ju lutem, unë me sa e kuptova ministrin, por edhe në shumë debate, e ka bërë shumë të qartë se çka është shitur në PTK. Nuk janë shitur asnjë prej asetëve. Është shitur thjeshtë biznesi i operimit. Është shitur edhe infrastruktura përcjellëse. Objektet, të gjitha janë pronë e Postë-Telekomit të Kosovës, që është një kënaqësi shumë e madhe.

Së dyti, përveç çmimit të ofruar, ne e kemi vlerësua dhe e vlerësojmë si fitore shumë të madhe, se është dërguar një mesazh shumë i qartë - në përbërje të këtij konsorciumi janë përfaqësuesit e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, pra biznesi amerikan, anglez dhe gjerman. Ata të cilët mendojnë që do ta zhvillojnë vendin, do të ndërtojnë shtet, duke u mbështetur në forcat e veta, le të pajtohen se ka perënduar ajo kohë njëherë e përgjithmonë, se nuk kemi pasur mundësi. Ne me miq kemi ardhur deri këtu, me miq do të vazhdojmë tutje, do ta fuqizojmë këtë shtet dhe do ta zhvillojmë këtë shtet. Se sa ka bërë Qeveria e Republikës së Kosovës, dëshmia më e mirë janë vlerësimet që japin qytetarët e Kosovës, sepse ato të arritura, ato vepra të krijuara, ata po i jetojnë, po i shfrytëzojnë çdo ditë, çdo sekondë të jetës së tyre.

Ndryshimet pozitive që kanë ndodhur në vendin tonë prej vitit 2007 e këndeje janë evidente dhe të pakontestueshme. Fatbardhësisht, shumica e qytetarëve mendojnë kështu.

Dhe, sa i përket vendimit të Kuvendit, është përfshirë në Buxhetin e Kosovës, por ky Kuvend jo një herë ka debatuar dhe janë bërë rekomandime, propozime për ta ndërprerë procesin e privatizimit të Postës, por nuk e kanë marrë besimin nga ky Kuvend. Gjejini ju ato.

Ndërsa, së fundi, për atë që iu rekomandon fjalës së zotit Beqiri, unë e kam një vendim këtu për rekomandimet e fundit, ku thuhet: “Vendim: Kuvendi nuk i miratoi rekomandimet e propozuara nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës lidhur me gjendjen ekonomike në vend, datë 4 prill 2013”. Prandaj, nuk është datë e largët kur ka ndodhur një gjë e tillë.

Dhe, së fundi, unë jam shumë i sigurt se Qeveria e Republikës së Kosovës nuk ka pse të frikësohet prej askujt, sepse këtë proces e ka karakterizuar një transparencë e plotë dhe do të jetë e gatshme që kontratën ta bjerë dhe ta votojë edhe në Parlamentin e Kosovës, që jam shumë i sigurt se deputetët që ia duan të mirën këtij vendi do t’ia japin mbështetjen këtij procesi të privatizimit dhe do ta vlerësojnë pozitivisht.

KRYETARI: Unë dua ta lexoj nenin 48 të Rregullores së Kuvendit: Deklarimet e ministrave.

Për të mos ju lodhur, unë po e lexoj shkurt, se është më i gjatë. Kush dëshiron ta lexojë krejt, mund ta lexojë. “Pasi të deklarojë ministri, kryetari i Kuvendit lejon të parashtrohen komente dhe pyetje në emër të grupeve parlamentare dhe nga deputetët e Kuvendit, individualisht”. Do të thotë, kështu shkruan në Rregullore, nuk po e bëj unë pse kam dëshirë. Jua jap përgjigjen në fund, kur ta kryejnë deputetët. Ata janë duke të pyetur ty.

Deputeti Albin Kurti e ka fjalën.

ALBIN KURTI: Faleminderit, kryetar!

Porsa na tha ministri që vendimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës për shitjen e PTK-së është Ligji për buxhetin e vitit 2011, i cili, siç e tha kryetari i Kuvendit, ka skaduar më 31 dhjetor të viti 2011. Ju porsa e thatë që nuk keni legjitimitet për këtë gjë, e para.

E dyta, ministër të kujt janë paratë, 277 milionë euro të kujt janë? Nuk u përgjigje.

E treta, listën e gjërave me shkrim edhe Distribucionet e Furnizimit të KEK-ut që e keni shitur, edhe të PTK-së, që po doni ta shitni, përkatësisht 75% të aksioneve të Telekomit. Listën e gjërave saktësisht, ‘jo nuk do të shiten objektet, shiten antenat’, e kështu me radhë. Listën!

Edhe e katërta, këto nuk janë fjalë të rrugëve, por janë fjalë të atyre njerëzve të institucioneve që na e pati sjellë edhe kontratën me “Behtel&Enka”, që nuk e keni publikuar kurrë, e që thatë nuk ka nënshkrim, e ma solli prapë edhe me nënshkrim, e që

sot e kësaj dite nuk ka publikim të kësaj kontrate, e këta njerëz që punojnë në institucione, që po m'i sjellin informatat, s'po guxojnë të flasin pas të ashtuquajturës 'vetëvrasje' të Dino Asanajt.

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Me siguri të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës u kujtohet debati për atë nen famoz për privatizimin e Postës dhe Telekomit të Kosovës, që e ka pas thur ish-ministri Bedri Hamzaj si transferim të aseteve publike në asete jopublike. Domethënë, një fjali goxha e komplikuar. Ju kujtohet që ka pasur debat këtu. Sidoqoftë, nuk është ky nen në buxhetin e vitit 2013, por prapë nëse e provojmë të mos e kontestojmë legalitetin - një pyetje po shtrohet këtu tepër e qartë dhe mendoj se nuk mund t'i mbyllim sytë nëse shtrohet një pyetje tepër konkrete dhe përgjigja është diçka krejt tjetër.

Mendoj se Kosova do të jetojë me këtë ngjarje, nëse bëhet akuzë publike. Se ka shpëlarje parash në shitjen e PTK-së dhe ministrat dhe Qeveria na thonë krejt është konform ligjit. Mendoj se përgjigja duhet të jetë krejt tjetër, ose për t'u mbyllur debati, ministri duhet të thotë 'do ta shikojmë, ose do ta verifikojmë'. Kjo do të përfundojë në sistemin legal të Kosovës për shkak se akuzat janë tepër publike, për shkak se ka dilema tepër të mëdha dhe mendoj se nuk mund të heshtim, kur përgjigja që i kthehet një pyetjeje kaq konkrete, është përgjigje krejt e kamufluar. Nuk është hera e parë që po ndodh dhe mendoj se nuk është mirë për askënd në Kosovë.

Ne si Grup Parlamentar nuk mund të themi se po marrim përgjigje, e nuk kemi përgjigje. Po kemi dëshirë të jetë gjithçka transparente, po kemi dëshirë që kjo kompani që e ka blerë me të vërtetë të jetë një kompani e një vendi mik. krejt po kemi dëshira ne, por dilemat që po ngrihen e obligojnë Qeverinë e Kosovës të fillojë të mendojë për të dhënë përgjigje. Nëse nuk jep përgjigje tash, mendojmë se kjo temë do të kthehet goxha zorshëm për vetë Qeverinë e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Muhamet Mustafa e ka fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: Së pari rreth çështjes së bazës ligjore. PTK-ja dhe Distribucioni janë privatizuar në bazë të ligjit mbi ndërmarrjet publike, i cili e krijon një bazë elementare shumë të ngushtë për privatizim. Por, megjithatë, në Ligjin për ndërmarrjet publike thuhet se ndërmarrjet publike mund të privatizohen në bazë të vendimit të Kuvendit të Kosovës, në të cilin përcaktohen edhe disa kushte kyçe për këtë privatizim, duke përfshirë edhe përqindjen e aksioneve. Ju lutem!

Ky Kuvend nuk ka marrë asnjë vendim në të cilin përcaktohet përqindja e aksioneve që shiten. Edhe neni 4 i Ligjit për buxhetin nuk e ka formën e vendimit, nuk i ka përcaktuar kushtet dhe nuk e ka përcaktuar përqindjen. Ju e dini se ne kemi insistuar disa herë që kjo të sillet në Kuvend, të merret vendimi dhe procesi i privatizimit të shkojë pa hipoteka të tilla.

Prandaj, nuk është transparencë, nuk është përgjegjësi, nuk janë zbatuar mirë rregullat.

Dy, sa u përket kompanive dhe miqve, unë po e ndiej veten keq kur çdo herë kur diçka mundohet të kapërcehet jo shumë pastër në baza ligjore, ne thirrmi në miq, të cilët i respektojmë, të cilëve u kemi borxh dhe të cilët janë duke u angazhuar këtu, por të gjithë ata miq nuk besoj që angazhohen për të shkuar diçka pa ligj, diçka pa Kuvend diçka, diçka që nuk është me procedurë. Prandaj, ju lutem, zbatojini ligjet dhe për shkeljen e ligjeve mos u mbështetni prapa miqve. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Hykmete Bajrami e ka fjalën.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryetar!

Besoj se gjithçka që pat për t'u thënë rreth bazës ligjore, veç u tha nga ju dhe deputetët tjerë. Kuvendi normalisht që ka diskutuar shpeshherë për procesin e privatizimit. U tha edhe më herët në debatin e fundit, rezultati ka qenë 38:38. Do të thotë, sa keni pasur deputetë në Kuvend pro procesit të privatizimit, po aq keni pasur kundër. Mandej, sa i përket listës se çka është shitur nga asetet, ne jemi shumë të vetëdijshëm që nuk janë shitur objektet, do të thotë nuk janë shitur ndërtesat dhe i takojnë Postës, e cila është njësi e veçantë që është ndarë nga Postë-Telekomi i Kosovës dhe është një ndërmarrje publike joprofitabile, fatkeqësisht. Mirëpo, duhet t'i bëjmë me dije të gjithë që është shitur rrjeti i telefonisë mobile komplet, me të gjitha antenat, është shitur rrjeti i telefonisë fikse, është shitur platforma kablllore për televizion, janë shitur 1,2 milion konsumatorë.

Tash merreni me mend, Kosova i 1,8 milion banorë, kurse 1,2 milion konsumatorë i ka Vala dhe për këtë arsye ne e konstatojmë çmimin. Përveç që nuk ka bazë ligjore, Qeveria nuk e ka pasur një strategji për shitjen e PTK-së, sepse e ka shitur kompaninë për 277 minus 35 milionë, që janë 242 milionë, dhe nuk e di, nuk është në gjendje të na japë përgjigje se ku do të shkojnë këto para, ku do të investohen, cili është projekti që Kosovës do t'i sjellë më shumë se 40 milionë dividendë që ia ka sjellë PTK-ja viteve të fundit. 65 milionë në vitin 2011, 45 milionë vitin e kaluar, kurse janë të planifikuara që 40 milionë dividendë të tërhiqen në këtë vit.

Cili është ai projekt që paska për të qenë më profitabil, do të thotë mungesa e një strategjie. Sa i përket transparencës, procesi nuk ka qenë aspak transparent. I kemi pasur dy runde, i kemi pasur kompanitë profesionale që janë tërhequr nga rundi, kemi pasur tri herë shtyrje të hapjes të ofertave pikërisht për t'i bërë dy kompani. E kanë gjetur diku një kompani, për t'i bërë dy, sepse nuk kanë mundur t'i hapin ofertat me një ofertues. Dhe, nuk ka transparencë. Procesi konsiderohet si i tillë edhe nuk ka aspak argumente nga Qeveria që e tregojnë të kundërtën. Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, e keni fjalën. Përgjigju në pyetje.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit!

Mendoj që debati, të cilin e filluam, do të japë efekte për të kuptuar edhe qytetarët e Republikës së Kosovës se sfida për ekonomi të tregut dhe sfida për të ecur përpara është e madhe, sepse duhet të kuptohet dhe më vjen keq që kolegja ime nuk i kupton këto gjëra.

Nuk i kupton, sepse është mbyllur në një sens të ngushtë të shikimit politik, por jo dhe profesional. Sido që të jetë, për të gjithë ata të cilët na dëgjojnë dhe janë qytetarë të Republikës së Kosovës, procesi i privatizimit të PTK-së është bërë në bazë të vendimeve të Kuvendit, në bazë të ligjeve të cilat ky Kuvend i ka sjellë, në bazë të vendimeve të cilat nga vendimet e Kuvendit dhe të ligjeve, Qeveria pastaj ka marrë vendime të caktuara.

Është proces transparent, është proces i hapur, i cili ka rritur interesin e kompanive të vendeve të zhvilluara dhe nuk është ndalur në idenë e krijimit të kësaj. Nuk ka nevojë askush të mendojë që joligjshmëria mund të fshihet pas miqve. Edhe një herë, të gjithë ata që kanë dilema për ligjshmërinë, të gjithë ata që kanë dilema për procesin, të gjithë ata që kanë dilema për listat, për marrëveshjet, për asetet, janë të mirëseardhur për ta marrë informacionin e plotë. Unë i dhashë disa informacione bazike, por sigurisht që kush dëshiron për të pasur qasje, është një ligj mbi qasjen në dokumente publike dhe jeni të mirëseardhur si deputetë, sepse e keni të drejtën që ta merrni komplet një proces të tillë. Por, unë e kuptoj debatin, e kuptoj që nganjëherë është vështirë të dilet mbi vetveten dhe e kuptoj që sikur është krijuar një bazë më shumë elektorale dhe po diskutohet mbi këto.

Unë e kuptoj “Vetëvendosjen” që ka koncept tjetër dhe kjo lëstë e natyrshme, sepse koncepti zhvillimor i saj është tjetër, dhe i cili ka dështuar në shumë vende tjera, por nuk e kuptoj shumë konceptin e atyre njerëz të cilët thirren dhe për çdo ditë ligjërojnë në ekonomi të tregut dhe ekonomi të transparencës dhe flasin për gjërat e tilla.

Të gjithë ata që kanë dilema, po e them edhe një herë, qoftë për ligjshmëri, qoftë për transparencë të procesit, qoftë për prejardhje të kapitalit, urdhëroni, janë institucionet shtetërore, të cilat e japin përgjegjësinë e plotë dhe unë nuk e marr të drejtën në bazë të flas në emër të institucioneve shtetërore, sepse jam institucionalist dhe dëshiroj t’i respektoj institucionet, por mbi të gjitha më vjen keq që debatet e tilla bëhen pa agjendë. Do të ishte mirë, nëse dëshironi ta bëjmë këtë debat, qoftë të sillet mocione për ta ndalë këtë proces, urdhëroni Kuvendi e ka këtë mundësi, le ta fillojë, e sjellim edhe bazën ligjore, edhe të gjitha gjërat. Ta informojmë me detale secilën prej tyre dhe Kuvendi le të marrë vendim prapë për këtë. Ne jemi për t’i respektuar vendimet e Kuvendit, ne e kemi atë bazë ligjore mbi Kuvendin, prandaj unë jam shumë i gatshëm, me krejt ministrat të cilët kanë marrë pjesë në këtë proces, por edhe me vendim të Qeverisë, sepse kjo ka kaluar edhe në Qeverinë e Republikës së Kosovës, me vendim unanim nga të gjithë ministrat dhe kryeministri, edhe zëvendëskryeministrat, të gjithë ata të cilët janë të involvuar, sepse kanë pasur besim në zhvillimin ekonomik dhe në krijimin e perspektivës për qytetarët.

Shihni se çfarë po ndodh sot në vendet e rajonit, të cilat kanë dashur me kaq ngulm ta mbajnë rolin e shtetit në ekonomi, siç po pretendohet këtu. Sllovenia është një shembull, në të cilin thirrur shumë shpesh, dhe ajo po hyn në një proces kur, ose do të kërkojë ndihmë nga Bashkimi Evropian, ose do të merret me shitjen e pothuajse të gjitha aseteve publike, sepse nuk ka mundur t’i qëndrojë ekonomia. Ekonomia e tregut nuk është ajo ashtu si po thoni. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Pasi u përsërit çështja e debatit, unë dua ta lexoj në tërësi nenin 48 - Deklarimet e ministrave: “Në çdo mbledhje plenare të Kuvendit, ministri me kërkesë dhe në marrëveshje me kryetarin e Kuvendit, mund të flasë në Kuvend për ndonjë çështje që ka të bëjë me fushëveprimin e përgjegjësive. Pasi ta ketë mbajtur fjalën, kryetari i Kuvendit lejon të parashtrohen komente ose pyetje në emër të grupeve parlamentare dhe nga deputetët e Kuvendit, individualisht. Ministri që e ka mbajtur fjalën, ka të drejtë t’u përgjigjet shkurtimisht komenteve dhe pyetjeve që mund t’i parashtrohen”. Do të thotë kjo çka është zhvilluar është në përputhje të plotë me nenin 48 të Rregullores së punës së Kuvendit.

Fjalën e ka ministri Bajram Rexhepi.

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Ndiej obligim për një deklaram që e bëri deputeti Burim Ramadani, i cili ose nuk i ka informatat e plota në lidhje me mospranimin e ekstraktit të lindjes, ose është i prirë për arsye politike, si zakonisht, që Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe mua personalisht të na akuzojnë pa bazë. E vërteta qëndron për hir të qytetarëve që ekstrakti i lindjes si një dokument i ri, i cili sublimon katër certifikatat e gjendjes civile, është i pranuar nga të gjitha ambasadat, përveç Ambasadës së Zvicrës, me të cilën jemi në bisedime edhe më tutje që t’i tregojmë argumentet dhe për hir të qytetarëve, që të mos pësojnë, edhe atë gjatë javës, besoj se kjo do të rregullohet. Prandaj, mund të ju them se ky projekt ka filluar bashkërisht me ekspertët e Komisionit Evropian para më tepër se një viti.

Nuk ka filluar pa përfunduar dhe me nguti, siç thotë zoti Ramadani, por natyrisht që çdo projekt i ri, çdo lansim i ri i teknologjisë informative, mund të shkaktojë probleme fillestare, që kanë qenë më të shprehura në komunën e Prishtinës, por me ndihmën e ekspertëve të Agjencisë së Regjistrimit Civil, tash ky lëshim i ekstrakteve të lindjes shkon pa kurrfarë problemi dhe deri tash janë lëshuar më tepër se 100 mijë sosh. Dhe, edhe një herë, me përgjegjësi them se përveç Ambasadës së Zvicrës, me të cilën jemi në bisedime, grupet teknike i kanë sqaruar gjërat dhe do të jetë në nivel pak më i lartë, mendojmë se edhe ata nuk kanë arsye që të mos i pranojnë këto dokumente, në mënyrë që qytetarët mos të maltretohen.

Prandaj, ky ishte një obligim imi që të ju shpjegoj se i keni informatat e shtrembëruara dhe zoti Ramadani për ambiciet tuaja personale, nëse keni, duhet të pritni pak më gjatë, kur t’i fitoni zgjedhjet.

KRYETARI: Burim Ramadani, shkurt!

BURIM RAMADANI: Faleminderit, kryetar!

Definimisht, shumë shkurt. Është normalisht që qëllime politike, po ne parti politike jemi, nuk merremi me shitblerje të specave, është tepër e qatë. Pyetja që ju bëra dhe prapë po e përsëris: e para, nuk është e vërtetë që vetëm Ambasada e Zvicrës nuk i pranon. E ke rastin edhe me ambasadat tjera, e ke rastin edhe me Ambasadën e Gjermanisë, e ke rastin

edhe me shpalljen nga nga shteti i Gjermanisë të mosbesueshmërisë të dokumenteve të gjendjes civile që vijnë nga Kosova dhe për këtë qytetarët e Kosovës sot paguajnë rreth 200 euro për mbilegalizimin, ashtu quhet, e dokumenteve të gjendjes civile, ose siç njihet në popull vulave apostile, të cilat janë bërë në Ministrinë e Brendshme, e tash bëhen vetëm në ambasadë, sepse edhe në dokumentin zyrtar që e kanë ueb-sajtin e vet tregojnë se nuk u besojnë dokumenteve të gjendjes civile për shkak se ka shumë pasaktësi.

E dyta, siç po thoni, nëse sistemi është i përfunduar, pse po ndërron çdo javë? Dhe, nuk është e vërtetë që ka vetëm problem në Prishtinë, por ka problem në secilën komunë. Dhe, nuk është çështja nëse kam apo jo informata, se ne këtu po jetojmë të gjithë. Njerëzit e Kosovës kthehen në ambasada, drejtorët e administratës, punëtorët e drejtorive të administratës që merren me gjendjen civile nëpër komuna dëshmojnë që për çdo javë ka nga një ndryshim në sistem dhe sistemi edhe më tutje nuk është i saktë.

Kjo është përgjegjësi juaja, duhet ta këqyrni, sepse ky problem është tepër i madh dhe që qytetarët e Kosovës nuk guxojnë të bllokohen kështu për një gabim pa lidhje. Faleminderit!

KRYETARI: Urdhëro, ministri e ka fjalën.

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Pa dashur të debatoj dhe të marr kohë më tepër, këto dokumente janë të sigurisë më të lartë dhe ato absolutisht nuk qëndrojnë. Prandaj, qytetarët mund të presin që edhe Ambasada e Zvicrës shumë shpejtë do t'i pranojë këto dokumente dhe ato çka pata t'i them, i tregova.

KRYETARI: Deputeti Goran Marinković, pyetje për ministrin Besim Beqaj.

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala predsedniče!

I ako sam dobio odgovor od ministra na njegovom prethodnom izlaganju, moram da se ne složim s tim, jer stari fiktivni dug koji građani Srpske nacionalnosti su dobili nije isti dug koji varira i kod ostalih građana, i koji bi trebao da se prenese, iz razloga zato što nije urađen po osnovu potrošnje, nego na osnovu indicija nekog koji tamo radi, i njegove slobodne procene. Zbog toga, ne mogu da se složim gospodine ministre sa vašom konstatacijom da je dug - dug. Slažem se da dug ne poznaje ni naciju, ni veru, i neka je tako, ali u ovom trenutku mislim da su građani Srpske nacionalnosti oštećeni na taj način, i da taj stari fiktivni dug nije realan.

Zbog toga vas molim da mi odgovorite još jednom na pitanje: Kako će to da se reši, jer se i on isto prenosi na novu kompaniju, koja će da preuzme rad sa Distribucijom na Kosovu.

(Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit të Kosovës, Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Beqaj e keni fjalën.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!
Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,
I nderuar deputet Marinkoviq,

Siç e thashë edhe në pjesën time të parë, përgjigjja është shumë e drejtpërdrejtë. KEK-u, sipas përgjigjes që e ka marrë nga ata, sepse duhet të kuptojmë që unë as nuk bëj fatura, as nuk merrem me mbajtjen e kontabilitetit në një kompani të tillë, por sidoqoftë KEK-u më ka informuar që nuk është në pozitë për të falur apo shlyer asnjë borxh të konsumatorëve, e kjo nuk lidhet me etnitetin e tyre. Për më shumë, është një marrëveshje e cila ekziston, marrëveshja ndërmjet udhëheqësve të komunitetit me Korporatën Energjetike të Kosovës për rregullimin e shërbimeve të energjisë elektrike. Kjo marrëveshje është respektuar nga shumica e konsumatorëve dhe ne i ftojmë që edhe ata konsumatorë, të cilët nuk e kanë respektuar marrëveshjen e nënshkruar, ta respektojnë atë, e kjo është rrugëzgjidhja e tejkalimit të këtij problemi. Pra, është një marrëveshje të cilën ata e kanë bërë në emër të komunitetit dhe duhet të respektohet si i tillë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shitesë, zoti Marinkoviq? Nuk ka pyetje shitesë. Atëherë, zoti ministër faleminderit! Deputeti Bekim Haxhiu, pyetje për ministrin Memli Krasniqi. Zoti Krasniqi nuk është këtu. Dëshironi ta shtroni pyetjen? Zoti Haxhiu e ka fjalën.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Pasi është hera e katërt kjo, pres ministri të përgjigjet në këtë pyetje. Pyetjen po e lexoj për shkak se është transferuar nga seanca e kaluar. Çështja ka të bëjë për arsye se Kuvendi, në mbështetje të nenit 65, pika 9 e Kushtetutës të Republikës së Kosovës dhe nenit 40 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen plenare, të mbajtur më 21 shkurt 2013, pasi debatoi për gjendjen e sportit në Kosovë, nxori 5 rekomandime. Me rekomandimin e parë, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit obligohet që në afat sa më të shkurtër kohor të përgatisë për miratim një pako ligjesh me qëllim të zhvillimit të sportit, si Projektligjin për sponsorim, Projektligjin për objektet sportive dhe menaxhimin e tyre dhe Projektligjin kundër huliganizmit.

Pyetja është: Pas votimit të këtyre rekomandimeve, çfarë hapash ka ndërmarrë ministria për hartimin e Projektligjit për sponsorim, Projektligjit për objekte sportive, menaxhimin e tyre dhe për Projektligjin kundër huliganizmit dhe disa dukurive tjera negative në sport dhe pasi gjendja në palestrat tona sportive është e mjerueshme, me gjithë investimet në sport dhe shikuesit të vazhdojnë të mërdhijnë bashkë me sportistët nga të ftohtit dhe në kohë dimri, e për këtë arsye shumë sportistë të huaj janë larguar nga Kosova, duke përçarur mesazh jo të mirë në botë për vendin tonë, dhe kjo e ka bërë që kërkesa ime vërtet të ishte në agjendën e ministrit për hartimin e Ligjit për menaxhimin e objekteve sportive. Gjithsesi, sikur Ministria apo ky Kuvend ta miratonte më herët Ligjin kundër huliganizmit dhe dukurive të tjera në sport, ne nuk do t'i kishim skenat çfarë i pamë kohëve të fundit në Merdar, por që kanë filluar edhe palestrat tjera sportive. Prandaj, kërkoj nga Ministria që të jetë syçelë në këtë drejtim dhe ta fillojë punën për hartimin e këtyre projektligjeve.

KRYESUESI: Keni edhe një pyetje tjetër për zotin Krasniqi, zoti Haxhiu?

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Edhe bazamenti i pyetjes së dytë e ka konceptin dhe bazën nga debati, i cili është zhvilluar për sportin, për arsye se Kuvendi në rekomandimet e propozuara me 21 shkurt, të votuara po atë ditë, pasi ka debatuar për gjendjen e sportit në Kosovë, ka kërkuar nga Ministria e Sportit që ta hartojë strategjinë për masivizim të sportit, duke filluar nga ai shkollor. Dhe, pyetja ka të bëjë rreth hapave që ka ndërmarrë Ministria e Sportit për hartimin e strategjisë për masivizim të sportit dhe, duke pasur parasysh që Kosova po i ofrohet çdo ditë e më tepër arenës ndërkombëtare, një masivizim i sportit do të ishte në interes të qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe Ministria do të duhej që të ndërmerre hapa të nevojshëm për hartimin e kësaj strategjie dhe interesimi im, i sportistëve dhe i qytetarëve të Republikës së Kosovës ka qenë për hapat që i ka ndërmarrë Ministria dhe ne do të donim që këto informata t'i kemi nga ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, i cili për herë të katërt nuk u përgjigjet këtyre pyetjeve.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Kajtazi, pyetje për Memli Krasniqin. Dëshiroi ta bëni pyetjen? Zonja Kajtazi e ka fjalën.

LIRIJE KAJTAZI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Edhe unë e përsëris pyetjen për ministrin Krasniqi, e cila sigurisht nuk i ka bërë shumë përshtypje, por mbetet në vazhdimësi ndoshta t'i kryejë detyrat e veta. Çështja ka të bëjë me ndërtimet e egra në zonën e mbrojtur historike të Prizrenit, që ka filluar të bëhet shqetësim për qytetarët prizrenas, por mbi të gjitha duhet të jetë shqetësim për institucionin që e udhëheq ministri. Nëse shkojmë dhe e vizitojmë atje, duhet të shikojmë se mos kemi hyrë në zonën historike apo në zonat private, të cilat veç kanë filluar njerëzit t'i bëjnë me ndërtimet e egra. Dhe, kohëve të fundit, edhe ky Kuvend e ka nxjerrë edhe Ligjin për Zonën Historike të Prizrenit. Pyetja ka të bëjë edhe me atë: A eka ndihmuar diçka në fushën e trashëgimisë ky ligj...?

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Zonja Lama, ministri nuk është për t'u përgjigjur. Nuk është as zonja Lama. Zonja Bytyçi, pyetje për kryeministrin Thaçi. Dëshironi ta bëni pyetjen? Zonja Bytyçi e ka fjalën.

KYMETE BYTYÇI: Faleminderit, kryesues!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Unë për hir të qytetarëve do t'ia parashtroj pyetjen zotit kryeministër.

Zoti kryeministër, para disa kohësh ka deklaruar në seancë plenare se me palën serbe, përveç bisedimeve politike e teknike, ka biseduar edhe për personat e pagjetur. Ju lutem, na jepni përgjigje çka është thënë në këto bisedime për këta persona të pagjetur dhe çfarë qëndrimi është marrë dhe kur pritet konkretizimi i këtyre bisedimeve?

Por, në fund, unë e lus kryeministrin që në seancën e radhës, për hir të qytetarëve, që ta dinë edhe qytetarët, se edhe ne si deputetë nuk jemi të njoftuar, çka është biseduar me palën serbe, në Bruksel. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Justina Pula nuk është këtu. Zonja Teuta Haxhiu, pyetje për zëvendëskryeministrin. Dëshironi ta bëni pyetjen?

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar!

Vetëm dua të tregoj se çështja ka të bëjë përsëri me ngritjen e memorialit në Mejë të Gjakovës. Mirëpo, për të marrë përgjigje nga zëvendëskryeministri, unë dhe familjarët, po e presim seancën tjetër.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Arsim Bajrami, pyetje për ministren Çitaku.

ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

E nderuara zonja ministre,

Konteksti i pyetjes sime lidhet me agjendën evropiane të integritimeve për Kosovën dhe për faktin që Kosova ka bërë përpjekje jashtëzakonisht serioze për ta ndërtuar agjendën e vet evropiane, jo vetëm nëpërmjet legjislacionit dhe Kushtetutës, që i respekton standardet më të larta evropiane, por edhe me vullnetin e shprehur politik të Qeverisë.

Por, fatkeqësisht, ky proces i integritimeve evropiane po lidhet me çështjen e dialogut dhe normalizimit dhe, fatkeqësisht, agjenda jonë po bëhet peng i politikave të Serbisë, të cilat po e mbajnë peng rrugën evropiane të Kosovës, që është edhe një padrejtësi që po i bëhet Kosovës, sepse Kosova ka shprehur një vullnet të jashtëzakonshëm proaktiv, ka bërë edhe veprime të njëanshme, jo vetëm në liberalizimin e vizave, por edhe në çështje tjera për ta ofruar një ofertë evropiane.

Dhe, pyetja ime, zonja ministre, është: A jeni duke menduar që ta ndërtoni një strategji alternative, që çështja e integritimit të Kosovës në Bashkimin Evropian të mos varet nga dialogu me Serbinë dhe të jetë një agjendë korrekte, çfarë edhe e meriton Kosova? Faleminderit!

KRYESUESI: Zonja Çitaku e ka fjalën, ministrja e Integritimeve.

MINISTRJA VLORA ÇITAKU: Faleminderit shumë, i nderuari deputet Bajrami!

Ju e dini që në tetor të vitit të kaluar, Komisioni Evropian e pati publikuar studimin e fizibilitetit për fillimin e negociimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Kosovës i qenë dhënë disa kritere afatshkurtra në katër fusha.

Në fushën e reformës së Administratës Publike është kërkuar miratimi i tri udhëzimeve administrative, gjë që është bërë. Në fushën e rendit dhe ligjit është kërkuar miratimi i dy ligjeve dhe një strategjie, gjë që është bërë, si dhe nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të Kosovës dhe EULEX-it. Në fushën e tregtisë është kërkuar ristrukturimi i Ministrisë së Tregtisë, si dhe përgatitja e vlerësimit të parë mbi ndikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, po ashtu kritere të përmbushura.

Është kërkuar akomodimi i Ombudspersonit, gjë që e kemi bërë bashkërisht me Parlamentin e Kosovës, si dhe është kërkuar, në fushën e mbrojtjes së të drejtave të komuniteteve, krijimi i një platforme, në të cilën institucionet e Kosovës do të bashkëpunonin me Kishën Ortodokse Serbe në Kosovë.

Këto kritere janë përmbushur dhe Komisionit Evropian i është dërguar raporti i detajuar.

Fatkeqësisht, më 16 prill, ditën kur Komisioni Evropian është dashur ta publikojë raportin vlerësues për vendet, të cilat aspirojnë të anëtarësohen në Bashkimin Evropian, raporti për Kosovën, përkundër përmbushjes së detyrimeve, është shtyrë, duke u ndërlidhur drejtpërdrejt me publikimin e raportit për Serbinë.

Unë e kam thënë edhe atë ditë, që ky ka qenë një rast i humbur për Komisionin Evropian, sepse ka pasur një mundësi që t'i jepet leksion Serbisë, por edhe vendeve tjera të rajonit, që një shtet nuk mund ta mbajë pafundësisht peng të ardhmen evropiane të shtetit tjetër. Kam kërkuar edhe më herët krijimin e një plani B, një strategjie alternative.

Ju e dini që një ndër arsyt kryesore pse e ardhmja jonë evropiane ndërlidhet me atë të Serbisë, ndërlidhet edhe me faktin që 5 vende anëtare nuk na kanë njohur ende. Dhe, shpeshherë Komisioni Evropian e ka përdorur këtë si justifikim. Mirëpo, është momenti i fundit që institucionet e Bashkimit Evropian të reflektojnë më thellësisht lidhur me këtë çështje, sepse është edhe kredibiliteti i tyre në pikëpyetje.

Mu për këtë qëllim, unë javën e ardhshme do të udhëtoj në Bruksel, do të kem takim me komisionarin për Zgjerim, me komisionaren për Punë të Brendshme, me komisionarin për Tregti, si dhe do të qëndroj në Luksemburg në takim me ministra të Jashtëm të Bashkimit Evropian.

Kosova nuk mund të mbetet vrimë e zezë për shkak të kokëfortësisë politike në Beograd për ta pranuar marrëveshjen për normalizim.

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zoti Bajrami? Zoti Bajrami e ka fjalën.

ARSIM BAJRAMI: Faleminderit për përgjigjen korrekte, zonja ministre! Do ta bëj vetëm një pyetje shtesë lidhur me strategjinë B, të cilën e paralajmëruat.

Definitivisht, do të duhej të bëhej kjo strategji B, sepse do të duhej të gjendet dera dalëse për integritet evropian. A do të jetë kjo një çështje politike, që do ta ngrini në nivel më të lartë të Qeverisë, apo vetëm ju si ministre? Dhe, a mendoni që kjo strategji B ka gjasa që të mirëkuptohet në qarqe të Bashkimit Evropian dhe çështja e integritetit tonë të mos jetë peng i bisedimeve aktuale, që po zhvillohen?

KRYESUESI: Zonja Çitaku e ka fjalën.

MINISTRJA VLORA ÇITAKU: Faleminderit shumë, kryesues!
I nderuari profesor Bajrami,

Është e vërtetë që kjo çështje ka filluar tashmë të diskutohet shumë intensivisht në kuadër të institucioneve. Normalisht, edhe Kryeministri, edhe Presidentja, por edhe ju si Kuvend do ta keni fjalën e juaj. Ndërkohë, që unë mu për këtë çështje do të udhëtoj në Bruksel. Ju e dini që Komisioni Evropian në studimin e fizibilitetit, të publikuar vitin e kaluar, ka rekomanduar në parim nisjen e negociatave për MSA, duke u thirrur në një mendim ligjor të Komisionit Evropian, mbi bazën e të cilit Komisioni Evropian mund të hyjë në marrëdhënie kontraktuale me Kosovën, pa pasur nevojë që Kosova formalisht të njihet nga 5 vendet e Bashkimit Evropian. Po ashtu, duke qenë vendi i parë që hyn në procesin e stabilizim-asociimit, pas ratifikimit të traktatit të Lisbonës, janë gjetur edhe disa modalitete shtesë, të cilat ne do t'i eksplorojmë dhe do të insistojmë që të aplikohen në rastin e Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kasolli, pyetje për ministrin e Arsimit, zotin Buja.

AFRIM KASOLLI: Faleminderit, kryesues!

Drejtimi i arsimit në nivel lokal në Kosovë karakterizohet me një shkallë të lartë të papërgjegjësisë në planifikim dhe zhvillim. Në një krizë të madhe ekonomike në vend, në komunën e Ferizajt, vazhdojnë të mos i marrin pagat për punën që kanë kryer rreth 40 mësimdhënës të këtij qyteti.

Ata nuk kanë marrë paga tash një vit, për shkak të mungesës së buxhetit komunal dhe kufizimeve nga MASHT-i. Në një prononcim, drejtuesit e Arsimit në Ferizaj patën deklaruar se kjo çështje do të mbyllet më së largu deri në muajin janar 2013, por kjo as që është realizuar. Kjo nuk ndodh askund në botë. T'i punësosh, e në të njëjtën kohë t'u thuash që do të marrin pagën, pastaj t'u thuash që duhet të hyni në borxhe për ta kaluar muajin, kjo është e patolerueshme.

Të punosh dhe të njëjtën kohë të mos e marrësh kompensimin për punën e madhe, po ashtu është një sfidë e madhe.

Prandaj, pyetja për ministrin është: Çfarë është duke bërë Ministria e Arsimit fillimisht në hetimin e këtij rasti dhe pastaj në tejkalimin e këtij problemi? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Buja, e keni fjalën.

MINISTRI RAMË BUJA: I nderuar zoti kryesues,

Të nderuar kolegë ministra,

Të nderuar deputetë,

I nderuar deputet Kasolli,

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë i zbaton ligjet që janë në fuqi dhe konform kësaj do të jetë edhe sqarimi i kësaj pyetjeje që bëni ju. Në rastin konkret, Ligji për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës, neni 4, mbi kompetencat dhe kompetencat e zgjeruara të komunave, pika 1 e sqaron këtë çështje.

Komunat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive për atë që ato i takojnë interesit lokal, ndërkohë që respekton standardet e caktuara sipas legjislacionit në fuqi në lidhje me

dispozitat e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve arsimore, marrin punë, pagesat e rrogave dhe aftësimin e mësimitdhënësve dhe të administratorëve.

KRYESUESI: Ju kisha lutur për qetësi, të nderuar kolegë... Unë ju lus, zotërinj deputetë, zoti ministër, ju lus të uleni në vendin tuaj dhe të dëgjoni. Askush s'po dëgjon. As ai që e ka bërë pyetjen, s'po mund ta dëgjojë përgjigjen. Faleminderit!

MINISTRI RAMË BUJA: Po ashtu, në bazë nenit 5, paragrafit c të po këtij ligji, një ndër kompetencat e komunave në nivelin 0, 1, 2 dhe 3 të arsimit publik parashkollor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë, është edhe punësimi i mësimitdhënësve dhe personelit tjetër të shkollave, në pajtueshmëri me procedurat ligjore të rekrutimit, përzgjedhjes së punësimit dhe të të punësuarve publikë.

Ministria e Arsimit, me Udhëzimin Administrativ nr. 2/2011, të datës 30.6.2011, që ka të bëjë me zbatimin e një formule komunale në përcaktimin e buxheteve shkollore në komunat që janë duke e implementuar financimin në nivel të shkollës, e ka përcaktuar buxhetin për arsimin në komuna.

Me bazën ligjore, kjo çështje është kompetencë ekskluzive e komunave, andaj edhe punësimi dhe pagesa e punëtorëve të arsimit, e në rastin konkret sigurimi i pagave për rreth 40 mësimitdhënës të komunës së Ferizajt është obligim ekskluziv i Komunës së Ferizajt. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kasolli, dëshironi pyetje shtesë? Zoti Kasolli e ka fjalën.

AFRIM KASOLLI: Faleminderit, kryesues!

Në bazë të asaj që u dëgjua, gjoja sikur Ministria e Arsimit nuk e ka ndërmend ta ndërmarrë asnjë veprim për tejkalimin e këtij problemi, për shkak se u kuptua që kjo qenka kompetencë ekskluzive e komunave. Mirëpo, problemi është se 40 njerëz kanë punuar dhe nuk i marrin pagat e tyre për atë që e kanë bërë. Dhe, unë mendoj që nëse konstatohet se udhëheqësit e departamenteve komunale për Arsim kanë bërë shkelje ligjore ndërmjet planifikimit dhe punësimit, atëherë konsideroj që është përgjegjësi e Ministrisë së Arsimit të intervenojë në këtë çështje, në mënyrë që të tejkalohet ky problem, i cili ka ardhur si rezultat i papërgjegjësisë së drejtorëve të departamenteve komunale, që janë të emëruar nga ky pushtet. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Buja?

MINISTRI RAMË BUJA: Intervenimi ynë nëpërmjet Inspektoratit është obligim yni ligjor dhe këtë do ta bëjmë gjithsesi, por çështja është që nuk e kemi vetëm problemin e Ferizajt, kemi probleme edhe me Gjiçin dhe komunat tjera, por me më pak numër të të punësuarve dhe këtë gjë do ta bëjmë. Por, është problemi që ne do ta bëjmë punën tonë konform ligjit, por, megjithatë, thashë që ligji për arsimin nëpër komuna i obligon këta njerëz që të mos bëjnë mbingarkesë të të punësuarve të tyre. Faleminderit!

KRYESUESI: Deputetja Musliu, pyetje për ministrin Buja. Deputetja nuk është këtu. Zoti Bajrami, pyetje për ministrin Mahir Jagzhëllar.

ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

I nderuar ministër Jagzhëllar,

Pyetja ime ka të bëjë me një projekt shumë të rëndësishëm, që e ka zhvilluar Qeveria në vitin 2009-2010, projekti i rishikimit funksional, i cili është zhvilluar në kuadrin e reformës së Administratës Publike dhe që është mbështetur fuqishëm nga Qeveria britanike, përkatësisht DFID-i.

Zoti ministër, a mund të na informoni a është konsideruar i përfunduar ky projekt? A janë implementuar të gjitha rekomandimet, a keni pasur probleme, ngecje? Dhe, zyrtarisht a mund ta konsideroni projektin e rishikimit funksional të përfunduar, duke qenë se ky projekt ka qenë një ekspertizë shumë e mirë ndërkombëtare rreth performansës së Qeverisë, kapaciteteve administrative dhe ka qenë një shans jashtëzakonisht i mirë që Qeveria jonë të bëhet e krahasueshme me qeveritë rajonale? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Faleminderit, i nderuari kryesues, nënkryetar i Parlamentit!

Të nderuar ministra,

I nderuari deputet zotëri Bajrami,

Duke ju falënderuar për pyetjen rreth procesit të rishikimit funksional, më lejoni që në disa pika të shkurtra ta prezantoj këtë proces si pjesë përbërëse e reformës së Administratës Publike.

Siç dihet, edhe ju e keni cekur, Qeveria e Republikës së Kosovës, me përkrahjen e Qeverisë së Britanisë së Madhe, në prill të vitit 2008 e ka filluar projektin e rishikimit funksional dhe organizimit institucional, apo ndryshe i njohur si projekti “Freetown”. Fushëveprimtaria e projektit shtrihet në tri shtylla kryesore:

- rishikimin e Qeverisë si tërësi, pra analizimi i organizimit dhe i funksionimit të Qeverisë në nivel makro,
- rishikimi vertikal, nëpërmjet të cilit u bë analizimi i organizimit dhe funksionimit i të gjitha ministrive, të Zyrës së Kryeministrit dhe disa agjencive të themeluara në atë kohë në nivel makro dhe mikro, por gjithashtu edhe
- rishikimi horizontal, që përfshin analizimin e funksioneve të përbashkëta për të gjitha institucionet, për shembull menaxhimin e burimeve njerëzore, e-qeverisjen, prokurimin publik, koordinimin e politikave, hartimin e legjislacionit e të tjera.

Projekti si i tillë është përfunduar në vitin 2011 dhe nga analizat në rishikimin në fjalë kanë derivuar një mori rekomandimesh, afro 400 sosh. Si rezultat i këtij procesi, një numër i madh i këtyre rekomandimeve tashmë janë integruar në politikat tona zhvillimore, në organizimin tonë institucional qeveritar, si dhe në funksionimin e gjithëmbarshtëm të organeve të administratës shtetërore.

Më konkretisht, këto rekomandime janë zbërthyer në masa konkrete nëpërmjet një numri të madh të dokumenteve zhvillimore dhe strategjike, tashmë të aprovuara nga Qeveria, nëpërmjet legjislacionit primar, që ndërlidhet me reformimin e Administratës Publike, të aprovuar nga Kuvendi, legjislacioni sekondar dhe nga rregullativa të ministrive, si dhe nëpërmjet procesit aktual të riorganizimit të brendshëm institucional.

Për ta ilustruar këtë me shembuj, janë disa, si:

- në bazë të rekomandimit të përgjithshëm për themelimin e një ministrie të fuqishme për zhvillimin ekonomik është krijuar Ministria e Zhvillimit Ekonomik. Më pastaj, lidhur me rekomandimin në rrafshin horizontal për fuqizimin e strukturave politikëbërëse dhe grumbullimin e atyre mbështetëse, tashmë Ligji për administratën shtetërore, atëherë është përmendur...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zoti Bajrami?

ARSIM BAJRAMI: Zoti ministër, kisha dashur të përgjigjeni në kontekstin e pyetjes sime, si ministër përgjegjës që e monitoroni këtë proces, a vëreni që janë implementuar rekomandimet, a ka rezistencë, për shkak se fryma e këtyre rekomandimeve ka qenë shkurtime strukturave administrative nëpër ministri dhe nëpër agjenci qeveritare?

Në disa raste, jo që s'ka pasur shkurtime, por ka pasur rritje të Administratës Publike. Kur ka filluar ky projekt, e ka pasur për qëllim që ta krijojë një qeveri racionale, në pajtim me mundësitë buxhetore të Kosovës. Ju, si ministër, e keni mbikëqyrur këtë projekt dhe a mendoni se Kosova po shkon në drejtim të implementimit të këtyre konkluzioneve, që kanë qenë jashtëzakonisht kompetente dhe profesionale?

KRYESUESI: Ministër?

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Po, si Ministri e Administratës Publike jemi pjesë e Komisionit Ndërmintor të Reformës së Administratës Publike, i cili udhëhiqet nga zëvendëskryeministri, por sigurisht se ne jemi duke vazhduar në atë rrugë. Nuk mund të them se të gjitha çështjet janë duke u zbatuar, por shumica e tyre po. Dhe, përafërsisht, të gjitha ministritë i kanë aprovuar rishikimet funksionale dhe planet strategjike zhvillimore.

Tash jemi në vazhdimësi me aprovimin e rregulloreve dhe sistematizimin e brendshëm të institucioneve, por gjithashtu jemi në fazën e aprovimit dhe klasifikimeve të vendeve të punës për çdo institucion.

Në anën tjetër, duke u bazuar në këto rekomandime, jemi duke i hartuar edhe planet dhe ligjet tjera, si për inspektimin administrativ, gjithashtu për trajnimet e obliguara, por janë edhe disa çështje tjera, të cilat tash për tash jemi duke i realizuar, por të cilat për shkak të kohës nuk mund t'i prezantoj në këtë moment.

KRYESUESI: Faleminderit! E fundit është zonja Haxhiu, pyetje për zëvendëskryeministrin Kuçi. Dëshironi ta bëni pyetjen? Fjalën e ka zonja Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryesues!

Edhe pse ministri i Drejtësisë nuk është këtu, unë po e parashtroj pyetjen.

Në procedurën gjyqësore të padrejtë, në të cilën është vendosur në dëm të dy ndërmarrjeve shoqërore “Apiko” dhe “Iliria”, duke ia falur kështu ngastrat e këtyre dy ndërmarrjeve Manastirit të Deçanit, në aktgjykimin e Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme. Për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit theksohet se Ministria e Drejtësisë, me anë të letres së vet, ka deklaruar se në pajtim me nenin 67, pika 4 të Ligjit mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi, lejon dhe e detyron Ministrinë e Drejtësisë që të përfshihet në procedurë, e në këtë rast t’i përfaqësojë edhe interesat e Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Me gjithë këtë detyrim ligjor, Ministria e Drejtësisë nuk ka insistuar fare për përfaqësimin e nevojshëm të AKP-së dhe është vetëkënaqur me një shkresë, të cilën ia ka komunikuar Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme.

Andaj, pyetja parlamentare është se pse Ministria e Drejtësisë ka qenë pasive në këtë çështje me kaq interes të rëndësishëm publik? Pres përgjigje në seancën e ardhshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Konstatoj se për sot janë shteruar pyetjet, si edhe hapësira kohore. Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës që është:

3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes plenare, të mbajtur më 4, 5, 10 dhe 11 prill 2013

Të nderuar deputetë,
Presim që të bëhet kuorumi, për ta futur në votim.

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

Mirë, u bë kuorumi. Tash janë 61 deputetë në sallë. A ka dikush vërejtje lidhur me procesverbalin? Nuk ka.

Atëherë, konstatoj se Kuvendi e miratoi procesverbalin e mbledhjes plenare, të mbajtur më 4, 5, 10 dhe 11 prill 2013.

Zoti Krasniqi është paraqitur me një kërkesë për rend të ditës. Në emër të 6 deputetëve nënshkrues, kërkesa është protokolluar. Zoti Krasniqi, e keni fjalën.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryesues!

Në bazë të nenit 42, paragrafi 2, të Rregullores së Kuvendit, propozoj që rendi i ditës së mbledhjes plenare të datës së sotme, 18 prill 2013, të plotësohet edhe me një pikë - Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Avokatinë.

Në arsyetimin që e kam përshkruar do të mundohem shkurtimisht të ju njoftoj që Komisioni për Legjislacion, në mbledhjen e mbajtur më 15 prill të vitit 2013, e ka shqyrtuar në parim këtë projektligj dhe ia ka rekomanduar Kuvendit për miratim në parim.

Është një çështje sensitive që ngërthehet në këtë ligj dhe është një nevojë imediate që të shtrohet për shqyrtim në parim sot në këtë seancë. Kështu që, lus për mirëkuptim, juve si kryesues dhe të gjithë deputetët ta mbështetnin këtë propozim timin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, unë e hedh në votim mocionin. Kryetarët e grupeve parlamentare dëshirojnë të shprehen lidhur me propozimin? Zoti Beqiri, në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Ne parimisht nuk kemi asgjë kundër që kjo të futet në rend të ditës, vetëm po ia rikujtoj opinionit që pikërisht PDK-ja ka qenë herën e kaluar kundër përmbajtjes që tash kërkojnë ta ndryshojnë. Kjo le të dihet për ata që na shohin dhe na dëgjojnë, sepse kjo është e vërteta. Por, edhe një herë po e përsëris, edhe komisionet i kanë dhënë mendimet e tyre, ne nuk kemi kundër që të futet në rend të ditës, por po e përsëris sesi vërtet qasjet ndryshohen për një periudhë kohore, qoftë gjashtëmujore apo njëvjeçare, e tregojnë nganjëherë seriozitetin tonë, për një çështje të caktuar, ose një ide të caktuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryesues!

Ne si Grup Parlamentar jemi të vetëdijshëm që Projektligji për Avokatinë është shumë i rëndësishëm, mirëpo nuk po e kuptojmë tendencën se përse po kërkohet që ky projektligj të futet sot si pikë e re e rendit të ditës. Meqë nuk u thanë as arsyet se përse kjo është shumë çështje sensitive dhe imediate, qysh tha zoti Krasniqi, pra nuk po e kuptojmë se përse është kjo çështje sensitive. Pra, le ta tregojnë arsyen dhe sigurisht që ne do ta përkrahim këtë iniciativë, mirëpo nuk po thuhet asgjë.

Për më tepër, miratimi i projektligjeve në procedurë të përshpejtuar, ashtu siç është bërë shumë herë në këtë Kuvend, po na sjell më pas ligje jo të mira, e që po mbeten në sirtarët e kësaj Qeverie dhe më pas po vijnë për plotësim-ndryshim.

Pra, ne mendojmë që nuk është kjo çështje tepër urgjente dhe mund të presë që ky projektligj të shqyrtohet në seancën e ardhshme, meqë kemi shumë vërejtje, edhe teknike, por edhe përmbajtjesore në këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së.

ARDIAN GJINI: Faleminderit!

Po më duket që nganjëherë duhet pyetur veten se çfarë ka ndodhur prej të hënës deri më sot, që e ka bërë kaq akute këtë temë? A ka dikush që mund një javë përpara ta dijë çka është urgjente? Apo, urgjente na dalin sot për nesër temat?!

Me të vërtetë, është goxha problematike në këtë Kuvend të Kosovës. Ne nuk kemi kurrgjë kundër këtij ligji. Mendoj se duhet të ketë ndryshime prej leximit të parë në leximin e dytë. Nuk do të kishim ndonjë problem, por është jashtëzakonisht problematike të kuptohet pse u bë sot urgjencë ky ligj? Pse s'i ka ra ndërmend dikujt dje, ose pardje, ose javën e kaluar? A ka ndodhur diçka këtë javë që e bëri kaq urgjent këtë ligj? Me të vërtetë, është problem.

Edhe çështja tjetër është qysh po provojmë t'i obligojmë deputetët të diskutojnë për lexim të parë në parim, kur nuk e kanë pasur në agjendë? A mendoni ju që deputetët, kur i kanë 100 ligje në agjendën legjislative, rrinë krejt kohën 'gafil', apo krejt kohën të përgatitur? Po, nuk mund të diskutojnë njerëzit për një ligj, i cili futet sot në diskutim! Nëse duam ta kalojmë, se është një urgjencë, kurrkush s'ka problem, po le të na e sqarojnë urgjencën.

Po dua ta përsëris, të shënohet kjo poentë. Nuk ka ndodhur kurrgjë hiç prej të hënës deri sot, kur ka pasur kohë të përgatiten deputetët, që sot në mëngjes ligji na qenka bërë kaq urgjent. Seriozisht, është e çuditshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, kryetarja e grupit Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Duke e pasur parasysh se ne e kishim mbledhjen e Kryesisë ditën e hënë, prej ditës së hënë deri në ditën e sotme janë tri ditë. Në rast se shihet shumë me urgjencë nga Qeveria miratimi i këtij ligji, ne do t'i japim përkrahje, mirëpo u tha edhe nga parafolësit - nuk e di sa kanë do të jenë deputetët vizavi me diskutimin në këtë ligj.

Mirëpo, nëse është urgjente, ne do t'i japim përkrahje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Beqiri, edhe një herë, si kryetar i Grupit.

ISMET BEQIRI: Kërkoj falje që e mora fjalën edhe një herë. Ne kërkojmë që nëse futet në rend të ditës, të jetë pika e fundit. Jo më herët! Përndryshe, nëse propozohet të futet më herët, ne nuk do ta votojmë, ose do të votojmë kundër.

KRYESUESI: Edhe ashtu nuk do ta futnim më herët. Propozimi është si pikë e fundit të rendit të ditës. Nuk ka debat tjetër shtesë. Grupet parlamentare mund të prononcohen, vetë kryetarët e grupeve, ose në emër të grupeve.

“6+”-i nuk është paraqitur. SLS-ja nuk është paraqitur. Atëherë, e hedh në votim, sipas Rregullores, që propozimi i zotit Krasniqi, i mbështetur nga 6 deputetë të futet në rend të ditës, si pikë e fundit për sot për këtë seancë.

Ju lus të bëheni gati për votim. Votojmë tash!

Në sallë janë të pranishëm 67 deputetë.

Për kanë votuar 31 deputetë, kundër 17, kanë abstenuar 7. Konstatohet që miratohet propozimi i zotit Krasniqi, i mbështetur nga 6 deputetë të tjerë.

Vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për organet qeveritare për shoqërinë e informacionit

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për organet qeveritare për shoqërinë e informacionit dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

E ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, zotin Vehapi, që ta arsyetojë raportin me rekomandime.

IDRIZ VEHAPI: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Pasi Projektligji për organet qeveritare për shoqërinë e informacionit ka qenë edhe një herë në seancë plenare për leximin e dytë, unë për këtë qëllim do të bëj një elaborim të shkurtër lidhur me procedurat, nëpër të cilat ka rrjedhur projektligji.

Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, më 24.10.2012 e ka dorëzuar raportin me rekomandime për Projektligjin për organet qeveritare për shoqërinë e informacionit, i cili raport me rekomandime është radhitur si pikë e rendit të ditës në seancën plenare të datës 8 nëntor 2012.

Në të njëjtën seancë, deputeti Armend Zemaj, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, ka kërkuar që projektligji në fjalë të shtyhet, derisa të konsultohen lidhur me vërejtjet, që projektligji të mos aplikohet në institucionet e pavarura, sidomos për Gjyqësorin dhe prokuroritë. Pastaj, Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, në bazë të vërejtjeve të dhëna në seancën plenare të datës 8 nëntor 2012, në mbledhjen e mbajtur më 27 shkurt të vitit 2013, e rishqyrtoi Projektligjin për organet qeveritare për shoqërinë e informacionit dhe vendosi për plotësimin e raportit të datës 24.10.2012 me këtë amendament.

Nenit 10, pas paragrafit 2, i shtohet një paragraf i ri 3, te dispozitat kalimtare me këtë formulim, si vijon:

Institucionet, të cilat gëzojnë pavarësi kushtetuese, të cilat janë të përjashtuara nga zbatimi i këtij ligji, kanë të drejtë të lidhin marrëveshje mirëkuptimi me ministrinë përgjegjëse për Administratë Publike, për ato fusha për të cilat këto institucione mund të përfitojnë nga agjencia për zbatimin e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit. Kjo është bërë në konsultime me sponsoruesin e ligjit në komisionin përkatës, po ashtu edhe me ato institucionet e pavarura.

Projektligji përmban gjithsej 12 nene dhe ka 10 amendamente, prandaj në emër të komisionit lus deputetët që ta votojnë projektligjin me amendamentet e propozuara. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, futemi në procedurën e votimit.

Amendamenti 1.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 2.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 3.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 4.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 5.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 6.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 7.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 8.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 9.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 10.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 11.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Të nderuar deputetë, e votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara.

Në sallë janë 64 deputetë. Votojmë tash!

Konstatoj që me 61 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi Ligjin për organet qeveritare për shoqërinë e informacionit.

Kalojmë në pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Debat parlamentar lidhur me ndërmarrjen “Trepça”, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, në bazë të nenit 15, pika 8 të Rregullores së Kuvendit, ka kërkuar debat parlamentar lidhur me ndërmarrjen “Trepça”.

Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e përbashkët me kryetarët e grupeve parlamentare, më 15 prill 2013, ka vendosur që këtë pikë ta radhisë për mbledhjen e sotme.

E ftoj zotin Beqiri, si kryetar i Grupit Parlamentar të LDK-së, në cilësinë e propozuesit të çështjes, që ta marrë fjalën, apo dikush tjetër. Atëherë, zoti Ferati.

SADRI FERATI: I nderuari kryesues,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Së pari, edhe një herë dua të ju falënderoj për mbështetjen që të zhvillohet ky debat sot për “Trepçën” dhe unë besoj se të gjithë pajtohem se është një debat i rëndësishëm dhe me interes për të gjithë.

Gjiganti “Trepça”, në të kaluarën jo shumë të largët, me dekada ka qenë një promotor i zhvillimit në Kosovë.

Deri në fillimin e vitit 2009, nga minierat e “Trepçës” janë nxjerrë 71 milionë tonë xehe me vlerë të përafërt rreth 17,7 miliardë dollarë. Rreth 15 mijë të punësuar me përkushtimin dhe djersën e tyre bënë që “Trepça” të bëhet një prej eksportuesve më të mëdhenj në ish-Jugosllavi dhe kontribuuesi më i madh në Buxhetin e Kosovës.

“Trepça” ishte krenaria e Kosovës. Shumica dërmuese e punëtorëve të “Trepçës” dhanë kontribut të madh për shtetin e Kosovës dhe lirinë që ne sot e gëzojmë. Ta kujtojmë edhe sot marshin e famshëm të punëtorëve të “Trepçës” në vitin ‘88, si dhe grevat historike të vitit ‘89.

Shprehim mirënjohjen tonë të thellë për minatorët dhe të gjithë punëtorët e “Trepçës” për këtë kontribut kolosal. Shumica e këtyre punëtorëve dhe patriotëve iu nënshtruan torturave, burgosjeve dhe largimit me dhunë nga puna.

Kam pasur rast të dëgjoj me qindra deklarime se pas kthimit do të punojmë, qoftë edhe pa pagesë, për të vazhduar me kontributin tonë për zhvillimin e shtetit dhe të shoqërisë kosovare. Për fat të keq, shumicës dërmuese nuk iu plotësua kjo dëshirë. Në punë u kthye vetëm një numër i vogël i punëtorëve. Së bashku me menaxhmentin dhe stafin drejtues, ata e zhvilluan një betejë të madhe për shpëtimin e minierave nga përmbytjet, si dhe përkujdesjen për ruajtjen e kapaciteteve tjera përpunuese.

Dhe, me këtë rast, ne e shprehim mirënjohjen tonë për të gjithë ata, pra menaxhmentet në kontinuitet, dhe për të gjithë ata që janë angazhuar për këtë kontribut.

Sot, menaxhmenti dhe punëtorët e “Trepçës” e kërkojnë mbështetjen e Parlamentit, të Qeverisë, të Odës së Veçantë, AKP-së, për të krijuar mundësi që ata me profesionalizmin dhe përvojën e tyre të menaxhojnë me resurset e tyre në interes të punëtorëve, por edhe të shoqërisë kosovare.

Për fat të keq, edhe pse me ligj AKP-ja është obliguar që brenda 18 muajve ta përcjellë në Parlament planin e riorganizimit të “Trepçës”, kjo ende nuk po ndodh.

Cila është “Trepça” sot?

Sot rezervat e identifikuara të “Trepçës”, pra të minierave në “Trepçë” janë 53 milionë tonë, përkatësisht po ta përkthejmë që me punën me kapacitetet të plota, këto rezerva janë të mjaftueshme për një prodhim mbi 100 vjet, edhe pse rezervat sigurisht duhet të jenë më të mëdha, por për to kërkohen hulumtime për zbulimin e tyre.

“Trepça” është e regjistruar në ministrinë përkatëse, me numrin e biznesit 70331094: “Trepça - ndërmarrje nën administrim të AKP-së”.

Aktualisht janë të punësuar 1 500 punëtorë. Prodhimi për vitin e fundit, pra po i referohem vitit 2012, ishte rreth 13 mijë tonë, apo shprehur në vlerë financiare rreth 20 milionë. Pra, “Trepça” ka filluar të bëhet një eksportues shumë i rëndësishëm, ndër më të mëdhenjtë në Kosovë.

Plani i punës, i hartuar nga menaxhmenti i “Trepçës” për 3-5 vjetët e ardhshme parashikon mundësinë e trefishimit të prodhimit dhe po ashtu trefishimin e numrit të punëtorëve. Dhe, vetëm në Stantërg dhe Mitrovicë mund të hapen rreth 1 000 vende të reja të punës dhe kuptohet rreth 3 000 të tjera nëpër njësi tjera.

Nëse do të mundësohej partneriteti me investitorët, tashmë të interesuar, do të mund të aftësohej elektroliza e zinkut, të rehabilitohej shkëmborja e plumbit, si dhe rehabilitimi i prodhimit të plehrave fosfate.

Me këto investime do të mundësohej hapja edhe e 2 000 vendeve tjera të punës, si dhe shteti do të mund të inkasonte në këtë shkallë rreth 30 milionë euro në vit, pa llogaritur tatimet në të ardhura personale.

“Trepça”, gjithashtu, ka qenë një qendër regjionale e përpunimit të xehes së metaleve me ngjyrë. Prandaj, përveç xeheve nga minierat e veta, ajo i ka trajtuar edhe xehet që kanë ardhur nga disa miniera në Serbi, Mal të Zi, Maqedoni e më gjerë.

Pas largimit të dhunshëm të shqiptarëve nga puna, “Trepça” është administruar nën masa të dhunshme. Gjatë këtyre 10 vjetëve ka dyshime të bazuara se “Trepça” është përdorur për shpëlarje parash. Menaxhmenti, stafi udhëheqës dhe punëtorët e “Trepçës”, pas kthimit në punë, nuk kanë parë investime apo pajisje, që do të dëshmonin për shpenzimin e miliona eurove për nevojat saj.

Ndërsa, “Trepça” tani ka mbetur peng i pretendimeve të shumta të “kreditorëve”, të cilët pretendojnë se “Trepça” nuk i ka shlyer borxhet ndaj tyre. Për këtë qëllim, Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme ka bërë thirrje publike dhe e ka vendosur një afat 12-mujor për paraqitjen e pretenduesve si kreditorë. Pas përfundimit të këtij afati, Dhoma e Veçantë e ka vazhduar edhe për 12 muaj. Ky proces mund të vazhdojë me vjet, ndërsa “Trepça” mund të stagnojë dhe të dëmtohet nëse nuk i shfrytëzon mundësitë e veta për prodhim dhe zhvillim.

Gjatë fazës së verifikimit të pretendimeve të donatorëve ekzistojnë edhe fazat e ankimeve, kështu që askush nuk është i sigurt se a do të kalojnë një, dy, pesë, apo dhjetë vjet, prandaj, ne si Kuvend, Qeveria, AKP-ja, nuk duhet të jemi indiferentë që para syve tanë të ndodhë stagnimi i një potenciali kaq të madh për arsye dhe pa fajin tonë, të punëtorëve të “Trepçës” dhe gjithë atyre të rinjve që pretendojnë që nesër mund të gjejnë interes në punësimet në “Trepçë”.

Pas verifikimit të pretendimeve të kreditorëve, organet e drejtësisë duhet të fillojnë hetimet se ku kanë shkuar ato para të kreditorëve të cilat vërtetohen se janë derdhur në “Trepçë”.

Prandaj, duke mos e penguar punën e Dhomës së Veçantë dhe duke ruajtur natyrën e pronës, është e domosdoshme dhe me interes që të miratohet një ligj i veçantë që “Trepçës” t’i krijohet e drejta e menaxhimit dhe vendimmarrjes së pavarur në mënyrë që disa njësi aktive do të mund të punojnë dhe gjenerojnë vende të punës dhe zhvillim në interes të punëtorëve, por edhe të shoqërisë së mbarë, si për shembull Miniera Stan-Tërg me Flotacionin në Tunelin e Parë, Kompleksi i minierave Artanë - Hajvali, me Flotacionin, në Kishnicë, kompleksi i minierave Bello-Bërdo - Cërnat, me Flotacionin, në Leposaviq, Metalurgjia e Plumbit, Elektroliza e Zingut, Industria Kimike e të tjera.

Është i domosdoshëm një bashkëveprim i Kuvendit, Qeverisë, Dhomës së Veçantë të AKP-së dhe menaxhmentit të “Trepçës”, që të gjendet modeli më i përshtatshëm për arritjen e këtij qëllimi.

Unë edhe një herë falënderoj menaxhmentin e “Trepçës” në krye me ushtruesin e detyrës së drejtorit, zotin Halil Çela, si dhe ekspertët, në krye me profesor Shyqri Kelmendin, për bashkëpunimin dhe furnizimin me materiale të bollshme dhe të rëndësishme, të cilat unë i kam shfrytëzuar në fjalën time.

Të nderuar deputetë,

Duke besuar në përkushtimin tuaj në gjetjen e zgjidhjes për tejkalimin e kësaj situatë specifike dhe të vështirë për “Trepçën” bëj thirrje për një debat të hapur, të argumentuar dhe që në fund ta votojmë rekomandimin që obligohet Qeveria e Kosovës që në afat prej 90 ditëve ta sjellë në Parlament për miratim Ligjin e veçantë për “Trepçën”. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e përfaqësuesit të Qeverisë. Fjalën e ka ministri Beqaj.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit!

I nderuari nënkryetar i Kuvendit,

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë,

I nderuari deputet Ferati,

Më lejoni t’ju falënderoj për ngritjen e një debati të tillë lidhur me funksionimin dhe interesin të cilin e ka Ndërmarrja “Trepça”, por para se të bëj shpjegimin në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, më lejoni të them që kompetencat e Qeverisë së Republikës së Kosovës, mbi kompaninë “Trepça” janë të limituara në nivel të krijimit të politikave afatgjata, të strategjive afatgjata, ndërsa për funksionimin dhe operimin e brendshëm, menaxhimin e saj të përditshëm, vendimet menaxheriale i merr AKP-ja, prandaj do të ishte logjike që sot në debat të ftohej edhe përfaqësuesi i AKP-së i cili do të mund të jepte shpjegime shtesë lidhur me operacionet, sepse nga momenti kur ne i kemi aprovuar këto ligje në Kuvend, ligje të cilat e kanë përcjell përgatitjen e “Trepçës” për t’u shndërruar në ndërmarrje shoqërore, tani kompetenca është e AKP-së dhe AKP-ja mund të sjellë informata të drejtpërdrejta dhe AKP-ja i përgjigjet Kuvendit që në kushte normale do të duhej të merrej informata nga dora e parë.

Si do që të jetë në nivel të Qeverisë, më lejoni t’ju them se është jashtëzakonisht e rëndësishme që sektori minerar të zhvillohet, të krijohen politika të mira dhe ligje të mira të cilat mundësojnë që ky sektor minerar i cili në një kohë të gjatë ka qenë edhe mburrje e zhvillimit ekonomik të Kosovës dhe ka qenë ikonë e zhvillimit ekonomik të Kosovës, të vazhdojë edhe më tutje duke krijuar hapësirë për t’u zhvilluar.

Ministria e Zhvillimit Ekonomik është e përcaktuar si Ministri e cila ka në kompetencë bazën ligjore dhe krijimin e politikave afatgjata dhe këtë e kemi thënë deri më tani disa herë.

Kjo është edhe në vazhden e reformave strukturale të cilat ne i përmendëm më herët për të krijuar një ekonomi të tregut, për të krijuar funksionalizim të ndërmarrjeve të cilat në një formë ose formën tjetër kanë qenë gati po thuaj se të bllokuara, kanë qenë të

bllokuara, siç është rasti i “Trepçës”, sepse kanë qenë me status të veçantë të menaxhuara nga rregulloret e UNMIK-ut, të menaxhuara nga menaxherë ndërkombëtarë, ndërsa ajo çka ishte në interesin tonë ishte që ne të sjellim ligje në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe të hapet rruga që këto ndërmarrje të marrin vendimet e veta, në bashkëpunim me AKP-në.

Ajo çka ne gjatë kësaj periudhe të caktuar, i nderuari deputet, kemi bërë është që të përgatitim bazën ligjore për valorizimin maksimal të këtyre vlerave të resurseve minerare të Kosovës, që nënkupton vendosjen e resurseve, posaçërisht ato të linjitit dhe xeheve të plumb-zinkut në funksion të zhvillimit të mirëfilltë ekonomik.

Ne në këtë kontekst kemi sjell në Kuvend strategjinë minerare të Republikës së Kosovës, strategji e cila është për hapësirën kohore 2012 – 2025, e cila definon qartë se përveç funksionalizimit ka edhe përgatitjen e këtij tregu, përgatitjen e fuqisë punëtore dhe vënien në funksion të zhvillimit ekonomik të gjitha resurseve të cilat kanë të bëjnë me aspektet minerare.

Njëkohësisht, ky Kuvend para pak kohe ka aprovuar ligjin me nismë të Kuvendit, pra me nismë të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Ligjin për minierat e mineraret i cili realisht është aprovuar në Kuvend dhe pret aprovimin dhe dekretimin nga presidentja e Republikës së Kosovës, i cili pastaj do të mundësojë që Qeveria të hapë edhe procedura të reja jo vetëm për kompaninë “Trepça”, por edhe për ndërmarrjet e tjera. Por, ligjet të cilat ne i kemi sjell këtu në Kuvend, të cilat realisht na kanë mundësuar që “Trepça” të fokusohet në mënyrë shumë të qartë dhe të trajtohet si ndërmarrje shoqërore: janë Ligji për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Ligji për Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe Ligji për organizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre.

Dua të them se Ligji për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre, është Ligji për “Trepçën”, atëherë Qeveria ka menduar dhe kjo është diskutuar gjer e gjatë në Kuvend, është diskutuar edhe nëpër grupet parlamentare që ne nuk kemi pasur nevojë të bëjmë një ligj të veçantë për një ndërmarrje të veçantë, por të bëjmë një ligj i cili do të na mundësonte edhe ndërmarrje në të ardhmen të cilat konsideron shteti që janë me interes të veçantë t’i fusim dhe të bëhen pjesë e këtij ligji, pra ligj i cili do të trajtojë riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre që në mënyrë të drejtpërdrejtë i mundëson qasjen strategjike Qeverisë dhe institucioneve të Republikës së Kosovës që të merren me këto ndërmarrje.

Duke marrë parasysh që një kohë të gjatë “Trepça” është menaxhuar nga UNMIK-u dhe nga menaxherë ndërkombëtarë, moratoriumi ndërkombëtar i cili ka sjell probleme për kompaninë dhe marrjen e vendimeve, edhe për kundër angazhimit shumë të madh të buxhetit të Kosovës, për të mbajtur, do të thotë, qoftë në formë të subvencioneve, qoftë në formë stipendioneve të cilat i ka dhënë për punëtorët dhe pensionimin e parakohshëm, është konsideruar se duhet të hapet rruga zhvillimore për këtë kompani dhe këto ligje, realisht e kanë hapur rrugën zhvillimore për kompaninë “Trepça” të cilën ne presim që AKP-ja duhet t’i raportojë Kuvendit për hapat të cilët janë marrë.

Është shumë me rëndësi të thuhet që këto ligje tani këtë moratorium nuk ia lejojnë më që të merret në nivel ndërkombëtar, por merret në nivel vendor, pra vendimin për moratorium të “Trepçës” mund ta marrë ekskluzivisht AKP-ja dhe në bashkëpunim me Gjykatën Supreme, Dhomën e Veçantë, e cila realisht mund të sjellë vendime të tilla.

Është shumë e rëndësishme të thuhet që në këto ligjet të cilat kjo paketë e ligjeve ka ndërruar strukturën e gjyqtarëve të cilët vendosin për të ardhmen e të gjithë atyre kreditorëve potencialë për “Trepçën”- ju e dini që para aprovimit të këtyre ligjeve shumicën e gjyqtarëve në Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme i kanë pasur ndërkombëtarët, në panele i kanë pasur shumicën ndërkombëtarët dhe ne, pra me ligjin të cilin e kemi aprovuar në Kuvend, është ndryshuar struktura dhe në panel janë kryesisht janë shumica gjyqtarë vendorë dhe në Gjykatë Supreme, do të thotë në Dhomën e Veçantë janë me shumicë gjithmonë gjyqtarët vendorë të cilët marrin vendime për çfarëdo veprimi të “Trepçës”, pra edhe të AKP-së lidhur me këtë ndërmarrje.

Vlen të theksohet që nga buxheti i Kosovës, posaçërisht pas vitit 2007 janë investuar vlera të rëndësishme të cilat kanë mundësuar që kjo ndërmarrje të ringjallet. Dua të them që me menxhmentin e ri të asaj kohe të “Trepçës” ne kemi një rifunksionalizim dhe “Trepça” është sjell në një moment kur ajo ka krijuar edhe profite të veta dhe ka pasur mundësi të investojë. Pra, nga një subjekt ekonomik i cili ka marrë vetëm në mënyrë të drejtpërdrejtë subvencionim nga shteti dhe ka gjetur diku rreth 800 punëtorë në atë kohë, flas për vitin 2007 – 2008, kjo ndërmarrje sot nuk punëson më 800 punëtorë, por punëson 1 500 punëtorë dhe gjatë kësaj periudhe të menaxhimit i cili është bërë në mënyrë të drejtpërdrejtë nga institucionet vendore dhe njëkohësisht edhe nga menaxhmenti vendor, i cili është për t’u falënderuar gjatë kësaj periudhe të caktuar ka krijuar një vlerë të shtuar të kësaj ndërmarrje dhe kjo ndërmarrje jo vetëm që i ka trajtuar punëtorët e vet të vjetër, por ka filluar ta rigjenerojë fuqinë punëtore dhe të rigjenerojë edhe mjete, të hyra dhe të bëjë kontrata afatgjata të cilat janë sot të plasura në tregun ndërkombëtar. Pra, flasim për një ngritje të kësaj ndërmarrje, flasim për vlerat e shtuara të kësaj ndërmarrje, flasim për eksportin që kjo ndërmarrje ka bërë dhe punësimet të reja të cilat kjo ndërmarrje i ka bërë.

Edhe më tutje kjo ndërmarrje mbetet larg asaj se çka ne presim të gjithë në Republikën e Kosovës, sepse konsiderojmë që duhet të jetë boshti kurrizor i zhvillimit të sektorit minerar dhe kjo është rruga në të cilën ne shpresojmë që AKP-ja konform ligjeve në fuqi brenda një periudhe të caktuar do t’ia sjellë Kuvendit, do t’ia sjell edhe Qeverisë hapat se si do ta bëjë ristrukturimin e kësaj ndërmarrjeje dhe në çfarë forme ka idenë për të krijuar një vlerë shtesë.

Është theksuar shumë edhe çështja e punëtorëve të “Trepçës”, punëtorëve të cilët kanë pasur një stazh dhe kanë qenë të larguar, unë do të them në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, se ne jemi duke shikuar në mënyrë të detalizuar që stazhi i punëtorëve të cilët kanë qenë të larguar në vitin 1989 dhe të cilët kanë qenë ikonë edhe e fillimit të ndërrimeve demokratike në Republikën e Kosovës, t’u njihet ai stazh nga Qeveria e Kosovës dhe këta do të thotë t’i marrin të gjitha benefitet sikurse edhe punëtorët tjerë. Prandaj, në këtë kontekst, përgjegjësitë e Qeverisë janë këto, unë e ftoj

edhe Kuvendin, por edhe AKP që është institucion që i përgjigjet Kuvendit, që të sjellë sa më shpejt planin e saj të veprimit në mënyrë që ne të qartësohemi dhe të hapim mundësi.

Unë mund të them se Qeveria konform këtij plani do të garantojë dhe do të merret edhe me ndihmat tjera buxhetore shtesë të cilat janë të nevojshme në mënyrë që të krijohen punësime. Synimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës është punësimi sa më i madh, krijimi i ndërmarrjeve të qëndrueshme, krijimi i bazës që këto ndërmarrje të jenë partnerë të qëndrueshëm dhe afatgjatë për zhvillimin ekonomik në nivel të vendit, por edhe në nivel ndërkombëtar.

Edhe një herë, e falënderoj deputetin për ngritjen e këtij debati. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, fjalën e ka zoti Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Zoti ministër,

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës mirëpret edhe këtë debat, edhe çdo iniciativë tjetër që ka për qëllim zbatimin, mbështetjen në zbatimin e ligjeve të cilat i ka miratuar ky Parlament, kohë më parë dhe aq më tepër kur është fjala për funksionimin e kompanive që janë aq të rëndësishme për ekonominë e vendit tonë.

Ju e dini që pas një kohe, pas një periudhe të gjatë tanimë “Trepça” është në një fazë krejtësisht tjetër dhe falë ligjit të cilin e kemi aprovuar, me një kërkesë të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, në vitin 2005, që nga viti 2006 “Trepça” ka qenë nën mbrojtjen e vendimit të moratoriumit të lëshuar nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, e bazuar me një rregullore të UNMIK-ut 2005/48, stërzgjatja e këtij memorandumi ka rezultuar me zhvlerësimin e asetëve me kosto të lartë të mirëmbajtjes, sigurim të asetëve pasive për deri sa për asetet aktive memorandumi ka qenë pengesë për tërheqjen e investitorëve, për zëvendësimin e teknologjisë së vjetruar dhe për rritjen e prodhimitarisë.

Kjo status-quo ka zgjatur 7 vjet dhe ka qenë barrë edhe për buxhetin e Kosovës dhe ka pamundësuar shfrytëzimin racional të pasurive natyrore si plumbi dhe zinku, ka vështirësuar situatën ekonomike sociale dhe nuk ka dhënë zgjidhje për problemet e trashëguara mjedisore.

Nevoja për investime jo buxhetore kërkonte ristrukturimin e “Trepçës” dhe si bazë për këtë ishte edhe plotësimi i bazës ligjore ekzistuese.

Duke qenë se kjo situatë ishte e tillë e u mundësua hyrja në fuqi e Ligjit për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara në nëntor të vitit 2011. Më lejoni vetëm t’ju lexoj për të shpjeguar rëndësinë e këtij ligji dhe po ashtu edhe për të shpjeguar se pikërisht ky ligj ka qenë për të dalë nga ky moratorium, për t’i hapur rrugë “Trepçës” dhe menaxhmentit për

të bërë afarizëm pozitiv dhe për të dalë nga gjendja, e cila ishte e bllokuar edhe për shkak të pretendentëve kreditorë nga jashtë.

Në termin shpjegues- riorganizim të këtij projektligji thuhet: ristrukturimi profesional i borxheve apo i operacioneve afariste të një ndërmarrjeje që në mënyrë të arsyeshme pritet se do të kthejë qëndrueshmërinë e ndërmarrjes si një e tërë dhe në të ardhmen dhe që do të mundësojë shlyerjen e kërkesave dhe interesave në pajtim me këtë ligj.

Pra, ligji në fjalë presim që të gjejë implementim edhe më të shpejtë, ju e dini një kohë goxha të gjatë kemi pasur mungesë edhe të bordit dhe kjo ndoshta edhe muajt e fundit ka qenë edhe pengesë për funksionimin normal ose implementimin e këtij ligji të planeve të menaxhmentit.

Fatmirësisht, këto ditë kemi rezultatet e para të funksionimit të bordit, kemi sot më duket në media, në shtypin ditor edhe konkursin për drejtorin e ri, ju e dini që kjo ndërmarrje ka kohë që funksionon me një ushtrues detyre.

Ajo që si Grup Parlamentar dëshiroj të them se herë pas here po përballemi edhe me raporte të tilla ose debate të tilla ku në fakt do të duhej të raportonin këtu agjencitë që janë përgjegjëse edhe për hartimin e politikave, edhe përgjegjëse për menaxhimin e ndërmarrjeve ose të sektorëve të ndryshëm. Ndoshta, ne duhet të mendojmë në të ardhmen edhe për mënyrën e raportimit, për mundësinë që në Kuvend të raportojnë edhe zyrtarë që janë përgjegjës, plotësisht përgjegjës për funksionimin e institucioneve të caktuara.

Më lejoni të përmend po ashtu edhe një raport të ekspertëve gjermanë të privatizimit i cili i angazhuar dhe kanë dhënë disa rekomandime për të cilat ne si Grup Parlamentar shpresojmë se do të implementohen. Në këtë raport, përveç tjerash, thuhet se duhet të dihen ose të definohen prona dhe titullarët e “Trepçës” dhe të dihen obligimet e “Trepçës” ndaj kreditorëve, duhet të dihet vlera e aseteve të “Trepçës” që nënkupton regjistrin e aseteve dhe vlerësimin e të njëjtave, rezervat minerale që megjithëse janë pronë e Republikës së Kosovës, i japin vlerë “Trepçës”, të definohen cilat janë obligimet mjedisore dhe sociale të “Trepçës”?

Në rastin e “Trepçës” parakusht për çfarëdo planifikimi të biznesit është pra të dihen pasuritë, obligimet, si ato kreditorë mjedisore dhe sociale, sa është borxhi total i “Trepçës” ndaj kreditorëve, çfarë do të bëhet me të punësuarit, si do të riorganizohen vendet e punës, si do të menaxhohen mbetjet, a do të paraqesin ato obligim apo kapital për “Trepçën” e tjerë?

Pra, këto janë disa çështje, të cilat i ka ngritur Grupi i Ekspertëve dhe për të cilat mendojmë se menaxhmenti, por edhe AKP-ja, si titullarë duhet të përkujdesen në zbatimin e tyre.

Më lejoni për fund të them e fokusohem në tri çështje për të cilat ne si Grup Parlamentar jemi të gatshëm dhe të interesuar që sa më shumë të ketë fokus. Te projektet kapitale

bordi i AKP-së duhet të inkurajohet që t'i mbështesë të gjitha propozime e "Trepçës" për projektet kapitale me të cilat synohet të rritet produktiviteti dhe qëndrueshmëria financiare e "Trepçës" dhe vlera e ndërmarrjes, pastaj te plani i ristrukturimit, AKP-ja si administratore e "Trepçës" në pajtim me ligjin numër 4-035 për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre të shtojë kapacitetet njerëzore që të përgatitë planin sa më të më të realizueshëm për riorganizimin e "Trepçës dhe te mikromenaxhmenti, ne mendojmë që duhet AKP, meqenëse ligji i precizon shumëçka, por AKP nuk duhet të mikromenaxhojë "Trepçën". Drejtori menaxhues duhet të ketë edhe kompetenca edhe përgjegjësi për veprimet e veta dhe jo si deri më tani për çdo riprokurim të vogël të merrte pajtim nga një njësi e veçantë, nga një menaxher apo edhe nga Bordi i AKP-së dhe ndonjëherë edhe nga Gjykata Supreme.

Pra, qoftë edhe nëse duhet nisma e ndryshimit, ne jemi të gatshëm që të punojmë në këtë drejtim që "Trepça", menaxhmenti i "Trepçës" të ketë mundësi sa më të mëdha të operojë e menaxhojë për çështje që ata konsiderojnë se janë të rëndësishme për afarizmin e kësaj ndërmarrjeje.

Ne na gëzon fakti se në çdo vit kemi pasur rritje të prodhimit dhe shpresojmë që me plotësimin e bordit të AKP-së kjo ndërmarrje të mund të ecë edhe më shpejt dhe të mund të bëhen zgjidhje sa më të shpejta për afarizëm sa më të mirë.

Dhe po ashtu kërkoj që për çështjet tilla, të debateve të tilla, herë pas herë që të shfrytëzohen edhe rrugë tjera, partitë politike, grupet politike duhet të kërkojnë më shumë edhe brenda komisioneve të ketë raporte të këtyre ndërmarrjeve në mënyrë që t'i shterim sa më shumë që është e mundur informatat dhe brenda komisioneve funksionale dhe të jemi në seanca sa më shumë të përgatitur me informata direkte. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Pajazit! Fjalën e ka zoti Ali Sadriu.

ALI SADRIU: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Kam kënaqësinë që sot të kemi rastin të diskutojmë për statusin dhe veprimtarinë e një ndërmarrjeje që dikur ishte prijatë e gjithë proceseve ekonomike në Kosovë dhe potencialin me të cilin disponon mendoj se i ka të gjitha kushtet që edhe më tutje të jetë njëri prej motorëve kryesorë të ekonomisë.

Shënimet e mia bazohen kryesisht deri më 8.6.2011 dhe ato bazohen në bazë të raporteve që i ka dorëzuar Zyra e Auditorit Gjeneral, nuk kemi asnjë arsye të kontestohen. Në atë takim ka marrë pjesë edhe kryetari i Bordit, i ndjeri Dino Asanaj, i vrarë apo i vetëvramë dhe në fund do t'ua lexoj edhe procesverbalin e diskutimit të tij që flet lidhur me "Trepçën".

Mendoj se Qeveria e Kosovës dhe Kuvendi janë vonuar në nxjerrjen e një ligji të veçantë për çështjen dhe trajtimin e "Trepçës", duke pasur peshën e tij në të kaluarën dhe pretendimet për të ardhmen.

“Trepça”, siç e tha edhe ministri, trajtohet si një ndërmarrje shoqërore, pra nuk është kompani publike. Menaxhimin e saj e ka udhëhequr UNMIK-u në një kohë dhe pastaj ka kaluar në kompetencat e AKP-së.

Është çështje që vërtet donë trajtim serioz. “Trepça” deri në datën që ju thashë, ka operuar dhe vazhdon të operojë si dy Trepça - “Trepça” e veriut dhe e jugut.

Qëllimisht rrjedhat e procesit na diktojnë se është lënë në një dy binarë që të mund të operojë , me gjithë veprimtarinë që e ka pasuar më vonë.

Është shumë indiaktive dhe shumë simptomatike se Qeveria e bën një involvim në menaxhmentin dhe veprimin në punën e “Trepçës” kur i ndanë subvencione dhe subvencionet i kushtëzon që nuk do të marrë as jugu nëse nuk i merr veriut.

Por si e kemi gjendjen në veri? Në veri as Zyra e Auditorit Gjeneral nuk ka arritur të bëjë ndonjë raport asnjëherë, përkundër asaj që në vitin 2011 gojarisht i është premtuar se do t’i mundësohet qasja në veprimet, gjegjësisht në pasqyrat financiare për të parë performansën e asaj pjese, realisht, nuk ka ndodhur asnjëherë.

Pjesës së veriut i është bërë, dhe unë do t’i lexoj disa të dhëna, në bazë të informatave që i ka nxjerr Zyra e Auditorit gjatë auditimit të vitit 2010 dhe 2011.

Edhe ne Komisionin për Mbikëqyrje të Financave Publike, po ashtu, ju thashë se kjo është diskutuar dhe është trajtuar në prezencën e bordit të AKPM-së, më datën 8.6.2011.

Nga raporti i auditorit për vitin 2010 dhe të raportit 2011, vërehet se menaxhmenti i ndërmarrjes shoqërore “Trepça” dhe e Bordi i Agjencisë Kosovare të Privatizimit, ende nuk kanë arritur të forcojnë sistemin e kontrollit të brendshëm dhe menaxhimin financiar të drejtë të funksionimit si tërësi, përfshirë ndërmarrjen e saj thelbësore si një organizatë unike.

Pra, ndërmarrja shoqërore “Trepça” nuk funksionon as sot si tërësi, ajo është e ndarë në dy pjesë. Në mungesë të formës së bashkëpunimit nga pjesa veriore e “Trepçës” dhe kufizimet në fushën e auditimit të përgjithshëm dhe menaxhimit nga ana e Bordit të AKPM-së, nuk ka mund dhe nuk ka konkluzione mbi menaxhimin e financave dhe kontrollit në pjesën veriore të “Trepçës”, pra është errësirë për ne, nuk dimë kurrëgjë.

Prandaj, edhe përqendrimi për rekomandimet e dhëna të KZAP-it i dedikohen pjesës jugore dhe me theks kryesor si rekomandim kryesor që AKPM-ja me Qeverinë të bëjnë gjithçka, pra të nxirret një ligj i veçantë që të detyrohet që pjesa e veriut të jetë nën menaxhimin dhe përcjelljen e AKPM-së.

Pjesa veriore e “Trepçës”- menaxhmenti i “Trepçës” veriore për vitin 2010 dhe 2011 ka treguar gatishmëri bashkëpunimi, atë që u thashë me fjalë, por realisht nuk ka ndodhur kurrë.

“Trepça” në veri ka trend pozitiv të hyrave, derisa në vitin 2011 të hyrat janë në vlerë prej 13 milionë e 939 mijë e 385 euro, në krahasim me vitin 2010, ku kishte 13 milionë e 94 mijë e 838 euro.

Kryesisht, këto janë nga shitja e koncentreve që kanë ndodhur. Është shumë interesante se koncentratet shiten përmes një tenderi ndërkombëtar përkundër kërkesës së AKPM-së se kjo procedurë do të duhej të shkojë përmes AKPM-së si organ, si kupolë e menaxhmentit që duhet ta këqyrë edhe pjesën jugore dhe veriore. Pra, përkundër kësaj, ata shpallin tender, shesin koncentre, koncentratet transportohen me pajime të strukturave ilegale, flas këtë pjesë në bazë të shtypit që e kemi mësuar të gjithë ne, nëpër territorin jugor dhe nuk ka asnjë pengesë. Shtrohet pyetja, ku është policia, ku është Qeveria, ku jemi ne?

Për ma keq, thashë te subvencionet, të marrim në vitin 2011, janë ndarë gjithsej për “Trepçën” 5 milionë e 210 mijë e 303 euro. Është shumë interesant se nuk i janë dhënë as jugut meqë derisa nuk i jepen edhe veriut. Qeveria pra tregohet shumë solidare në dhënien e subvencioneve edhe pse nuk kemi asnjë kontroll fare ku po shkojnë ato dhe çka po ndodh, megjithatë në pjesën veriore shkojnë 2 milion e 369 mijë e 672 euro, në pjesën jugore shkojnë 2 milionë e 840 mijë e 331 euro. Pra, këto janë mjete që janë ndarë, subvencione që merren për ta ndihmuar veprimtarinë e Trepçës.”

Është shumë interesant se këto mjete nuk shpenzohen asnjë euro për investime kapitale, këto shpenzohen për paga, mëditje, mallra dhe shërbime.

Auditori ka nxjerrë disa rekomandime dhe kryesisht i referohet pjesës jugore, meqë s’ka pasur qasje në pjesën veriore. Vëren se ka një ndryshim pozitiv nga viti 2010, në vitin 2011, në trajtimin e rekomandimeve të dhëna, ka një përmirësim, sepse prej 9 rekomandimeve që janë dhënë, 2 i ka trajtuar, 3 i ka në shqyrtim, të tjerat ende s’ka startuar. Pra, edhe këtu kemi dobët, por megjithatë krahasuar me jugun, është një ndryshim shumë i madh.

Cilat janë mangësitë që më tutje auditori i konsideron si çështje që do të duhet urgjentisht të adresohen.

1. Menaxhimi i të ardhurave.
2. Të hyrat nga shitja e koncentratit të plumbit, zinkut, aluminit dhe sulfurit.
3. Të hyrat nga qiratë.
4. Procedurat e prokurimit të zhvillohen në harmoni me ligjin, gjë që s’ka ndodhur në vitet paraprake, prandaj jep rekomandim që këtu të forcohet.
5. Menaxhimi i personelit.
6. Funksionimi i kontrollit të brendshëm.
7. Dobësia kryesore ka të bëjë me bashkëpunimin ndërmjet dy pjesëve që e tejkalon kompetencën edhe të AKPM-së...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Edhe një minutë, ose dy, derisa ta përmbyllë diskutimin.

ALI SADRIU: Po kaloj pra te procesverbali i deklaratës së të ndjerit, Dino Asanaj.

Raporti i Auditorit të përgjithshëm për vitin 2009 kishte 9 rekomandime. Nga këto rekomandime autori ka konstatuar, 2 janë adresuar, 3 janë në proces, 4 prej tyre nuk janë adresuar.

Theksimi i çështjes ka të bëjë me AKPM-n, nuk ka arritur të ketë qasje në veri. Pra, drejtori deklaroi se s'kam asnjë qasje në veri. Drejtori i pjesës veriore ka deklaruar me shkrim se vazhdon ta ndjejë veten si i menaxhuar nga UNMIK-u.

Më 2011 për herë të parë AKPM është munduar që të kushtëzojë me kontratë subvencionet, por i është thënë se nuk do t'i marrë as jugu nëse nuk i merr edhe veriu, po e thotë Qeveria dhe Qeveria i ndanë mjetet.

AKPM-ja ka shpallur shitje për mbeturinat, kanë bërë tender ndërkombëtar. Në një moment të shpalljes së shitjes AKPM-ja ka reaguar publikisht duke thënë se “Trepça” është nën monitorim dhe vetëm Oda e Veçantë ka të drejtë leje për shitje. AKPM ka alarmuar të gjithë institucionet duke shtuar se këtu edhe reagimi i menjëhershëm që të ndërmerret një aksion i EULEX-it dhe policisë, e ka kuptimin gjatë shitjes së koncentratit, për shkak se kjo veprimtari bazohet në mënyrë joligjore. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese lidhur me këtë i trajton të gjitha ndërmarrjet shoqërore si pasuri e Republikës së Kosovës.

Ky është procesverbali i të ndjerit, të vetëvrarë me shumë thika, nuk jam kompetent për ta vlerësuar, por lë shumë për të dyshuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, fjalën e ka nënkryetari Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: Faleminderit, kryesues!

“Trepça” pa dyshim që ka qenë dhe mbetet njëra prej ndërmarrjeve më të rëndësishme të vendit tonë, rëndësia e saj nuk kufizohet vetëm në aspektin e ekonomik dhe potencialin e saj prodhues, por shkon deri në rrafshin politik.

Në “Trepçë” në njëfarë mënyrë filloi edhe rrënimi i ish- Jugosllavisë. Ishin minatorët e “Trepçës” ata që në nëntor të vitit 1988, marshuan drejt kryeqytetit në shenjë revolte ndaj diskriminimit social dhe politik jugosllav që u bëhej shqiptarëve, si dhe kundër praktikave të egra eksploatuese të “Trepçës” nga Beogradi.

Dhe atëherë kur Serbia u ngrit hapur për të na e mohuar edhe autonominë, minatorët e “Trepçës” ishin ata që u sakrifkuan, duke u ngujuar dy herë thellë në horizontin e nëntë të minierës, për ta kundërshtuar okupimin serb që fillimisht atëherë nisi me ndryshimet kushtetuese.

Institucionet tona duhet t'iu jenë përherë mirënjohëse këtyre heronjve tashmë të harruar pa të drejtë, minatorët kanë nevojë për përkujdesje institucionale e jo për lëvdata retorike, sepse lëvdata retorike kanë marrë boll.

Në të kaluarën “Trepça” ishte institucioni më i rëndësishëm ekonomik dhe prodhues në Kosovë. Në të vërtetë “Trepça” ishte kombinat që përbëhej nga një konglomerat prej rreth 40 minierave, fabrikave dhe ndërmarrjeve të ndryshme. Ajo përfshinte një rrjet ndërmarrjesh në të cilat kishte llojllojshmëri të prodhimeve si dhe në të cilën punonin mbi 20 mijë punëtorë.

Prandaj, “Trepça” përbën themelin e zhvillimit ekonomik dhe industrial që Kosova e përjetoi sidomos gjatë viteve '70 edhe përkundër eksploatimit që i ndodhte nga ana e Serbisë.

Vetëm në vitin 1983 “Trepça” eksportoi mallra me vlerë prej 103 milionë dollarëve, që krahasuar me vlerën e sotme është trefishi apo katërfishi i dollarëve të sotëm, duke u radhitur kështu në mesin e 5 të eksportuesve më të fuqishëm të ish-Jugosllavisë. Për 58 vjet të punës prodhuese, Kombinati i “Trepçës” ka prodhuar 33 milionë tonë xehe.

Pas suprimimit të dhunshëm të autonomisë së Kosovës, nga Serbia, në 1989 filluan të aplikoheshin masat e dhunshme, siç dihet, prandaj me mijëra punëtorë shqiptarë në “Trepçë” i humbën vendet e tyre të punës, “Trepça” u shndërrua në një ndërmarrje të uzurpuar, e cila iu nënshtrua një keq shfrytëzimi dhe shkatërrimi konsistent nga regjimi serb. Ajo u mbyt në borxhe si dhe përjetoi kontrata të dëmshme gjatë kohës së Millosheviqit, duke ia kaluar në shfrytëzim gjysmën e kësaj ndërmarrje kompanive të huaja, të cilat edhe sot e kësaj dite pretendojnë pronësi të caktuar mbi një pjesë të “Trepçës”.

Pas tërheqjes së trupave ushtarake dhe policore serbe, si dhe pas hyrjes së trupave të NATO-s në Kosovë, si dhe instalimit të administratës së UNMIK-ut në vitin 1999, qytetarët menduan se tash ishte koha për rikthimin e lavdisë së dikurshme të “Trepçës”.

Njerëzit me të drejtë pritën që “Trepça” të revitalizohej, ta rifillonte punën dhe punëtorët t'i ktheheshin prodhimit.

Por, kjo nuk ndodhi, dhe unë çuditë se si ministri e konsideron si sukses, duke thënë që në “Trepçë” menjëherë pas luftës punonin vetëm 800 punëtorë, kurse tash punojnë nga 1 400 apo 1 500, krahasuar me atë që ka ndodhur në “Trepçë” dikur, kjo nuk do të merret absolutisht si sukses, por si dështim.

Dhe që 14 vjet “Trepça” ka mbetur peng i një vendimi të padrejtë politik e kjo është ndarja e Mitrovicës, pikërisht për shkak se u nda Mitrovica, u nda edhe “Trepça” dhe prodhimi në njëfarë mënyre pushoi.

Për shkak se “Trepça” ishte ndërmarrja kryesore që mundësonte punësimin dhe mirëqenien e familjeve të Mitrovicës, jo rastësisht pas luftës Mitrovica është qyteti i

vetëm në Kosovë të cilit iu ka zvogëluar edhe popullsia. Prandaj “Trepça” është një argument themelor pse Mitrovica duhet të bashkohet, përveç argumenteve tjera.

Politikat e mbrapshta të UNMIK-ut e çuan “Trepçën” drejt pasivizimit dhe shkatërrimit, kurse politikat e qeverive tona e çuan “Trepçën” drejt likuidimit dhe privatizimit.

Për shkak të politikave qeveritare të cilat synojnë shitjen e lirë dhe të shpejtë e përplot parregullsi të çdo pasurie publike, “Trepçës” po i përgatitet fati i Distribucionit të KEK-ut si dhe ai i PTK-së.

Ashtu sikurse çdo ndërmarrje tjetër publike, edhe “Trepça” iu nënshtroa një kolonizimi të vazhdueshëm nga njerëzit e partisë në pushtet. Udhëheqja e “Trepçës” është e kontrolluar partiakisht. Këta njerëz kanë krijuar një rrjet brenda “Trepçës”, bile që dyshohet se merret me aktivitete ilegale të cilët duhet të jenë objekt i hetimeve policore dhe procedurave të drejtësisë. Një prej këtyre aktiviteteve të dyshuara për të cilin është folur shumë dhe të cilin duhet ta ketë parasysh policia dhe drejtësia, është edhe dyshimi se ka shitje ilegale të prodhimeve të “Trepçës”.

Lëvizja “Vetëvendosje”, mendon se “Trepça” nuk duhet të privatizohet, sepse ajo përbën një resurs shumë të vlefshëm në aspektin ekonomik si dhe shumë të rëndësishëm në kuptimin strategjik.

Sipas një analizë që kanë bërë ekspertët tanë të kësaj fushe, nëse në “Trepçë” do të investoheshin rreth 177 milionë euro, e kjo do të mund të bëhej për nja 2-3 vjet, kjo ndërmarrje do të revitalizohej si dhe do të krijoheshin së paku 8 mijë vende të reja të punës.

Justifikimi i Qeverisë se nuk kemi para, është justifikim i paqëndrueshëm, Qeveria për asfalt po i jep nja 200 milionë euro për çdo vit, kurse për “Trepçën”, për ta rivitalizuar nuk paska para. Prandaj, nuk është puna te mungesa e parave, por te një koncept i gabuar ekonomik që e përfaqëson kjo Qeveri aktuale.

Ekspertët tanë kanë llogaritur se pas investimit të 177 milionë eurove dhe fillimit të prodhimit masiv të produkteve minerare, vetëm në vitin e parë nga ky prodhim do të mund të krijohej një qarkullim prej 400 milionë eurosh.

Fushat në të cilat do të investoheshin këto 177 milionë euro janë: xehetaria, metalurgjia e plumbit, metalurgjia e zinkut, industria kimike, si dhe rregullimi i çështjeve sociale të punëtorëve të “Trepçës”.

Në këtë mënyrë, edhe do të ndërtonim infrastrukturë e do të shtronim asfalt, edhe do të krijojmë vende pune të reja të punës dhe mirëqenie më të lartë, edhe do të revitalizohej “Trepça”.

Nëse e shikojmë prodhimin e “Trepçës” nga perspektiva e tregjeve botërore, kuptojmë se ajo përbën një potencial tejet strategjik për zhvillim meqenëse në bursat botërore çmimet e metaleve kanë një rritje progresive të vlerës së tyre.

Përveç dhjetëra metale të ndryshme që prodhohen në “Trepçë” aty gjendet edhe indiumi, një metal kryesor që përdoret në teknologjinë e sotme touch-screen dhe çmimi i të cilit gjatë 20 vjetëve të fundit është shumëfishuar dhe kështu pritet do të ndodhë vazhdimisht në të ardhmen.

Prandaj, zhvillimi industrial i Kosovës është i mundshëm vetëm në qoftë se “Trepça” në pronësi publike do të prodhonte, siç ka prodhuar dikur: plumb, zink, argjend, ar, bizmut, kadmiumit e më vonë edhe indium dhe metale tjera të rralla, si dhe të kualitetit të lartë.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kryetari i Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, edhe një herë!

Mendoj se duhet ta kthejmë fjalën pak, ta rrotullojmë prej fundit, Grupi Parlamentar i Aleancës do ta mbështetë mocionin e propozuar sot nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Sidoqoftë, mendojmë se është pak ndoshta gati e përealizueshme që të kërkohet prej Qeverisë që ta sjellë një ligj, do të ishte më mirë që kjo të ishte një nismë legislative të cilën do ta diskutonim dhe ndoshta do të kishte ardhur një ligj si duhet.

Mendoj se janë bërë shumë gabime, që në kohën kur Qeveria e Kosovës ka filluar të ketë kompetenca më të mëdha në menaxhimin e ndërmarrjeve shoqërore dhe publike dhe do t'i kthehem pak kësaj teme shumë shkurt se çka po mendoj me këtë të drejtë që e ka pasur.

Fillimisht, ju e dini se Kosova ka pas Ministri të Energjisë e të Minierave dhe Qeveria aktuale e ka parë të arsyeshme ta heqë. Është tepër interesant të thuhet se nëse në Kosovë vazhdimisht përsëritet se energjia, do të thotë, thëngjilli dhe minierat janë pasuritë tona më të mëdha dhe i ndërtojmë 19 ministri dhe nuk kemi Ministri të posaçme e cila merret me këtë temë, është e qartë se tregohet prioriteti, tregohet si janë vendosur prioritetet. Është krejt e kotë të thuhet në foltore të Kuvendit ose në konferencë për shtyp se Qeveria ka prioritet të lartë ose prioritet kryesor zhvillimin e sektorit të minierave, e në këtë rast, po flasim për “Trepçën”.

Mendoj se nuk ka të bëjë fare me atë realitet për të cilin ne po dëgjojmë këtu që të flitet.

Tani, po dua të kthehem pak te kjo çështja e kompetencave të Qeverisë. E di që shumica dërrmuese e deputetëve e kuptojnë, e po e shoh që ministrat nuk janë këtu, e di që është keq për të patronizuar nganjëherë, domethënë për të mbajtur ligjëratat, mirëpo kur e dëgjon një ministër- thotë diçka që nuk ka të bëjë fare me të vërtetën qysh është

konceptuar qeverisja në Kosovë, aty të shkon mendja se ndoshta duhet për t'ia përsëritur, për t'ia thënë: a të kujtohet ndonjëherë që kemi diskutuar kështu?

Në demokracitë parlamentare, nëse Qeveria thotë që Kuvendi i ka kompetencat ose është punë e Kuvendit, ose është përgjegjësi e Kuvendit e jo e jona, është më së pakti cinizëm.

Zoti nënkryetar i Kuvendit,

Në demokraci parlamentare populli e zgjedh Kuvendin, ndërsa Kuvendi nga radhët e veta, me shumicë e zgjedh Qeverinë. Qeveria dhe deputetët të cilët e votojnë Qeverinë janë një dhe duhet të jenë, edhe mbikëqyrja parlamentare, është farsë të mendohet që opozita e bën mbikëqyrjen parlamentare, pra duhet ta bëjnë ata deputetë që e kanë zgjedhur Qeverinë, ta mbikëqyrin a mos po abuzon me votën e tyre që ia kanë qitur, a mos po abuzon me votën e popullit?

Pse po i them krejt këto? Ministri e tha një fjali. Ai tha që AKP-ja është përgjegjësi e Kuvendit dhe Qeveria ka kompetenca të limituara kundrejt “Trepçës” për shkak se i bën vetëm politikat dhe diçka strategjike, kështu, ta parafranoj, shumë përafërsisht.

Po vetë kjo Qeveri e ka propozuar Bordin e AKP-së. Edhe deputetët e partive në pushtet i kanë votuar, për shembull, jo vetëm këtë rast, por në të gjitha rastet edhe kështu edhe duhet të jetë. Unë po pajtohem, nuk po e kontestoj sistemin, mua më pëlqen ky sistem, por nuk po më pëlqen qysh po sillen njerëzit brenda sistemit. Nëse një ministër tash thotë- ne nuk kemi kompetenca, veç për t'ia bërë do strategji, do politika, se AKP-ja i ka, e Kuvendi e ka zgjedhur AKP-në me propozim të tyre, është më së pakti cinizëm.

Po sidoqoftë, hajt se po supozojmë për një minutë që ka të drejtë çka po thotë ministri, dhe po thotë na duhet bërë veç do politika, do strategji, e cilat i kanë bërë që 5 vjet? A kanë bërë ndonjë send? Domethënë, edhe nëse po ia pranojmë që veç atë pjesë e ka, domethënë, krejt të limituar, që nuk e njeh ministri drejtorin e AKP-së, që nuk e ka të partisë së vet, që nuk ka dëgjuar kurrë për të, që ka ardhur prej Hënës ai, edhe nëse ashtu mendojmë prapë, hajde cilat strategji, cilat politika i keni bërë, pra?

Qysh se është shpallur pavarësia e Kosovës, të njëjtit njerëz janë në pushtet, me një dallim LDK-ja ka qenë, nuk është më, po këtë resor e ka udhëhequr e njëjta parti, me disa ndryshime.

Cilat politika, cilat strategji i kemi sot që të na kallëzoj ministri çka po bëhet me “Trepçën”? Dhe, çka ndodh në Kuvendin e Kosovës, deputetët i thërrasin miqtë e vet që i kanë në “Trepçë”, ata iu shkruajnë nga 6 faqe se sa prodhon “Trepça”, sa ka prodhuar në vitet 70, dhe i lexojnë, dhe derdhin lot të krokodilit për punëtorët e “Trepçës” dhe për Kosovën që s'po prodhon.

Po çka po bëjmë, çka po bën Qeveria? Mendoj se këto mënyra të punës, ekskluzivisht prej Qeverisë së Kosovës, dëshmojnë një gjë, nuk ka as gjasa teorike e lëreni më praktike që me këtë mendësi për të prodhuar as strategji, as politika afatgjata, as afatshkurtra e

lëreni më ndonjë ligj normal. Mendoj se këtu kemi ndërthurje të këqija të interesave të cilat nuk mund të sjellin kurrgjë hiq.

Thashë edhe një herë në fillim, po them edhe një herë, ne do ta mbështesim këtë mocion. Shpresojmë që Qeveria do ta prodhojë një ligj brenda 90 dite për “Trepçën”, por në të njëjtën kohë edhe më shumë shpresojmë që ai ligj do të jetë ligj i zbatueshëm dhe i mirë, e jo ndonjë ligj për të cilin pra do të ballafaqohemi në mes veti këtu dhe për t’u ndarë prapë.

Unë dyshoj se do të ndodh diçka, domethënë, ky dyshim i imi është i bazuar në ato që i thashë më përpara, 5 vjet nuk bën kurrgjë, dhe për 90 ditë do të bësh, është pak absurd, sidoqoftë, për të shpresuar është mirë.

Mendojmë se shprehjet se Kosova nuk e meriton, punëtorët nuk e meritojnë, janë krejt fraza. Duhet dikush të punojë, të bëjë diçka, të prodhuar diçka dhe atëherë për të debatuar rreth atij produkti dhe për t’u ballafaquar. Po më duket që kemi mbërri në një pikë kur po e dimë edhe vetë se çka është kah ndodh në këtë konstalacion forcash politike, sidomos në Qeverinë e Kosovës, nuk mund të prodhojë diçka. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Gjini! Fjalën e ka zonja Selmani, kryetarja e Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, i nderuari nënkryetar i Kuvendit!

Përshëndetje për deputetët,

Do të ishte e rrugës që ministri i Zhvillimit Ekonomik, sot së paku të jetë këtu, për arsye se drafti i projektligjeve vijnë po nga kjo Ministri. Edhe pse ndërmarrja “Trepça” është nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, prapëseprapë, sipas të gjitha gjasave ai ministër është dashur të jetë prezent gjatë gjithë kohës së debatit sot këtu me ne.

Në rast se e shohim çështjen e statusit të sotëm të “Trepçës”, si ndërmarrje nën administrimin e AKP-së dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit, me ligjin e pakos së presidentit Ahtisari, i ka të gjitha kompetencat dhe është definitivisht nën kontrollin e Kuvendit të Kosovës, atëherë u kërkua edhe nga parafolësit më parë që do të ishte e rrugës edhe ata të ishin sot prezentë, jo ndoshta atje ku është ministri, por të ishin mbrapa dhe të dëgjonin gjithë debatin për “Trepçën” dhe në fund të dinin se çka të vendosim në të ardhmen.

Ne e dimë mjaft mirë se në mars të vitit 2006 asetet e “Trepçës” kanë qenë të vendosura me një vendim nën moratorium, i cili u vazhdua edhe me 26.1.2011 nga Dhoma e Posaçme, në bazë të kërkesave që është marrë vendim dhe disa njësi punuese të “Trepçës” janë liruar nga moratoriumi dhe ato sot funksionojnë. Si funksionojnë, u tha shumë këtu, mirëpo duhet të dimë se po ky Kuvend, po ky legjislacion në vitin e kaluar miratoi 3 ligje, pakon e 3 ligjeve të AKP-së, ligje të cilat dhanë definicione më të qarta për Agjencinë Kosovare të Privatizimit; Ligjin për riorganizimin e ndërmarrjeve dhe Ligjin, i cili tregoi situatën si do të zhvillohet në çështjen më të ndjeshme, ndoshta në të

cilën atakohet edhe vetë “Trepça” si ndërmarrje shoqërore, Ligjin e gjykatës, në të cilën duhet të rregullojmë ndoshta këtë çështje. Mirëpo, në rast se e shohim funksionimin e “Trepçës” brenda këtij moratoriumi të ngritur, atëherë veprimet të cilat duhet t’i marrim ne si Kuvend, Qeveria dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit, që është duke bashkëpunuar me një grup të ekspertëve, mirëpo u tha edhe këtu pak më parë se çështja e moratoriumit ka hyrë ndoshta edhe shkaku i obligimeve kreditore të “Trepçës” duhet të kihet kujdes që me zbatimin e pakos së ligjeve të cilat janë miratuar në këtë Kuvend dhe me çështjen e këtij vendimi të moratoriumit të shihet se ku dhe si do të veprojë “Trepça” në të ardhmen, që të nxjerrim ligje pas Ligjit të minierave dhe mineraleve të cilin e kemi miratuar po në këtë Kuvend dhe një strategjie minerare, unë do të kërkoja edhe nga ministri, edhe nga AKP-ja, e cila është kompetente tash pas formimit të bordit të saj që në këto grupe punuese që i ka formuar, Grupi punues për çështje të kontabilitetit dhe financave, Grupi punues për caktimin dhe vlerësimin e rezervave të xeheve dhe Grupi punues për çështje ligjore, Grupi punues për menaxhim të çështjeve mjedisore dhe sociale që të vijë me një përfundim sa më të shpejtë apo me një konkludim të përbashkët të gjithë këtyre grupeve dhe të tregojë se edhe cilat njësi apo edhe cilat ndërmarrje tjera të cilat e përbëjnë “Trepçën” mund të largohen nga ky moratorium.

Në rast se ju kujtohet, edhe në amendamentimin të këtyre tri ligjeve të cilat kanë ardhur në pako, Aleanca Kosova e Re i pati dhënë sugjerime te veta, mirëpo sugjerimet nuk shkuan në atë masë çfarë e kërkuam ne.

Shpresoj dhe besoj shumë që edhe Qeveria, edhe Kuvendi dhe njëkohësisht Agjencia Kosovare e Privatizimit, pasi e kam në fuqi akoma vendimin e moratoriumit të datës 26.1.2011 nga Dhoma e Posaçme, që tregojë saktësisht kur dhe si mund të veprojë “Trepça” si një ndërmarrje profitabile për qytetarët e saj?

Ne mund të luajmë politikisht secili subjekt në vijat politike çfarë mendon, mirëpo duhet të kemi kujdes me vendimet të cilat janë nxjerrë nga Dhoma e Posaçme dhe të thuhet saktë në këtë datë, në këtë ditë dhe me këto ligje pas funksionimit të ligjit për riorganizim, që dihet saktë kah po shkon “Trepça” dhe kah po shkon Kosova me sektorin minerar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Unë propozoj që të shkojmë në pauzë të drekës, pra tash është ora 13:30 dhe pauza zgjat si zakonisht, deri në orën 15:00, ose një orë, nëse ju doni. Janë të paraqitur për diskutim edhe 18 veta. Vazhdojmë në orën 15:00.

Vazhdimi i mbledhjes pasdite

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, zoti. Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Vazhdojmë. Fjalën e ka deputetja Justina Shiroka- Pula.

JUSTINA SHIROKA- PULA: Faleminderit, kryetar!
Zonja dhe zotërinj deputetë,

Dëshiroj të ri shpreh mendimin dhe qëndrimin tim rreth vizionit që duhet të përkrahet për kompleksin “Trepça”, si aseti i fundit i madh i mbetur akoma në pronësi të popullit të Kosovës.

Është koha e fundit që të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës, përfshirë këtu Kuvendin, të mendojnë në nivelin e kërkesave të kohës dhe të popullit, të mendojnë vërtet për zhvillimin ekonomik që duhet për ta nxjerrë Kosovën nga kriza ekonomike, që tashmë konsiderohet gati një situatë normale dhe pa shpresë për rritjen e punësimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm, përndryshe do të mbetemi edhe për shumë e shumë vite të fundit në rajon dhe Evropë për nga niveli i të ardhurave për banorë.

Nëse dështojmë me “Trepçën” siç kemi dështuar me faljen e ” Ferronikelit” si resurs strategjik dhe me privatizime të tjera, nuk e di se në cilin resurs tjetër do të mund të mbështesim zhvillimin ekonomik afatgjatë. Dhe atëherë do të jetë turp i madh për të gjithë ne kur ata këshilltarë ndërkombëtarë që na shtojnë të bëjmë të gjitha privatizimet dhe faljet e aseteve strategjike, do të na quajnë mbase edhe një Republikë- model bananesh, në jug të Evropës, por atëherë do të jetë vonë, shumë vonë dhe turp.

Pajtohem me qasjen se zhvillimi real dhe i qëndrueshëm ekonomik mund të vijë vetëm nëpërmjet të tërheqjes së investimeve private dhe një rol adekuat të shtetit në një ekonomi të tregut, me rregulla perëndimore. E theksoj këtë, ekonomi tregu me rregulla dhe transparente. Jo një ekonomi të ashtuquajtur tregu pa rregulla dhe që shkatërron ekonominë dhe varfëron popullin duke menduar vetëm për palën tjetër private.

Për këtë kërkohen që të zbatohen disa parime tashmë të konfirmuara në mbështetje të suksesit, shkurt, këto parime për mua janë:

1. Zhvillimi ekonomik kërkon tërheqjen e investimeve private vendore dhe të huaja.
2. Mjedis i investimeve duhet të jetë i përshtatshëm dhe procedurat të jenë transparente dhe konkurruese.
3. Asetet dhe resurset strategjike që i kemi nuk duhet të falen apo të jepen me çmime simbolike.
4. Qeveria dhe investimet publike, kapitale të mbështetura edhe me kredi nga institucionet zhvillimore ndërkombëtare duhet të kenë rol mjaft të rëndësishëm, po të kemi parasysh edhe kushtet aktuale të ekonomisë dhe financave botërore.

Këto katër parime që i citova në mënyrë implicite kanë qenë dhe janë parime të zbatuara në hartimin e programit të Qeverisë të PDK-së ku unë kam qenë ministër, por edhe të kësaj Qeverie që e kemi sot.

Çështja është se sa këto parime zbatohen në procesin e privatizimit që i kemi pasur këto vite.

Për sektorin e minierave, si ministër gjatë 2008-2010, këto parime janë reflektuar në draft-strategjinë për sektorin minerar si dhe programin e zbatimit të saj.

Strategjia aktuale minerare i përfshin parimet, por institucionet nuk i zbatojnë ato.

Për “Trepçën” u miratua një ligj që nuk ka gjasa të çojë aq shpejt drejt suksesit, pra drejt tërheqjes së investimeve në kuadër të partneritetit publik- privat dhe zhvillimit të ciklit të plotë të nxjerrjes dhe përpunimi i minerareve, të plumbit, zinkut e tjera. Përkundrazi, ligji që ky Kuvend e ka miratuar, i ka hapur rrugë arritjes së pretendimeve të investitorëve të para vitit 1989, në “Trepçë”.

Prandaj, duhet të angazhohemi për një ligj dhe strategji të veçantë, apo të avancuar për “Trepçën”.

Unë nuk besoj që institucionet ndërkombëtare e kanë nxjerr tashmë mësimin se qëndrimet dhe ndërhyrjet e tyre e kanë vonuar apo e kanë dështuar deri tani procesin e rimëkëmbjes dhe zhvillimit të sektorit minerar.

Ne duhet të mësohemi të sillemi si zot shtëpie në Kosovën tonë, duhet të punojmë për zhvillimin e saj, jo për të shpronësuar atë.

Në vitin 2010 ne si institucion vendor përgatitëm një model bashkëkohor për ristrukturimin e “Trepçës” dhe tërheqjen e investimeve private në të si partneritet publik-privat, model që tash është dëshmuar i suksesshëm në disa vende të botës. Kundër qasjes tonë për “Trepçën” ishin ICO, jo zyrtarisht sepse nuk guxuan ta bënte këtë, sepse nuk kishte edhe argumente, tani ICO ka ikur duke na lënë vite prapa, duke na lënë me këtë ligj që nuk na ofron zgjidhje sa ne kërkojmë të arrijmë për zhvillimin e “Trepçës”. Të huajt dhe interesat e disave prej tyre kanë arritur të na vonojnë në procesin e duhur të “Trepçës”, dhe jo vetëm të “Trepçës”.

Unë shpresoj që Qeveria të zbatojë ato që janë paraqitur në programin e saj, sa i përket “Trepçës”. Resurset në “Trepçë” nuk mund të privatizohen, sepse edhe Kushtetuta nuk e parasheh këtë, por ato mund të jepen në përdorim tek investitori me kushtet më të mira për Kosovën. Por këto parime madhore të Kushtetutës, fatkeqësisht nuk i kanë parasysh institucionet përkatëse.

Unë kam besim se jo vonë do të bëhet ajo që me minatorët dhe e gjithë Kosova pret të ndodhë rreth zhvillimit të “Trepçës”. Nuk ka më kohë për propagandë, nuk ka më kohë për të humbur, është koha që të gjithë së bashku për një kauzë të përbashkët, të drejtë, kauzën e mundësisë së zhvillimit të ekonomisë dhe të “Trepçës”.

Duke i marrë fatin e “Trepçës” në duart tona, më shumë do të na respektojnë edhe ata që fillimisht nuk kanë qenë dakord me ne për motive nga më të ndryshme.

Këtë herë po flas si ekonomiste, duke u bazuar në parametrat makroekonomike dhe trendët e zhvillimit ekonomik. Së pari, duhet të zhvillojmë strategji për ristrukturimin e “Trepçës” dhe si strategji zhvillimore duhet të kemi ca objektiva bazë nga të cilat duhet të dalin konkluzionet dhe rekomandimet dhe unë këtu do të propozoj disa faza të

parapërgatitjes apo të shprehjes së objektivave për të cilat mendohet se janë të domosdoshme.

Objektivi i parë, të cilin unë e propozoj, mendoj se duhet të bëjmë shqyrtimin dhe analizën e të gjitha opsioneve të mundshme për ristrukturimin e “Trepçës” dhe të identifikojmë opsionin më të përshtatshëm për të arritur transformimin e duhur të bizneseve fitimprurëse të cilat investime private, me dhe apo me partneritet publik- privat mund të zhvillohen me sukses.

Objektivi i dytë, të identifikohen dhe para vlerësohen të gjitha potencialet ekonomike të aktiviteteve kryesore fitimprurëse në kuadër të “Trepçës”, dhe

Objektivi i tretë, duhet të bëhet përgatitja e planit konkret të masave dhe aktiviteteve që duhet të ndërmerren nga institucionet vendore të shoqëruara me afate kohore për realizimin e aktiviteteve dhe caktimin e institucioneve përgjegjëse përkatëse.

Duke u bazuar në studime dhe eksperiencë të ndryshme të vendeve të tjera, dhe duke u bazuar në hulumtimet dhe në studimet aktuale, të cilat janë bërë në “Trepçë”, unë i kam marrë opsionet dhe i kam nxjerrë disa rekomandime që shpresoj se do të jenë të rëndësishme për “Trepçën” dhe për Kosovën.

Si rekomandim i parë, mendoj se riaktivizimi dhe zgjerimi i aktiviteteve të “Trepçës” kërkon patjetër investime të konsiderueshme. Këto investime mund të vijnë nga sektori privat dhe sektori publik.

Ky investim kapital të sektori publik mund të sigurohet nëpërmjet bankave zhvillimore ndërkombëtare.

Si rekomandim i dytë, propozoj që ristrukturimi i “Trepçës” mund të realizohet nëpërmes krijimit të shoqërive aksionare, fillimisht me pronarë Republika e Kosovës, shoqëri këto pa borxhe të vjetra pretenduara.

Në bazë të studimeve janë identifikuar gjashtë aktivitete biznesore për të cilat mund të themeloheshin gjashtë shoqëri aksionare, të cilat në perspektivë mund të hyjnë edhe në ndonjë proces të mëvonshëm të partneritetit.

Dhe, rekomandimi i tretë, ka të bëjë apo duhet të bazohet në eksperiencën më të mirë të vendeve ndërkombëtare, konkretisht jam bazuar në shtetin gjerman dhe në kompaninë URS të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Sipas dokumenteve të tyre ata propozojnë të studiohen mundësitë e krijimit të një kompanie të veçantë mjedisore që do të merret direkt me eliminimin e...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Regjia, ia vazhdoni fjalën.

JUSTINA PULA-SHIROKA: ...duke punësuar, në këtë kompani të punojnë aktualisht të gjithë ata të cilët nuk janë në gjendje të punojnë në miniera.

Si rekomandim i katërt, procesi i ristrukturimit të “Trepçës” duhet të paraqitet dhe realizohet në kuadër të planit integral të aktiviteteve të definuara, plan ky i cili duhet të miratohet paraprakisht nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe të mbështetet e të aprovohet në Kuvend.

Thirrja ime është që ky diskutim që e bëjmë sot në Kuvend për “Trepçën” duhet të vazhdojë, Kuvendi duhet të marrë rolin vendimtar për këtë aset strategjik të veçantë dhe problematik.

Prandaj mendoj që duhet të krijojmë një strukturë apo një mekanizëm ndërpartiak dhe ndërinstitutional që t’i mbështesim institucionet relevante dhe të gjejmë rrugën më të mirë për ristrukturimin e “Trepçës”.

Kosova mund tani të tërheqë investime private serioze dhe t’i kombinojë ato sipas nevojës mbi investimet publike nëpërmjet kredive të buta nga BERZH-i dhe të tjera institucione financiare ndërkombëtare si Banka Botërore, AECI dhe Evropiane dhe bankat tjera, duke vepruar njëjtë si të gjitha shtetet në zhvillim që i kanë marrë në duart e tyre fatet e zhvillimit të resurseve të tyre strategjike. Kjo është imperativ për të ardhmen e “Trepçës”. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nënkryetari Sabri Hamiti e ka fjalën.

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit.

Zotërinj ministra,

Kolegë deputetë,

Të gjithë e mbajnë në mend, ata që janë më të ri edhe ata edhe të vjetrit edhe më shumë, parullën e famshme kundërdhënëse dhe pavarësiste që vinte dikur si formulë e ekonomisë nga “Trepça”: “Trepça punon, Beogradi ndërton”.

Pra, nëse kjo ka qenë jo vetëm motivim për aktivizëm politik pavarësist, po edhe logjikë ekonomike, atëherë kjo mund të përkthehej sot: “Trepça” punon, Kosova fiton”.

E pra, nëse është kështu dhe nëse deklarohet edhe në bisedimet e sotme deri këtu, që është një aset i pazëvendësueshëm, një burim fuqie gjeneruese ekonomike për Kosovën, kujdesi për “Trepçën” për më tepër koncentrimi i institucioneve të Kosovës, që ky aset të bëhet prodhimtar, dobiprurës për ekonominë e Kosovës, duhet të bëhet institucion.

“Trepça” në Mitrovicë, prodhimi i energjisë elektrike në Obiliq jo vetëm se kanë qenë tradicionalisht dy pasuritë më të mëdha gjeneruese ekonomike të Kosovës, por ajo që për mua dikur ka qenë është edhe sot, rëndësi e veçantë është se këto dy pika kanë pas prodhuar edhe atë që quhet “inteligjencë teknike në Kosovë”, e cila është në fuqinë e krijimit dhe sot, dhe unë i përmend këto dy asete, atë që quhet e natyrës dhe kjo e njeriut,

të cilat duhet të kombinohen, duhet të jenë në simbiozë në mënyrë që ne të kemi një përparim në këta lëmenj.

Tash, sa i përket Obiliqit, ju e dini që tash jemi në një fazë gati paradoksale të zhvillimeve nga projektimet dhe nga ndodhitë, është mirë që për “Trepçën” të bisedohet sot dhe bisedohet në mënyrë racionale që të gjendet zgjidhja e saj. Dhe zgjidhja e saj, menjëherë po them, qoftë për rekomandimin që e kemi, hartimin e një ligji për “Trepçën” duhet të bëhet qoftë edhe ky akt legjislativ vetëm dhe vetëm në konsultim, për të mos thënë, edhe një sponzorim dhe shkrim direkt, kodifikim të ekspertëve të fushës të cilët ekzistojnë në Kosovë dhe janë shumë të mirë, qofshin ata momentalisht që në një mënyrë janë të implikuar në prodhimin ose drejtimin e “Trepçës” ose ata që tash s’janë atje, nuk është me rëndësi.

Çfarë dua të them? Dua të them që duhet të krijohet ligj për “Trepçën” për dy arsye themelore. Një, për t’i krijuar status ligjor dhe dy, për ta ruajtur.

Nën kodifikimet që e prekin “Trepçën” të tillë si është tash, ne e kemi një dispersim të çuditshëm, nëpërmes ligjeve për ndërmarrjet publike diku, nëpërmes implikimit të Qeverisë, siç e deklaroi edhe ministri, ndërmjetshëm përmes strategjisë afatgjate, por jo konkrete, nëpërmes AKP-së që administrojnë, që është prapë absurd, se AKP-ja nuk ka pse ta rezervojë.

(Ndërhyrje)

A i thonë Agjencia e Kosovës për Privatizim? A është ai institucion? Po s’mund e paragjykon këtë. Pse të jetë, pandalshmërisht ta bëjë kjo...

(Ndërhyrje)

Unë po i dëgjoj do ligjvënës të mëdhenj, që po më gjuajnë fjalë- ligji.

Po, prandaj duhet të bëhet ligj tjetër. Për sy të zinj s’po e lypim ligjin. Po ligjin e bëjnë njerëzit dhe nevojat. Ligjet i bëjnë nevojat, kërkesat, zhvillimet, kështu që Oda e Veçantë.

Pra, kemi disa pika implikimesh të niveleve ligjore, nënligjore, organizative që implikohen në “Trepçë” dhe kanë krijuar një tollovi, një pamundësi të koncentruar të zhvillimit.

Dhe, kjo puna e ligjeve - ligjeve që i kemi, mos harroni se shumica janë derivime të një administrimi arbitrar ndërkombëtar të ekonomisë së Kosovës dhe duhet të mbarojnë trashëgimitë e tilla. Dhe ne, nëse dom ta marrim atë që e quajta unë parullë të kënaqshme të sotme dhe e pranojmë bashkërisht që: “Trepça punon, Kosova fiton”, atëherë kjo legalizohet, ligjësohet, kodifikohet në të gjitha aspektet, edhe si status edhe si organizim dhe si mbrojtje, po e them edhe një herë. Dhe ju e dini mirë pse e them si mbrojtje, e dinë edhe më mirë ata që janë të implikuar në “Trepçë” sot.

Sepse, edhe një herë po kthehem te ajo që unë po e quaj “inteligjencë teknike”, që duhet të implikohet në “Trepçë”. Duhet njëherë e përgjithmonë të thuhet hapur, sa ka pasuri aty dhe çka ka? Thuhet, plumb e zink, po shkohet, argjend e ar, dhe shkohet dhe tutje. Dhe nuk është mirë që të flitet me figura, po duhet, është koha të thuhet saktësisht çka ka “Trepça”.

Është punë tjetër ligji, unë e përshëndes diskutuesen para meje e cila e përmendi rolin e Kuvendit. Në pasuritë e tilla, definitivisht me ligj duhet të implikohet Kuvendi. Ne kërkojmë këtë ligj të implikohet Kuvendi rreth “Trepçës” dhe Qeveria, natyrisht, ligjërisht, mbasandaj vijnë modalitetet e zhvillimit, strukturimi, mënyra e parapamjes së strukturimit dhe mundësitë e zhvillimit, me çfarë investimesh, publike apo private.

Prandaj, unë e mbështes kërkesën e Ligjit të posaçëm për “Trepçën”. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka Alma Lama.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

“Trepça” dhe gjendja e saj aktuale, të cilën do ta cilësoja si “gjigantin e gjunjëzuar” është pasuria e Kosovës, që gjithkush tjetër e shfrytëzoi, përveç popullit të Kosovës.

Pasuria e saj është arsyeja se pse sot Beogradi po këmbëngul që të mos largohet nga veriu. Ekspertët kanë vlerësuar se “Trepça” kushton miliarda euro.

New York Times në 1998 shkruante: “Mitrovica është zona më e pasur minerale e tërë Evropës, këtej maleve Urale, copa më e vyer e Ballkanit, me vlera miliarda dollarë, miniera e parë për plumb dhe zink, miniera e tretë për nga madhësia që prodhon: ar, argjend, kadium, cirkon e tjerë.

Lufta në Kosovë është lufta për minierat e Mitrovicës, Mitrovica është “Kuvajti i Serbisë”. “Minierat në Mitrovicën Veriore, përfaqësojnë 3/4 e pasurive potenciale minerale të Jugosllavisë”, shkruhej në atë kohë. Madje, edhe në vitin e bllokadës ekonomike të Jugosllavisë, në 1996, ato sollën rreth 100 milionë dollarë fitime”.

“Trepça” është e vetmja pasuri që ende nuk është falur apo shitur, por gjendja e saj është munduar të ndërlikohet në mënyrë të pazgjidhshme.

Lista e pronarëve dhe pretendentëve për këto miniera e shpjegon mirë lojën që është luajtur dhe po luhet në Kosovë. Aksionari i parë i këtij “Kuvajti serb” pas aneksimit të Kosovës dhe pasurive të saja nga Slobodan Milosheviqi ishte Beobanka me ish- drejtor pikërisht Slobodan Milosheviqin. Deri në ‘90 i tërë minerali i Mitrovicës përfundonte në Rusi dhe njeriu që kontrollonte lidhjet ruse ishte pronari i Inex-Interexport-it, ambasadori i Jugosllavisë në Moskë, Borisllav Milosheviqit, pikërisht vëllai i Slobodan Milosheviqit.

Që në ditët e para të pasluftës u shfaqen kompanitë e para që firmosen kontrata blerjesh të aksioneve me Jugobankën, në një kohë që de jure Mitrovica ishte nën administrimin e UNMIK-ut.

Më 14 qershor 1999, erdhi në Jugosllavi drejtori i SCMM-së tregtari më i madh i argjendit të Mitrovicës, Jean Pierre Rozan dhe bleu 51% të aksioneve të “Trepçës” nga Jugobanka. Në shtator ai firmosi kontratën për shfrytëzimin e “Trepçës” me drejtorin e caktuar nga Beogradi, serbin Novak Bjeliq, shkruan “Le Monde”, në 1 shtator 1999, për të vazhduar më tej SCMM-së dy vjet përpara ju shtua firma TEC Ingeniere.

Kontratat Mytilenos, i kishte firmosur me Jugobankën e Milosheviqit dhe Genex-in e Çernomyrdinit. Vetëm në '97 kjo kompani kishte paguar 509 milionë dollarë.

Po i sjell të gjithë këta shembuj, për të kuptuar se si kanë shkuar çështja e pronësisë dhe shfrytëzimit të “Trepçës”.

SCMM- TEC Ingenierie - Trigaduri - Genex - Mitlenos - Jugobanka- Beobanka, ky është rrethi vicioz , kur shtetet përkatëse të këtyre kompanive i lyejnë vazhdimisht ingranazhet të politikës së vendeve përkatëse dhe e mbajnë peng Mitrovicën prej 14 vjetësh.

Është më se e qartë se Serbia jo vetëm ajo ka interesa të fuqishme në këtë pjesë të Kosovës, nuk është e vetme, janë edhe shtetet e tjera të cilat projektojnë të shqyejnë sa më shumë që të mundën nga pasuria e “Trepçës”.

Prandaj, unë shtroj pyetjen, përse qeveritë e Kosovës, asnjëherë nuk u morën seriozisht me “Trepçën”, për ta rivënë në punë? Kosova është në një gjendje të dëshpëruar ekonomike dhe nevoja për pasurinë e saj është më e madhe tani se kurrë.

“Trepça” ka nevojë për investime për t’u rivitalizuar. Kosova tashmë ka privatizuar pjesën më të madhe të ndërmarrjeve shoqërore, sapo shiti edhe PTK-n. Paratë e këtyre shitjeve disa mbeten jashtë Kosovës, ndërsa të tjera shkojnë për investime krejtësisht jo strategjike.

Pse këto para nuk u përdoren kurrë për të investuar aty ku vërtet është e leverdishme, aty ku prodhohet? A ka qenë e mundur që gjatë këtyre viteve “Trepça” të ishte vënë në punë?

Unë mendoj se po, mirëpo dyshoj se interesa shumë të mëdha e kanë bllokuar këtë proces, me qëllimin për t’ia ulur vlerën “Trepçës” që më pas të jepet në shfrytëzim apo të shitet për një vlerë shumë më të ulët.

Qeveria e Kosovës nuk duhet të lejojë që dallaveret dhe transformimet e pronës në kohën e Milosheviqit, të vazhdojnë të dëmtojnë ekonominë e Kosovës edhe sot pas 14 vjetësh. Asnjë iniciativë nuk është marrë deri tani për të adresuar problemet ligjore, sepse kam përshtypjen se qeveritarët po presin edhe vetë të shqyejnë ndonjë copë nga pasuria e “Trepçës”.

Aktualisht ka shumë kompani ndërkombëtare që kanë shprehur interes dhe po llobojnë fuqishëm, jo publikisht, tek krerët më të lartë të shtetit, që ta fusin në dorë “Trepçën”. Por, ky gjigant ende nuk është pjesë e një strategjie serioze ekonomike e cila do ta bënte funksionale dhe unë mendoj se kjo nuk po ndodh rastësisht. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Time Kadrijaj e ka fjalën.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryetar!

Deri në vitin 1989 “Trepça” ka funksionuar si ndërmarrje e përbërë e punës së bashkuar brenda së cilës kanë vepruar 27 subjekte të pavarura ekonomike apo organizata punuese.

Në nivelin e ndërmarrjes së përbërë të punës së bashkuar, pra në nivelin e Kombinatit, kanë qenë të deleguara vetëm funksioni i komerciales, shitja e produkteve dhe blerja nga tregu i jashtëm, funksioni i hulumtimeve shkencore, funksioni kreditor, financiar dhe sistemi unik kompjuterik.

Të gjitha funksionet tjera, organizative, prodhuese, menaxheriale, financiare, komerciale, njerëzore e tjera, kanë qenë të realizueshme në nivelin e organizatave punuese. Obligimet ndaj furnitorëve, obligimet ndaj bankave, kreditimet afatshkurtra, obligimet kreditore, kreditë afatgjata në të gjitha elementet tjera të afarizmit të ndërmarrjeve, janë realizuar në harmoni me ligjet e kohës, pa implikimin e nivelit të përbashkët, pra pa ndikimin dhe implikimin e nivelit të Kombinatit. Këtu qëndron sot edhe një nga shkaqet e qasjes së gabuar ndaj “Trepçës” të cilën qasje e ka imponuar UNMIK dhe të cilët heshtazi apo pa kriter e kanë pranuar strukturat qeverisëse vendore.

Pra, obligimet të cilat i vihen në barrë “Trepçës” sipas UNMIK-ut janë krijuar në një periudhë të administrimit të plotë të “Trepçës” nga Qeveria e Serbisë, pas vitit 1992 dhe janë të bashkuar në një thes, si një faturë e cila i ngarkohet Kosovës.

Çështja e privatizimit dhe e borxheve të “Trepçës” sot ende trajtohen si një realitet dhe “Trepça” ka mbetur peng i këtij qëndrimi. Shtylla e Katërt dhe AKM-ja prej fillimit krijuan konfuzion sa i përket nivelit të borxheve prej miliona eurosh në kohën e fundit edhe shifra astronomike, tërësisht të pabazuara. Në këtë vit AKM-ja ka përgatitur një pasqyrë të përafërt lidhur me kërkesat e paraqitura deri më tani ndaj “Trepçës”. Numri më i madh i pretenduesve ka të bëjë me kërkesat individuale për pronë, pagat e papaguara dhe me obligimet në emër të kontributeve dhe tatimeve.

Gjatë kësaj periudhe kohore, pra prej vitit 1950 e deri në vitin 1989, ku u suspendua autonomia e Kosovës, “Trepça” ka poseduar me tërë pasurinë e “Trepçës”, kanë qeverisur dhe disponuar atë mëvetësisht dhe në mënyrë krejtësisht të pavarur, natyrisht duke pasur gjithmonë parasysh se kjo pasuri aso kohe ishte në pronësi shoqërore.

Ishin këto të drejta ekskluzive dhe të patjetërsueshme të punëtorëve të “Trepçës” dhe të askujt tjetër. Pra, as të organeve shtetërore të cilat të drejta mjerisht iu uzurpuan atyre me dhunë. Në këtë drejtim, me vendimin e Qeverisë së Serbisë “Trepça” në vitin 1992 u transformua në shoqëri aksionare.

Pas vendosjes së masave të dhunshme të “Trepçës” nga Kuvendi i Serbisë dhe përjashtimit të punëtorëve shqiptarë nga puna në kuadër të Kombinatisë “Trepça”, pra në kuadër të Organizatës së Përbërë të Punës së Bashkuar, bëhen ndërime të shumta dhe substanciale, si organizative ashtu edhe statusore, të cilat nuk kanë pasur mbështetje as në ligjet e aplikueshme në Jugosllavi. Ndër këto më skandaloze dhe pa mbështetje ligjore, por me pasoja të mëdha, konsiderohet vendimi i Qeverisë së Serbisë më datën 27.11.1991 për ristrukturimin dhe organizimin e “Trepçës” si ndërmartje shoqërore unike, me të cilin vendim organizatat punuese brenda sistemit “Trepça” e humbin subjektivitetin juridik dhe bëhen njësi punuese të një kompanie unike dhe të centralizuar, gjithnjë nën mbikëqyrjen dhe udhëheqjen e fortë nga Qeveria e Serbisë.

Problemi lidhur me borxhet e “Trepçës” ashpërsohet në vitin 2003, pasi që kompania bullgare “Shinto” e padit “Trepçën” e konstituuar pas luftës në Kosovë, në Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës për mos pagesën e mallit të dërguar në vitin 1995. Dhoma e sjell vendimin në favor të kësaj kompanie dhe gjyqi në Mitrovicë për një ditë e sjell vendimin e ekzekutueshëm.

“Trepça” ankohet në këtë vendim dhe e vërteton se kjo kompani ka lidhur kontratë me “Trepçën” dhe ka dërguar material në kohën kur Jugosllavia ka qenë nën embargon e Kombeve të Bashkuara dhe kjo kompani në fakt ka bërë shkelje të Rezolutës së Kombeve të Bashkuara për çka duhet të dënohet dhe kërkesa e “Trepçës” të refuzohet dhe ky vendim i gjyqit të merret si arsye për vënien e “Trepçës” nën moratoriumin embargo.

Të gjitha obligimet që në çfarëdo mënyre lidhen me Serbinë do të duhej që të shqyrtohen në kuadër të bilancit të ndarjes ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Pas vendosjes së masave të dhunshme të “Trepçës” nga Kuvendi i Serbisë dhe përjashtimit të punëtorëve shqiptarë nga puna në kuadër të kombinatisë “Trepça” punëtorët që janë larguar kanë mbetur pa kurrfarë përkrahje, qoftë materiale po edhe etike, dhe as profesionale.

Andaj, ne sot e përkrahim këtë debat dhe rekomandimin që është dhënë nga Grupi Parlamentar për hartimin e një projektligji, i cili do të jetë një projektligj që vërtet do të jetë në favor edhe të kombinatisë “Trepça” por edhe të punëtorëve që punonin në këtë kombinat. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Sabri Hamiti.)

SABRI HAMITI: Fjalën e ka kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Faleminderit!

Edhe unë do t’i them një tri-katër fjalë.

Të nderuar deputetë,

Ndoshta ishte një fjali e ministrit e cila më ka nxitur që të marr fjalën se Agjencia i përgjigjet Kuvendit.

Unë pajtohem që “Trepça” është një nga pasuritë më të mëdha kombëtare të këtij vendi dhe është krejt e natyrshme që të debatojmë dhe marrim vendime të rëndësishme për këtë çështje.

Pak më parë, nënkryetari tha se dikur ka qenë parulla: “Trepça” punon, Beogradi ndërton” e tani do ta bëjmë parullën: “Trepça” punon, Kosova ndërton” që në fakt nuk jemi në atë rrugë, por mund të themi që “Trepça” mund të punojë e dikush mund të fitojë, po kush, nuk e di, por Kosova si po duket jo.

Ky proces i privatizimit, mendoj që ka filluar mbrapsht kur ka filluar dhe ka filluar në kohën e UNMIK-ut, i cili kishte formuar një Agjenci të Mirëbesimit të Kosovës. Mirëpo, kjo Agjenci për të qenë Agjenci e Mirëbesimit të Kosovës dhe tani i privatizimit të Kosovës, do të duhej ta kishte një Agjenci që e mbikëqyrë se si po realizohen kontratat e objekteve të pasurisë që po privatizohen dhe një Agjenci e tillë nuk ka ekzistuar asnjëherë dhe nuk ekziston.

Tash, herë pas herë, topi i gjuhet Kuvendit se Kuvendit i përgjigjet Agjencia Kosovare e Privatizimit, edhe kështu nuk e ka bash krejt emrin shqip. Dhe mendoj që nuk është e sigurtë, në rend të parë “Trepça” si pasuri kombëtare nuk do të duhej t’i lihet një Agjencie, që nuk përbëhet nga njerëz të përgjegjshëm. Në rend t parë, bordi që e merr përgjegjësinë, unë mendoj se nuk përbëhet nga njerëz të përgjegjshëm, nuk përbëhet nga njerëz që kanë kredibilitet profesional, nuk përbëhet nga njerëz që kanë kredibilitet intelektual, nuk përbëhet nga njerëz që kanë kredibilitet politik dhe vendosja e njerëzve të tillë nëpër institucione kaq vitale për vendin dhe për të ardhmen e tij, mendoj që është një papërgjegjësi e madhe.

Prandaj, ne duhet të themi, e kemi privatizuar Ferronikelin, asnjëherë, asnjë ministër, as i Financave as i Ekonomisë nuk ka ardhur këtu të na tregojë se çka Kosova po fiton me privatizimin e Ferronikelit.

Madje, unë në mandatin e kaluar, e kam pyetur kështu në bisedë private ministrin e Financave: çka po fiton Kosova me shitjen e Ferronikelit, pasi ai ka qenë një nga njerëzit që ka marrë pjesë në atë privatizim dhe s’ka mund ta thotë asnjë fjalë.

Unë mendoj që as Qeveria e sotme nuk mund ta thotë asnjë fjalë se çka fiton buxheti i Kosovës nga Ferronikeli, një.

Dy, pra, kohë më parë është privatizuar Distribucioni. Kur krahasohet me gjithë të tjerët, del se vërtet i është falur, edhe pse mund në qarqe të caktuara të flitet se janë dy çmime, një që dihet dhe një që s’dihet. Kjo është një çështje tjetër, kjo është lëndë për hetuesinë që të merret me këto çështje dhe ta vërtetojnë vërtet sa është e qëndrueshme kjo, ose sa s’është e qëndrueshme.

Sot, në një mënyrë folëm për privatizimin e “Valës” dhe na thanë se ka vendim. Unë, të nderuar deputetë, juve dhe opinionit mund t’ju garantoj se nuk ka asnjë vendim ligjor dhe asnjë ligj mbi bazën e të cilit është privatizuar “Vala”.

Kur ka ardhur Ligji për buxhetin e Kosovës për vitin 2011, me të ka ardhur edhe një vendim i Qeverisë, i cili është tërhequr me kërkesën e kryeministrit, pasi në Ligjin për buxhet të financave në vitin 2011 ka hyrë në nenin 4, që mund të privatizohet edhe pse ishte krejt e paarsyeshme, por e ka pasur ligji i vitit 2011 se mund të privatizohet Posta. Mirëpo, në dispozitat përfundimtare të ligjit shkruan qartë se Ligji megjithatë që e ka brenda, është valid deri në mesnatën e 31 dhjetorit të vitit 2011. Pra, me natën e 31 dhjetorit 2011 ai ligj është jo valid, i ka kaluar mandati. Prandaj, kushdo që e mbështet këtë privatizim duhet ta dinë se po e mbështetin një privatizim të paligjshëm dhe unë këtë rast e shfrytëzoj në këtë foltore, për të kërkuar nga Bashkimi Evropian, pasi ata e kanë një trupë të EULEX-it këtu që të na bien prokurorë dhe gjyqtarë më të përgjegjshëm, më profesional dhe t'i hetojnë këto gjëra të paligjshme, se ata po thirren përditë se nuk po zbatohet ligji në Kosovë dhe ne nuk po mund t' i liberalizojmë vizat. Ne po themi, ejani me ekspertë tuaj, atëherë ose legjitimoni ose mos e legjitimoni këtë proces të paligjshëm.

Nuk ka bazë ligjore ky privatizim. Këtë duhet ta dimë të gjithë dhe kushdo që tenton t'i japë bazë ligjore këtij vendimi, s'ka të drejtë. Fuqia e bën të veten, por drejtësi dhe ligj këtu nuk ka. Kjo duhet të jetë e qartë dhe unë po flas më tepër për deputetët që i kam përballë se sa për të tjerët.

Ligj nuk ka dhe unë mendoj që asnjë deputet nuk duhet ta miratojë një diçka që është e paligjshme. Ajo pasuri nuk është e njerëzve që mund të jenë një mandat deputet, a në pushtet. Ajo pasuri është e Kosovës dhe atë duhet ta ruajmë. Ne kemi luftuar për ta ruajtur atë pasuri.

Vijmë te "Trepça", pasuri më të madhe se mineraret që i ka "Trepça" dhe pjesë tjera që i kanë qenë të bashkëngjitur "Trepçës" Kosova nuk ka. Dhe unë mendoj që këtë pasuri nuk mund t'ia lëmë si pasuri shoqërore ta privatizojë Agjencia e Privatizimit. Nëse e bëjmë këtë krim, dhe e mbështesim ne, ta dimë që ne përfaqësuesit e zgjedhur të qytetarëve të Kosovës, po e bëjmë këtë krim.

Nuk di, ndoshta dikush edhe nesër del e mbështet edhe një diçka të tillë, por ne duhet t'u themi: ne e kemi marrë besimin nga qytetarët, ne kemi luftuar për të qenë të lirë në këtë vend, ne domi këtë pasuri ta shfrytëzojmë për të mirën e vendit tonë, për të mirën e fëmijëve tanë.

Nuk guxojmë ne, pse dikush për interesa edhe personale, njerëz janë dhe njerëzit po gabojnë, që t'i marrim ata që e donë këtë vend më shumë se ne. Jo. Unë tash, po dua të flas për veti. Unë 15 vjet kam qenë i dënuar, ka edhe të dënuar tjerë këtu që sot i kanë ra pak pishman, për Kosovën. Kemi qenë në luftë...

(Ndërhyrje)

...e di që po ju djegë dhe po më vjen mirë që po ju djeg, dhe unë mund të them që jo që kam qenë i gatshëm ta sakrifikoj vetveten, kam hyrë diku që kam qenë ndoshta i bindur që edhe familja ime mund të sakrifikohet, por Kosova të jetë e lirë dhe Kosova të fitojë.

Dhe ata që s'u ka munguar kurrë, s'mund ta donë, kushdo që të jenë, në dashi të Evropës, në dashi të Azisë, s'mund ta donë Kosovën më shumë se ne.

Ne po domi të ndërtojmë shoqëri demokratike, shoqëri që bazohet me ligj dhe një shoqëri ku nuk respektohet ligji dhe ku privatizohet pasuria në mënyrë të paligjshme, aty nuk ka perspektivë demokracia, aty nuk kanë perspektivë vlerat evropiane as euroatlantike, prandaj mendoj që duhet t'i thirremi mendjes. Privatizimin e "Trepçës" nuk mund t'ia lëmë një agjencie, ashtu qysh edhe e kemi formuar, kemi njerëz ekspertë, ka edhe këtu që kanë ardhur të na dëgjojnë sot, ka edhe të tjerë që s'janë këtu, ka njerëz që e kanë një përvojë jetësore, ka njerëz që e kanë një përgjegjësi njerëzore, intelektuale dhe kombëtare dhe le ta formojmë një ekip e cila do ta formësojë një strategji të zhvillimit ekonomik, edhe të privatizimit, pse jo, por jo kështu. Ne nëse ia lëmë mund ta lëmë ta hajë ujku edhe "Trepçën", por atëherë kujt po i vjen radha. Atëherë do të na vjen radha neve dhe nuk është mirë. Më mirë është që mos ta lëmë ujku ta hajë "Trepçën", që të mos na hajë edhe neve më vonë. Faleminderit.

KRYESUESI: Deputeti Salih Morina e ka fjalën.

SALIH MORINA: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar ministra,

Unë do të përqendrohem pikërisht tek borxhet e ndërmarrjes së "Trepçës". Mendoj se "Trepça" aktualisht është ndërmarrje administrative e AKP-së dhe statusi i saj i padefinuar vazhdon të mbetet peng i borxheve të pretenduar dhe të privatizimit. Më herët stafi ndërkombëtar të dy këto çështje i ka trajtuar si diçka që duhet të ndodhë doemos.

Sipas të dhënave që disponon AKP, borxhet e pretenduara ndaj ndërmarrjes "Trepça" variojnë nga 50 deri në 250 milionë euro. Këto borxhe nuk janë fiktive dhe mund të jenë edhe disa herë më të larta nëse atyre u shtohet edhe pretendimet e kohëve të fundit që janë tërësisht të pa baza. Borxhet e pretenduara ndaj ndërmarrjes "Trepça" mund të klasifikohen në tri grupe:

Nën 1, borxhet e pretenduara që kanë të bëjnë me kërkesa individuale për pronën, pagat e pa paguara dhe obligimet në emër të kontributeve dhe tatimeve. Në këtë grup hyjnë numri më i madh i të pretenduarve.

Nën 2, kemi një grup të veçantë ku mund të futen kërkesat e kompanive nga Serbia, dhe

Nën 3, i kemi borxhet e pretenduara nga kompanitë ndërkombëtare.

Vendimi për moratorium vazhdon edhe më tutje dhe realisht "Trepça" vepron në një vakum juridik, pa qenë i definuar statusi i saj, i cili e vështirëson afarizmin si etnitet biznesor.

Prandaj, e mbështes kërkesën e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, të cilin e kanë iniciuar, që u tha edhe nga parafolësit tjerë, sepse ka nevojë që Qeveria e Kosovës ta

iniciojë ligjin për “Trepçën”, për këtë gjigant të madh i cili ka bërë shumë për Kosovën dhe shumë ka dhënë për qytetarët e saj dhe vetëm një ligj i tillë mund ta shpëtojë këtë gjigant nga veprimet jo të mira që u thanë edhe nga parafolësit tjerë. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjen e merr kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi.)

KRYETARI: Adem Grabovci, replikë!

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Ne, po debatojmë për një çështje që është edhe një shqetësim për të gjithë. Vërtet, “Trepça” ka qenë dikur gjigant dhe atë rol, unë mendoj që edhe Grupi Parlamentar, se duhet të bëjmë përpjekje të japim kontributin të gjithë që të krijojmë kushte që “Trepçës” t’i kthehet shkëlqimi i dikurshëm, roli dhe rëndësia që e ka pasur dikur për ekonominë jo vetëm të Kosovës. Plotësisht pajtohem me atë parullën, që dikur si në moshë tepër të re, kam dalë nëpër rrugë të Prishtinës dhe kam bërë edhe unë pak përpjekje të bëj për vendin tim, ta qes gjoksin dhe me parullën: “Trepça punon, Beogradi ndërton”. Ajo më ngjall një nostalgji për të kaluarën time krenare, të popullit tim, të vendit tim dhe ndiej kënaqësi dhe krenari shumë të madhe që kam qenë në moshë, po e ritheksoj, me shumë bashkëmoshatarë të mitë, shumë i ri, por kemi pas një vizion shumë të qartë se ku duhet të arrijmë dhe çka meriton.

Këtu u ngrit edhe çështja e privatizimit të PTK-së. Meqë unë parëz isha ndër ata që u thirra në ligje, unë nuk dua as të pretendoj të replikoj apo të debatoj për këtë çështje, unë vetëm po thirrrem në vendimet e këtij Kuvendi.

Më datën 11 tetor të vitit 2012 kemi pasur dy dokumente në këtë Kuvend, një rezolutë nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës dhe një mocion nga tri grupe tjera parlamentare, e cila nuk ka marrë votat e mjaftueshme. Prandaj, kërkohet decidivisht po e lexoj: “Vendimi për privatizimin e PTK-së të sillet në Kuvendin e Kosovës për aprovim, së bashku me një strategji lidhur me këtë privatizim, e cila strategji definon qartë interesat e Republikës së Kosovës në këtë aset publik dhe mënyrën se si do të përdoren mjetet për privatizimin e kësaj ndërmarrjeje publike”. Janë edhe tri pika të tjera.

Në rezolutë është kërkuar:

Nën 1, në harmoni me vendimet e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të vazhdojë implementimi i procesit të privatizimit, konform standardeve dhe normave ndërkombëtare të transparencës.

Prandaj, për mua do të kishte qenë shumë normale, shumë e drejtë, shumë e arsyeshme, që ne si ligjvënës të kërkojmë, vërtetë të kërkojmë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Albulena Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Ndonëse në të gjitha shtetet e zhvilluara koncepti i pasurisë nëntokësore është segmenti më vital dhe strategjik, Kosova edhe krahas potencialit të resurseve natyrore që ka, për fajin e politikave të dëmshme të UNMIK-ut dhe të qeverive, deri më tani nuk është bërë asgjë.

Përkundrazi, sektorin e minierave në përgjithësi, e në veçanti gjigantin dhe potencialin më të madh ekonomik dhe zhvillimor, kjo Qeveri e ka degraduar, sikurse edhe e ka degraduar pasurinë tjetër publike dhe shoqërore, në mënyrë që ky degradim t'i shërbejë procesit të kriminalizimit privatizues të pasurisë së këtij populli, i cili me djersë në ballë e në gjak në trup e ka sajuar.

Shembulli konkret për degradimin e sektorit të minierave është edhe shembulli i Minierës së Goleshit, ku minatorët e kësaj miniere u larguan nga vendet e tyre të punës, përkundër që formalisht kjo minierë është privatizuar me spin-off special. Pra, minatorëve të Goleshit privatizimi vetëm se u solli mjerim dhe assesi mirëqenie.

Kjo është e zakonshme në një proces, ku të pasurit sa shkojnë e pasurohen e të varfrit edhe më shumë varfërohen. Por, ky pasurim u takon vetëm pushtetarëve, të cilët me fanatizëm janë duke e mbrojtur pushtetin e tyre. Në Minierën e Goleshit blerësi nuk investoi asgjë që do të duhej të bënte sipas kontratës së privatizimit.

Shembull tjetër i privatizimit të Ferronikelit është shembull se si pasuria kombëtare tjetërsohet, për tu pasuruar një grusht njerëzish që e kontrollojnë rendin shoqëror në Kosovë. Blerja e këtij aseti të rëndësishëm kombëtar nga Kompania “Alferon” dëshmoi vetëm fillimin e tjetërsimit të aseteve vitale të vendit tonë.

Përkundër kësaj, ne jemi të befashuar nga neglizhenca dhe presioni, të cilin e lejuan ta durojnë dhe t'i nënshtrohen disa deputetë të këtij Kuvendi.

Është hipokrizi që sot të flasësh për “Trepçën” e të mos votosh një rezolutë e cila kishte për qëllim shfuqizimin e kontratave, që ishin lidhur në kohën e Millosheviqit.

Pra, e kam fjalën këtu për rezolutën e Lëvizjes “Vetëvendosje”, e cila kishte për qëllim shfuqizimin e kontratave dhe vendimeve të dëmshme të Millosheviqit dhe që nuk u votua nga ky Kuvend e që padyshim se edhe Kombinati “Trepça” do të ballafaqohet me këtë problem. Rreziku edhe më i madh është se ne ende nuk e dimë se çka është shitur e çka është dhënë me kontratat mistike të kohës së Millosheviqit, që u përkrahën, po e përmend edhe menjëherë nga këta deputetë të këtij Kuvendi.

“Trepça” sot, në vend se të jetë gjenerator më i madh i të ardhurave të qytetarëve të Kosovës, ajo është duke u përgatitur për privatizim, pra për t'u shitur e për të mos u kthyer asnjëherë qytetarëve të këtij vendi. Andaj, nuk është edhe i rastësishëm insistimi i partisë në pushtet, që medoemos ta vë në krye të AKP-së zyrtarin e PDK-së. Siç duket, atë që e la në gjysmë Dino Asanaj, Blerim Rexha do ta çojë deri në fund.

Lëvizja “Vetëvendosje” fton të gjithë deputetët e Kuvendit të Kosovës, që të dalim në mbrojtje të Republikës dhe të pronës së saj e jo në mbrojtje të kontratave dhe vendimeve të Millosheviqit. Ju faleminderit!

KRYETARI: Donika Kadaj-Bujupi e ka fjalën.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

S’kam qare edhe pse e di që ka për të replikuar, por pa e përmend faktin që Adem Grabovci, të cilit iu kujtua vetja kur ka dalë në protestë dhe që mu duk goxha patetik, se krejt kemi dalë në protesta, mua mu kujtua që në strukturat e përbashkëta administrative, edhe pse kam qenë goxha e re, ka qenë udhëheqës i MTI-së atëherë edhe i pari e ka thënë atë termin e keq “Trepça e Veriut” dhe “Trepça e Jugut”. Edhe rrënjët e këtij hendeku qëndrojnë prej asaj kohe, prandaj përtej asaj që kemi qenë patriotë, duhet pranuar dhe nuk na amnistohen gabimet që i kemi bërë, gabime shumë të mëdha.

Edhe kam thënë shumë herë, në emër të patriotizmit nuk bën të amnistohen ata që kanë keqpërdorur dhe që kanë vjedhur pasurinë e këtij populli.

Pastaj më vonë, pas periudhave të mëvonshme, kemi pasur njeriun e dytë në Qeveri, që vazhdon të jetë i dyti në Qeveri, që ka dhënë fjalë joserioze, që është vetë joserioz, me plane joserioze, në stilin e Perëndimit të egër, është zëvendëskryeministër i parë i Qeverisë së Kosovës, i cili thotë: Lërmani mu ndërmarrjen “Trepça”, se ajo duhet të rehatohet sipas planit, që ai e ka bërë publik disa vjet më parë e ai plan është hajgare.

Sipas planit të tij, dikujt duhet t’i jepet e drejta ekzekutive për ta regjistruar gjigantin ekonomik si kompani, në Londër. Tash, nuk ka vend në botë, që nuk të pranon ta regjistrosësh një kompani, nëse i ke 20 euro i paguan edhe shkon e regjistron, mirëpo ky format i të diskutuarit dhe i të menduarit mund të ishte shitur para nja 100 vjetëve, apo në ndonjë vend ku shteti udhëhiqet nga oligarkët. Mirëpo, Kosovë është në Evropë dhe qytetarët e saj, të paktën shpirtërisht mbeten të përkushtuar që të vazhdojnë të jenë në Evropë, prandaj, unë do të them- stop dominimit të udhëheqjes së stilit oligark aziatik.

Për më keq, kjo Qeveri, përtej zëvendëskryeministrit të parë, asnjëherë nuk ka dhënë ide si të zhvillohet “Trepça”, por ka mbetur peng i fjalëve: Më jepni mua asetet e unë ju tregoj se çka bëj. E çka bëj dhe çfarë ka bërë, e kemi parë me shumë asete, me shumë ndërmarrje publike në Kosovë.

Kosova, të nderuar, mund të jetë e udhëhequr nga të paditurit, por Kosova ka mjaftë njerëz që janë të ditur dhe të cilët nuk janë të angazhuar, sepse politikat përjashtuese të kësaj Qeverie, kanë bërë që të jenë refuzuese ndaj vlerave demokratike perëndimore. Dhe, këto politika kanë bërë që ky vend i vogël t’i përngjajë një anijeje të uzurpuar dhe të udhëhequr nga piratët dhe për piratët vlen kodi i piratëve- cili është ai kod , e dinë të gjithë.

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës e mbështet procesin e privatizimit si formë e organizimit politik dhe ekonomik, por jemi të përkushtuar dhe po mundohemi që të

kontribuojmë që ky proces, së paku minimalisht, në kuadër të këtyre mundësive të këtij momenti, në të cilin e keni sjell këtë shtet, të kontribuojmë që ky proces të jetë minimalisht, po them edhe një herë, i organizuar dhe transparent sipas standardeve të qeverisjes së mirë.

E përshëndesim debatin për “Trepçën”, por jo këtë formë debati që s’po prodhon kurrgjë, po të jemi, të organizohemi që formati i organizimit të ardhshëm të “Trepçës”, le të jetë i dalë nga debati që së paku qytetarët e saj të kenë hise në vendimmarrje. Le të ndjehen, se ky vend është edhe i tyre, e jo vetëm i disave të cilët po pasurohen në kurriz të fukarasë së Kosovës.

Edhe një e fundit, Kosova nuk mund të reformohet nga njerëz të stilit “good looking kofy boy”, që janë pa ide, jokreativë, që janë përsëritës dhe mbi të gjitha jo etik, të stilit të kombinuar me veshje perëndimore të shtrenjta, ndërkaq me mendje shegertit të dëgjueshëm. Ju faleminderit!

KRYETARI: Myzejene, nuk ta ka përmendur emrin. Urdhëro, replikë.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Duke marrë parasysh se zëvendëskryeministri i parë ka ide dhe nuk është pasuruar nga Kosova, as nga cubat të cilët i rrahin investitorët të cilët vijnë në Kosovë, ai ka treguar një plan shumë konkret për çështjen e “Trepçës” në bursën e Londrës, në të mirën e Kosovës dhe qytetarëve të saj dhe jo në favorin e xhepave të një lideri të një partie politike. Ju faleminderit!

KRYETARI: Kundër-replikë ka edhe Adem Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Unë e përshëndes kolegen Bujupi. Ajo tha se vërtet kur kam vepruar ka qenë shumë e re në moshë dhe është shumë e vërtetë se s’ka mundur t’i vlerësojë veprimet e mija edhe në vitet ’90-ta para lufte, gjatë lufte e kështu me radhë, megjithatë unë ndjehem shumë mirë edhe kur kam qenë bashkëdrejtues i Departamentit të Tregtisë e Industrisë, se nuk ka qenë Ministri atëherë, por ka qenë bashkëqeverisje dhe larg asaj që unë kam bërë një ndarje të tillë, apo kam qenë ndonjëherë i angazhuar që të ndaj veriun dhe jugun, por për mua Kosova në vazhdimësi ka qenë një dhe e pandarë, ashtu siç është dhe si e shikoj edhe sot.

Ne këtu kemi një ligj, që ky Parlament e ka votuar më 22 shtator të vitit 2011, me siguri se edhe zonja Bujupi e ka përkrahur. Unë po e lexoj vetëm një tek çështjet e riorganizimit.

Ristrukturimi profesional i borxheve apo i operacioneve afariste të një ndërmarrjeje që në mënyrë të arsyeshme pritet] se do të kthejë qëndrueshmërinë e ndërmarrjes si një e tërë, si një e tërë ju lutem, është shumë mirë dhe shumë qartë për atë që do të kuptojë, në të ardhmen dhe që do të mundësojë shlyerjen e kërkesave dhe interesave në pajtim me këtë ligj.

Prandaj, realitetin nëse e pranojmë që kemi një realitet të tillë edhe sot apo deri më 25 korrik e kemi pasur kur, gjegjësisht rastin e intervenimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, kemi pasur një realitet tjetër dhe sot po ashtu, kemi një realitet tjetër që krejt bota demokratike ta ka pranuar ty tërësinë territoriale, e kështu me radhë, për çka jemi të angazhuar...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Kundër-replikë, Donika Kadaj- Bujupi.

DONIKA KADAJ - BUJUPI: Po, veç desha të them se cubat i kemi larguar në të '98-ën dhe '99-ën, atëherë kur njerëzit që sot janë në Qeveri, kanë qenë jugosllaven, të cilët janë gjetur në Zvicër prej UDB-së dhe prej oligarkëve rusë dhe kanë shpërlarë para për ta. Faleminderit!

KRYETARI: Kundër-replikë, Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Është e dhembshme, ata njerëz të cilët mendojnë se e kanë fituar luftën në krah të popullit, ndërsa populli e ka fituar luftën dhe tash për pasojat gjatë luftës vuajnë dënimet edhe pas luftës. Dhe, në fund kërkojnë ndihmë po nga këta njerëz që i kanë ndihmuar dhe në fund etiketohen, kjo është turpi që i ndodh Kosovës, kënd e ka brenda në Parlament.

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Muhamet Mustafa.

MUHAMET MUSTAFA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar përfaqësues të Kabinetit Qeveritar,

Unë e përshëndes iniciativën e këtij debati edhe pse në fillim më është dukur pak ndoshta kam pasur një frikë se a do të kemi bazë për diskutim mjaftë, a kemi një analizë nga e cila do të mund të nxirrim konkluzë. Po e shoh se ky shkëmbim i mendimeve vërtet është i dobishëm që të aktualizojmë problemin e “Trepçës” dhe të gjejmë zgjidhjet sa më të mira për këtë problem.

Sigurisht, se rreth “Trepçës” ka mite, ka teprime, por padyshim se kjo është një nga korporatat dhe kompanitë më me rëndësi për zhvillimin e ardhshëm të Kosovës edhe se pas viteve të vështira në vitet '90-tave, kohëve të fundit kjo po tregon disa shenja të ringjalljes dhe mundësisë për një revitalizim.

Në vitet e '90-ta “Trepça” ka qenë e okupuar dhe është qeverisur nga ai pushtet. UNMIK-u i ka shpallur diskriminuese dhe të paligjshme të gjitha vendimet për transformim, jo vetëm të “Trepçës”, por gjithkund në Kosovë prandaj, ato vendime dhe ato transformime dhe kinse privatizime të “Trepçës” nuk janë valide. Ne mund t'i shpallim edhe njëherë që s'janë valide, por ato nuk janë valide në këtë moment.

E dyta, po ashtu u përmend edhe këtu embargoja, prandaj çështja e kreditorëve, problemi me kreditorët është i fryrë, është i fryrë nëpërmes edhe propagandës shumë të madhe që bën Serbia, në opinionin e jashtëm dhe në opinionin e brendshëm.

Në kontekstet që do të zhvillohen, do të provohet se ato pretendime të shumtën janë fiktive, sepse në “Trepçë” në vitet e ‘90-ta nuk ka ndodhur investim, nuk ka ndodh zhvillim, në “Trepçë” ka ndodhë dezinvestim. “Trepça” shumë më shumë është amortizuar, se sa që është ndërtuar. Prandaj, “Trepçës” duhet t’i kompensohet dëmi, jo t’i kompensojë dikujt dëm.

Në këtë drejtim, mendoj se çështjet me “Trepçën” duhet t’i shohim në kontekstin e konjunkturave që bëhen tash. Unë kam një analizë të shkurtër këtu para vetes, të një grupi të ekspertëve të kësaj fushe, të cilët tregojnë se do të ketë një kërkesë në rritje për këto metale, prodhimi do të rritet edhe “Trepça” e ka shansin pra, që të prodhojë metale dhe të shesë metale.

Në këtë drejtim, Kuvendi është përgjegjës, që “Trepçës” t’ia krijojë këto kushte, që të ketë një afarizëm normal.

Po ashtu, duhet ta marrim si një fakt pozitiv, që “Trepça” ka një shitje prej 20 milionëve, prej 0 sa ka pasur menjëherë pas luftës. Të përkujtojmë, e përmendi edhe dikush këtu, se në shtator të vitit 2011, pra gati po bëhen dy vjet, ne i kemi aprovuar tri ligje që është dashur t’i hapin një perspektivë “Trepçës”, por nëse për dy vjet nuk është bërë asnjë hap serioz dhe nuk i është hapur një perspektivë domethënëse ristrukturimit dhe konsolidimit të “Trepçës”, atëherë diçka s’është në rregull, këto ligje nuk po funksionojnë.

Mu për këtë, duhet të mbështetet pra, që ky Kuvend për shkak të rëndësisë së “Trepçës”, të nxjerrë ligjin e veçantë. Le të jetë një ligj i veçantë, që iu përshtatet specifikave të “Trepçës” dhe merr “Trepça” një rrugë për konsolidimin e saj të gjithanshëm.

Përpos ligjit ne duhet të gjejmë një zgjidhje, zgjidhja ekziston, përvoja pak a shumë ekziston. Mendoj se ne kemi një situatë kur kompania e “Trepçës” duhet të konstituohet si një kompani e re, e cila funksionon normalisht, ish- kompania e “Trepçës” le të merret me problemet e borxheve, qysh ka qenë praktika me spin-off-et në tëra ndërmarrjet tjera. Por, te “Trepça” është ndërmarrje shumë specifike, sepse aty mund të kemi edhe për disa pjesë privatizim, për disa pjesë nuk mund të kemi privatizim. Plotësisht e pati me vend edhe kolegja ime Justina Pula dhe të tjerët që thanë pasuritë nëntokësore të “Trepçës” nuk mund të privatizohen.

Ne mund t’u japim një licencë, një leje, një koncesion, që të shfrytëzohen me partneritet publiko-privat, por ato nuk mund të tjetërsohen, nuk mund të shiten, prandaj, është një problem specifik, është një ndërmarrje specifike dhe duhet të gjendet zgjidhja pra, specifike.

Ne duhet të kemi sa më shpejtë një studim të fizibilitetit, i cili nuk ekziston sot, sa di unë. Dhe të gjitha problemet po na dalin, pse Qeveria dhe ata që po i administrojnë pasuritë e

Kosovës, po i privatizojnë, po marrin, po i rristrukturojnë pa një studim të fizibilitetit. Ne duhet të shohim cili është drejtimi i rristrukturimit të “Trepçës” ai studim i fizibilitetit do të na tregojë tregun e “Trepçës”, sa duhet investuar në teknologji, ku janë shanset për investime, cilat janë përfitimet e Kosovës, cilat mund të jenë përfitimet e investitorit, sepse unë supozoj se për shkak të investimeve serioze, që duhen në “Trepçë,” ne patjetër duhet të jemi atraktivë edhe për investitorë strategjikë.

E në këtë drejtim, ne duhet të krijojmë kushte që “Trepça” të punojë, të fitojë interesi publik dhe të fitojë investitori. Ky është trekëndëshi real. Nuk mund të ketë një trekëndësh afatgjatë i një situatë, kur dikush fiton e dikush humb. Në atë situatë mund të humbë interesi publik dhe faktikisht, nuk është e rastit që të rralla janë vendet që janë pasuruar me pasuritë nëntokësore, të rralla janë në botë ato vende.

Edhe mu për këtë, ne teorinë ekonomike ekzistojnë dy situata: një që quhet mallkimi i burimeve, mallkimi i resurseve e dy është bekimi i resurseve. Një vend mund të jetë i bekuar prej minierave, në qoftë se e ka një regjim demokratik, vepron shteti ligjor edhe buxheti është transparent edhe përfitimet shkojnë në buxhet të shtetit, por jo në grupe të ngushta. Prandaj, nëse ne duam që “Trepça” vërtet të bëhet bekim për zhvillimin e Kosovës, ne duhet të forcojmë këtë Kuvend më së pari - këtë Kuvend duhet ta forcojmë, e jo në Kuvend të na vijnë: jo, ka pasur vendim; jo, s’ka pasur vendim; jo, ka qenë një nen; jo, s’ka qenë një nen; jo, ka qenë një mocion; jo, ka qenë një rezolutë, pra ne mos t’i ndërrojmë tezat këtu. Është një vendimi i Kuvendit, dy është ligji i Kuvendit, tre janë mocionet, këto janë tri gjëra të ndryshme. Në qoftë se, fillojmë kështu në stilin ta mujta me fjalë, ma mujte me fjalë, ta bëra, s’ta bëra, atëherë, me të vërtetë s’kemi shans që të hyjmë në zonat e interesave të një shteti, të cilin e bekojnë resurset me të cilat disponon.

Një problem që mua më ka rënë në sy kohëve të fundit, është problemi i zgjatjes së afatit për kreditorë. Unë nuk dua të përziehem në gjyqe, gjyqet janë autonome dhe vendosin, por unë si deputet nuk e kuptoj, pse të zgjatet afati? Ka ekzistuar, domethënë, prej kur është aprovuar ai ligj. Ne e kemi aprovuar në shtator dy vjet, tash po shoh që ende po zgjatet afati edhe një vit. Po, ata kreditorë në qoftë se kanë argumente, në qoftë se kanë pasur interesa, kanë mundur t’i japin ato kërkesa. Domethënë, zgjate afatin, shtyj proceset dhe në këtë mënyrë unë e përkrah këtë propozim, që të shkohet

me ligj, por bashkë me ligj të na vijë edhe një studim i fizibilitetit. Dikush tha, ju duheni ta thirrni Agjencinë. Faleminderit, ne duhet ta thërrasim edhe Agjencinë, por ne në rend të parë duhet ta thërrasim Ministrinë përkatëse dhe Qeverinë, që të vjen në këtë Kuvend dhe t’i hapë perspektivat zhvillimore. Ju faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka Sala Berisha-Shala.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, kryetar!

Përsëritje ministra të Qeverisë,

Të nderuar kolegë deputetë dhe deputete,

Ju të pranishëm,

Përsëritje menaxhment i “Trepçës”

Kisha dashur që debatet e rëndësisë së veçantë, siç është ky sot, të na bashkojnë dhe të mos na ndajnë në taborë të kundërta, që të barikadohemi në taborë që ndoshta nuk kishim pasur dëshirë asnjëri prej nesh.

Tash po i kthehem fjalimit tim. Ekzemplari më reprezentativ i sektorit të minierave në Kosovë është “Trepça” si në kuptimin e traditës mbi 80-vjeçare, si në kuptimin e prodhimit dhe industrisë së metaleve të çmueshme, por edhe në kuptimin ekonomik në përgjithësi.

Pa dashur të zgjatem në funksionimin e vështirësuar të “Trepçës” që doli shumë e dëmtuar nga lufta e fundit, për të cilën gjë menaxhmenti i saj ka bërë një padi në gjykata, pa dashur të flas as për kohën, kur e menaxhonte UNMIK-u apo ndonjë aktivist i dikurshëm apo i tashëm i ndonjë partie politike e pa dashur të flas as për gjendjen aktuale, dua të kujtoj që kjo temë nuk kap vetëm “Trepçën” si një ndërmarrje, si një koncept i ngushtë, por po e prekim dhe diskutojmë për sektorin e plumb-zinkut, arit dhe argjendit, i cili është i lidhur ngushtë me fatin e “Trepçës”.

Është i lidhur ngushtë, sepse ekzistojnë zonat tjera perspektive, në kuptimin e gjeologjisë dhe minierave të definuara në Ligjin për miniera dhe minerale, si zona të interesit të veçantë, të cilat janë të pasura me resurse të çmuara të plumb-zinkut, arit, argjendit, kadmiumit e tjera elemente shumë të rëndësishme.

Këto zona janë pjesë e “Trepçës” të definuara pra, si zona të interesit, por mund të jenë nesër në një të ardhme minierat e ardhshme partnere me “Trepçën” e sotme apo të nesërme, ndoshta duke i përdorur të njëjtat kapacitete tekniko- teknologjike, të industrisë dhe metalurgjisë, të kombinuara këto me investim dhe kapital të përzier vendor a të huaj, privat apo publik. Me fjalë tjera, mendoj që është jetike dhe e domosdoshme për investime jobuxhetore.

Prandaj, për t'i dhënë hov zhvillimor tërë sektorit minerar të plumb-zinkut, arit dhe argjendit, duhet të krijojmë kushte dhe rrethana të favorshme, në rend të parë për “Trepçën”, në mënyrë që të vazhdojë zinxhiri i investimeve dhe zhvillimit në këtë industri shumë profitabile dhe të rëndësishme për ekonominë e Kosovës.

Mendoj, që “Trepça” ballafaqohet me shumë sfida e ndër më kryesoret janë infrastruktura ligjore. Legjislacioni aktual është pothuajse sfidë kryesore, e cila krijon situatë tepër të rrallë, ndoshta unike në kuptimin e menaxhimit e ndërmarrjeve industriale, minerare dhe realisht nuk e has askund, as në literaturat më të veçanta juridiko-ekonomike, një situatë apo shembull të tillë.

Ky legjislacion aktual në fuqi krijon strukturë të shumëfishtë menaxhuese. Praktikisht, “Trepça” menaxhohet nga disa nivele menaxheriale, nga Bordi i AKP-së, nga njësia për “Trepçën”, shpesh nga Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme, e kështu me radhë.

Mendoj, që një sfidë tjetër, që e përmendi edhe një koleg më herët, është edhe afati i kreditorëve, i cili dëshiroj që të mos zgjatet me pafundësi. Dhe, është mirë që çështja e pretendentëve të bëhet në mënyrë legale dhe transparente, sa më parë që është e mundur.

Sfidë tjetër është sfida sociale. Fati i ish minatorëve të “Trepçës”, të cilët ende ndodhen si kategori sociale, të subvencionuar nga Qeveria dhe nga “Trepça”. Sfidë po aq e rëndësishme është edhe sfida mjedisore dhe barrë jo vetëm për “Trepçën” dhe Kosovën, nga aspekti i respektimit të kriterëve mjedisore, milionë tona mbetje industriale, duke filluar nga Artana, Kishnica, Mitrovica e zona tjera, mbetje këto të depozituara nga e kaluara në zona urbane, në brigje të lumenjve, duke shkaktuar ndotjen e ujit, ajrit dhe tokave.

Sfidë tjetër është edhe ristrukturimi i “Trepçës” në të gjithë nivelet e saj, duke përfshirë ristrukturimin tekniko-teknologjik, ristrukturimin e menaxhmentit, ristrukturimin e njësive minerare dhe flotacioneve, si dhe njësive tjera vartëse të “Trepçës”.

Ky proces duhet kryer dhe mbështetur, bazuar në praktikat më të mira të modeleve evropiane të ristrukturimit. Vetëm atëherë ndërmarrja “Trepça” do të ishte ndërmarrje konkurruese në tregun lokal dhe global. Vetëm atëherë “Trepça” do të ishte subvencionuese e Buxhetit të Kosovës, mbushëse e arkës së shtetit dhe faktor i rëndësishëm ndikues në zhvillimin ekonomik të vendit. Për të gjitha këto, “Trepça” i ka rezervat minerale dhe resurset tjera, për të qenë e tillë.

Andaj sfidat e lartcekura, nga to dalin disa rekomandime që i përmendëm edhe në emër të grupit parlamentar dhe duhet t’i mbështesim dhe, më lejoni t’i përsëris edhe një herë.

Bordi i AKP-së duhet të inkurajohet që të mbështesë propozimet e “Trepçës” për projekte kapitale, të studiara mirë përmes fizibilitetit dhe me të cilat synohet të rritet produktiviteti, qëndrueshmëria financiare e “Trepçës” dhe vlera e ndërmarrjes.

Mandej, mikromenaxhmenti. Mendoj që AKP nuk duhet të mikromenaxhojë Trepçën. Drejtori menaxhues duhet të ketë edhe kompetenca dhe përgjegjësi për veprimet e veta dhe jo si deri më tani, që për çdo prokurim të vogël të marrë pajtim një herë nga njësia e “Trepçës” mandej nga menaxheri i Agjencisë, mandej nga Bordi i AKP-së dhe ndonjëherë edhe nga Gjykata Supreme, Dhoma e Posaçme.

Dhe, AKP si administratore e “Trepçës” në pajtim me Ligjin për riorganizim, që është miratuar më herët, të shtojë kapacitetet njerëzore që të përgatitë planin sa më të realizueshëm për riorganizimin e “Trepçës” të ofrojë një plan të mirëfilltë të riorganizimit.

Shpresoj, që tema të tilla duhet ta bëjmë si kulturë, që të na afrojnë neve si deputetë të Parlamentit të Kosovës, pavarësisht nga cilat parti politike jemi. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Vjosa Osmani e ka fjalën.

VJOSA OSMANI: Faleminderit, i nderuari kryetar!

Të nderuar deputetë,

Gjiganti i dikurshëm “Trepça” përbënte rreth 70% të pasurisë së përgjithshme minerare të ish -Jugosllavisë dhe ishte njëri ndër motorët e ekonomisë jo vetëm kosovare, por edhe asaj Jugosllave me rreth 22 mijë punëtorë të punësuar, që përfaqësonte rreth 10% të forcës punëtore të tërë Kosovës. Kjo minierë u shfrytëzua nga regjimi jugosllav dhe frytet e saj shumë pak u shijuan nga qytetarët e Kosovës.

Fatkeqësisht, situatë thuajse e ngjashme është edhe sot edhe pas përfundimit të luftës dhe për shkak të neglizhencës që është treguar në raport me këtë gjigant ekonomik.

Duke mos e bërë prioritet, Qeveria ka dëshmuar se nuk është e interesuar ta revitalizojë “Trepçën” dhe rrjedhimisht të ulë numrin e papunësisë në rajonin e Mitrovicës dhe më gjerë. Në përgjithësi institucionet do të duhej t’i kushtonin një vëmendje më të madhe aktiviteteve si prodhimi, meqë prodhimi është ai sektor që sjell më së shumti punësim për qytetarët.

Aktualisht, “Trepça” prodhon me kapacitete mjaft të limituara. Kjo shprehet mjaft keq në prodhimin e përgjithshëm industrial të Kosovës dhe në eksport, sepse pjesa dërmuese e produkteve të “Trepçës” eksportohej, prandaj, edhe bilanci tregtar i Kosovës do të përmirësohej dukshëm me revitalizimin e “Trepçës”.

Për riaktivizimin e “Trepçës” nevojiten investime relativisht të mëdha, të cilat duhet të sigurohen nga partnerët ekonomikë të jashtëm, ndër të tjera.

Për fat të keq, për shkak të imazhit të rëndë investues në Kosovë dhe raporteve të shumta ndërkombëtare, të cilat portretizojnë Kosovën si një vrimë të zezë në Evropë, ku përdoren mjete primitive ndaj investitorëve të huaj, si reketimi, kërcënimi dhe shantazhimi, interesimi i investitorëve potencialë është pothuajse inekzistent. Pra, nuk është bërë asgjë konkrete, për të ofruar mbështetjen e plotë, që mundësitë e investimit në “Trepçë” dhe në tërë Kosovën të realizohen me sukses.

Të nderuar deputetë,

Situata ligjore rreth “Trepçës” është jashtëzakonisht komplekse. Ka dhjetëra kompani që pretendojnë pronësi ose thirren si investitorë dhe menaxhmenti i “Trepçës” ka dhënë një pasqyrë të qartë të këtyre pretendimeve dhe kategorizimin e tyre. Në anën tjetër, gjyqësori në Kosovë ka shpallur moratorium mbi këto kërkesa, prandaj, paqartësitë ligjore vazhdojnë.

Miratimi i Ligjit për “Trepçën” ashtu siç është prezantuar në kërkesën e Grupit Parlamentar të LDK-së, përveç që ka për qëllim qartësimin e çështjeve ligjore, do të mund të përfshinte edhe strategjinë për revitalizimin e kësaj ndërmarrjeje.

Këtë ia kemi borxh minatorëve të “Trepçës”, ia kemi borxh Mitrovicës, por mbi të gjitha zhvillimit ekonomik të Kosovës dhe uljes së papunësisë për qytetarët tanë.

“Trepça” gjithnjë ka qenë e veçantë, prandaj edhe kësaj radhe duhet të trajtohet si e veçantë, prandaj edhe duhet të miratohet ky ligj i veçantë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputete! Ministër, e keni fjalën.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

U theksua shumë herë edhe në mëngjes edhe më vonë, çështja e ligjshmërisë për privatizimin e PTK-së dhe kam obligim para jush dhe para qytetarëve, që ta lexoj nenin 4 të Ligjit të buxhetit, i cili thotë: Vendim për privatizim me ndikim fiskal.

Vendimi i Qeverisë 2/3 i datës 9 mars 2011, për privatizimin e PTK-së i cili është i bashkëngjitur këtij ligji si aneks, konsiderohet i miratuar nga Kuvendi, nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Ky miratim e plotëson kërkesën për miratim nga Kuvendi i përcaktuar me nenin 9.1 të Ligjit për ndërmarrjet publike, respektivisht dispozita e fundit e Ligjit të buxhetit thotë kështu: i gjithë buxheti dhe alkimi i mjeteve përfundojnë me datën 31 dhjetor 2011, që nuk ka asnjë dispozitë tjetër, e cila e eliminon as nenin 4, prandaj ju bëj thirrje, të gjithë ata të cilët kanë dyshim në ligjshmërinë jo vetëm të thërrasin EULEX-in, por të thërrasin të gjitha institucionet tjera relevante, për të bërë hetime në këtë fushë, sepse është me interes për qytetarët që të dalë në pah ligjshmëria e këtij vendimi.

Ndërsa, sa i përket asaj për privatizimin e 75% të aksioneve, ju kujtoj që me datën 23 mars 2008 është themeluar nga Qeveria një komision ndërministror, i cili ka sjell strategjinë këtu në Kuvend për miratim dhe ky komision ndërministror ka qenë i ngarkuar për të dhënë propozimin dhe ishte në përbërje të Ahmet Shalës - ministër, Lutfi Zharku - ministër i Tregtisë dhe Industrisë, Fatmir Limaj, Nenad Rashiq dhe Sadri Ferati - ministër i Administratës së Pushtetit Lokal, të cilët realisht e kanë bërë vendimin dhe rekomandimin për privatizimin e 75% të aksioneve të PTK-së.

Ndërsa, sa i përket çështjes së diskutimit për “Trepçën”, unë dua t’ju them, se edhe një herë e falënderoj deputetin për ngritje të këtij debati, sepse na ka krijuar edhe një herë mundësinë për të ndarë atë se çka është bërë. Unë besoj që shumica prej jush që keni qenë ministra dhe keni qenë udhëheqës nëpër mekanizmat paraprakë, keni pasur shumë mundësi për të dhënë kontribut lidhur me funksionimin dhe bashkimin e kësaj kompanie, bashkimin për të mos u trajtuar kjo as e veriut, as e jugut, por që realisht punën të cilën ne e kemi gjet si Qeveri, është relativisht e mangët.

Unë dua t’ju përkujtoj se kjo Qeveri ka punësuar njerëz të rinj në “Trepçë” së bashku me menaxhmentin e “Trepçës” dhe dëshiroj t’i falënderoj këta, sikurse kanë ardhur menaxhmenti i “Trepçës” ka mundur të vijë edhe AKP-ja sot, sepse nuk është e ndaluar për të ardhur edhe ata kishin mundur të japin informacione rreth funksionimit aktual të “Trepçës” dhe do të ishte logjike, që të vinin dhe të jepnin shpjegime të tilla.

Pra, ka punësuar njerëz të rinj, ka bërë investime të reja, po e njeh stazhin e punëtorëve, ka krijuar bazë ligjore për heqje të këtyre administrimeve nga UNMIK-u dhe të gjitha

atyre vendimeve arbitrare, të cilat janë marrë nga gjyqtarët e huaj, ka miratuar një strategji minerare, ka bërë planin e veprimit për zbatimin e kësaj strategjie, që në periudhën trevjeçare parashihen 189 milionë euro investime në fushën e minierave në përgjithësi. Dhe, më në fund, me këtë menaxhment dhe me këtë grup njerëzish, të cilët kanë punuar me mund shumë të madh, ka krijuar një ndërmarrje fitimprurëse.

Pra, flasim për këto veprime të cilat kjo Qeveri i ka bërë dhe ne jemi shumë të lumtur, që kemi pasur mundësinë që të krijojmë bazën ligjore dhe këtë bazë ligjore ta transferojmë pastaj te AKP-ja.

U përmend shumë edhe privatizimi i “Trepçës.” Po ju them, nuk e di, asnjëherë as në Qeveri, nuk e di në AKP dhe në Bordin e AKP-së, por asnjë ide në Qeverinë e Republikës së Kosovës nuk ka qenë për privatizim. Gjithmonë është folur për rifunksionalizim, prandaj nuk është logjike të sillet diçka e tillë, e cila nuk është diskutuar në asnjë moment.

Por, sido që të jetë, ne e mirëpresim debatin, i cili kontribuon në ngritjen e interesit shtetëror, në ngritjen e interesit për të gjithë ata punëtorë në miniera, të cilët me shumë mund kanë ngritur kompaninë të jetë fitimprurëse dhe të hiqet ajo ideja që kjo kompani nuk mund t’ia dalë.

Duhet t’ju them që ky kompleks ka qenë pa kanalet, pa pastrime të ujit, pa pastrime të ajrit, do të thotë në hapësira dhe të gjitha këto janë bërë me një mund jashtëzakonisht të madh dhe me investime vetjake, plus investimet të cilat kanë bërë, duhet të thuhet, që ata njerëz të cilët kanë punuar dhe me përkrahje të kësaj Qeverie kanë arritur që nga shtatë- tetëqind punëtorë, të kenë 1 500 punëtorë dhe kjo është për t’u përshëndetur. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Unë nuk dua të replikoj me askënd. Unë tash po kërkoj nga administrata e Kuvendit, gjithë dokumentacionin që ka të bëjë me privatizimin, ta përgatisin për të hënë në Kryesi dhe Kryesia të marrë vendim atë material t’ua shpërndajë deputetëve dhe kushdo që e kërkon.

Le të shihet komplet dokumentacioni, ai ekziston.
Vazhdojmë. Fjalën e ka deputeti Ramiz Lladrovci.

RAMIZ LLADROVCI: Faleminderit kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Pasuritë natyrore, përfshirë resurset minerale energjetike, metale dhe jometale, janë ndër pasuritë më të rëndësishme që Republika e Kosovës i posedon. Me të drejtë nga të gjitha grupet e aktorëve, ato konsiderohen shtyllë dhe burim i rëndësishëm potencial dhe real për zhvillim më të hovshëm ekonomik të vendit.

Republika e Kosovës është vend me pasuri mjaft të mëdha natyrore minerale, duke e bërë atë një potencial për përpunimin dhe prodhimin e energjisë dhe produkteve tjera. Sektori mineral është jo vetëm një treg i veçantë në vetvete, por edhe burim për zhvillimin e jetës ekonomike dhe sociale në vend.

Sa i përket pasurive natyrore minerale, Republika e Kosovës mund të konsiderohet relativisht e pasur në krahasim me vendet e rajonit dhe më gjerë. Zhvillimi i gjithanshëm dhe i qëndrueshëm ekonomik dhe social i Republikës së Kosovës sipas shumë studimeve të bëra gjër më tani në masë të madhe do të mbështetet në pasuritë natyrore vendore, të cilat nuk i mungojnë Kosovës.

Historia e “Trepçës”, prodhuesit më të madh të plumbit dhe të zinkut në Evropë ka qenë shumë e bujshme siç ka qenë të bujshme edhe kohët në të cilat është formuar e zhvilluar ky gjigantë i ekonomisë kosovare. “Trepça” e vjetër më se 2000 vjet mbanë mend ilirët, romakët, sllavët, turqit, austro hungarezët, anglezët, gjermanët e më në fund prapë ilirët, shqiptarët, qymyri, mineralet e plumbit dhe zinkut dhe disa minerale tjera janë një nga faktorët kyç në krijimin e një qëndrueshmërie ekonomike dhe mund të sigurojnë një rritje ekonomike dhe joshje të investitorëve strategjik.

Mirëpo, duhet të theksohet se këto pasuri në veçanti minierat mund të konsiderohen katalizatorë të zhvillimit vetëm nëse janë të shoqëruara në teknologji të avancuara dhe shërbime nga fusha e hulumtimeve zhvillimore.

Sektori mineral dhe posaçërisht potencialet e “Trepçës” është një nga mundësit komporative të zhvillimit më të shpejtë ekonomik, nga ky shkak një faktor kryesor ndikues në këtë fazë duke shtruar ndikimin e vet të konsiderueshëm në çështje të ofrimit të mundësive për hapjen e vendeve të reja të punës.

Për vetë historinë e saj si dhe rëndësinë ekonomike dhe sociale që përfaqëson “Trepça” do të trajtohet nëpërmjet një plani integral që do t’u japë zgjidhje jo vetëm çështjeve ekonomike, por edhe atyre sociale dhe mjedisore të trashëguara.

Riaktivizimi dhe zgjerimi i ndjeshëm i aktiviteteve fitimprurëse të “Trepçës” kërkon patjetër investime të konsiderueshme të cilat duket se pari mund të vijnë nga sektori privat, por edhe format e tjera investimesh kapitale nëpërmjet bankave zhvillimore, ndërkombëtare mundet dhe duhet të konsiderohen.

Për aktivizimin e aktiviteteve të “Trepçës” me investime jo buxhetore kërkon ristrukturimin e tij, ky proces do të duhej të fillonte disa vite më parë.

Ristrukturimi duhet të përqendrohet në krijimin e kushteve për riaktivizimin dhe zgjerimin e aktiviteteve fitimprurëse të “Trepçës” si dhe mundësinë e aktiviteteve të reja më potencial të konsiderueshëm përfitues për ekonominë e Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: E ka fjalën deputeti Sadri Ferati.

SADRI FERATI: Faleminderit, i nderuari kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë,

Që nga fillimi në përcjellje me vëmendje të gjitha diskutimeve, ka diçka që veç e ka formuar emnusin e përbashkët. Të gjithë jemi të vetëdijshëm për rolin dhe rëndësinë edhe në kaluarën, por që edhe sot kanë potencialet e “Trepçës”.

Të gjithë pajtohemi se rezervat e “Trepçës” janë të asaj natyre që duhet të merren shumë seriozisht dhe që duhet një mbështetje që ato të shfrytëzohen në interes të punëtorëve dhe në interes të qytetarëve.

Po ashtu jemi shumë të vetëdijshëm që kjo gjendje ekzistuese nuk e lejon “Trepçën” që të zhvillohet ajo do të ketë një stagnim deri në zvogëlim e rëndësisë së vet “Trepçës” dhe të pasurive të saj.

Pajtohemi se nëse lejohet zhvillimi i partneritetit konform ligjeve në “Trepçë” mund të hapen perspektiva edhe përtej gjendjes ekzistuese dhe atë nga investitorët të cilët tashmë veç ka shprehur interesim. Por, natyrisht jo me ligje ekzistuese, ata do të investojnë atëherë kur të binden se kapitali që ata do të investojnë do të jetë i sigurt.

Prandaj, edhe një herë duhet vënë theksin e veçantë që kërkohet pra një vullnet nga Kuvendi në bashkëpunim me ministrin, me AKP-n, me Dhomën e Veçantë, me menaxhmentin e “Trepçës” që të procedohet ligji dhe brenda ligjit pa e prejudikuar se cili është modeli më i mirë, ka vend që të diskutohet dhe të shihet se ky apo ai model, kjo formë e strategjisë apo ajo formë e strategjisë të bazuar në këtë apo në atë analizë, duke u bazuar në këtë përvojë të mirë apo një përvojë tjetër, kjo le të mbetet e hapur dhe ne do të thotë, në iniciativën që e kemi marrë nuk e kemi mbyll çështjen e modeleve. E kemi lënë hapur dhe unë vërtet falënderoj shumë diskutues që me kompetencë dhe shumë të përgatitur e kanë ndihmuar këtë debat, kështu që më se i domosdoshëm është sot veprimi për një arsye.

Po që se ne mjaftohem me legjislacionin ekzistues dhe me gjendjen ekzistuese, nënkupton pajtohemi që të humben shumë vite dhe “Trepça” mbetet në nivelin që është. Ne tani këtu po flasim ngase vetëm për borxhe po të kishim folur unë jam i bindur tri seanca nuk do të na kishin mjaftua .. si janë inkasuar ato borxhe, në cilën periudhë, a ka pas legalitet, cilët janë pretendentët, ku janë investuar ato, çka duhet të bëhet me ato? Ne nuk po e kontestojmë ligjin dhe rëndësinë dhe kompetencat e Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme, ajo le të vazhdojë si proces. Po ashtu nuk po e kontestojmë natyrën e pronës dhe ajo duhet të ruhet. Çka kërkohet në këtë rast dhe çka po kërkojnë vetë punëtorët, çka kërkojnë ata të cilët po presin te dera e “Trepçës” për t’u punësuar? Kërkohet që t’ju krijohet mundësia, që të shfrytëzohen mundësitë maksimale të aftësisë profesionale të menaxhmentit, të përvojës dhe gjithë kapaciteteve që ka që ajo të zhvillohet. Ne po kërkojmë zhvillim, po kërkojmë 4 000, 5 000, 6 000 vende të punës, po kërkojmë që mbi atë fitim pastaj të fitojë edhe Buxheti i Republikës së Kosovës dhe kjo është e thjeshtë.

Ndërsa thënia “jo” nxjerrjes së ligjit nënkupton mbetja e kësaj gjendje. Edhe një herë po e rikonfirmojmë edhe Bordi i AKP-së e ka pasur kohën 18 muaj, nuk ka prua asnjë strategji dhe asnjë plan të rikonstituimit ose të rirreshtimit të kësaj gjendje që e ka.

Edhe shumë kompetentë të tjerë, prandaj, unë edhe një herë angazhohem ndërsa po të ketë nevojë dikush për argumente shtesë në të gjitha këto pika që i thashë, besoni ka analiza, ka analiza edhe ndërkombëtare që tregojnë se cila ka qenë natyra e keqpërdorimit në vitet '99-2009, ato janë rrëqethëse, por unë po besoj se nuk është për këtë Parlament është për Dhomën e Veçantë dhe është për gjykatat ajo çështje. Ndërsa ne edhe një herë çka ne mund të bëjmë, cila është kërkesa e të gjithëve pra që janë të interesuar që ne ta tregojmë vullnetin, të tregohemi bashkëpunues, ta autorizojmë Qeverinë nëse Qeveria do, nëse jo Parlamenti e ka atë të drejtë, do të bëjë nëpërmes komisioneve iniciativa si grupe parlamentare që ose të draftohet ligji ekzistues ose më mirë të nxirret ligji i ri i cili definitivisht do ta ketë një rezultat.

Duke mos cenuar ligjet ekzistuese dhe të drejtën askujt të hapë vend që “Trepça” e pavarur me vendimet e veta në njësitë që ajo i konsideron se janë produktive të vazhdojë më tutje të gjenerojë dhe ndërsa atëherë kur përfundojnë proceset në Dhomën e Veçantë, atëherë mund të kthehet “Trepça” në origjinën, do të thotë cilat janë borxhet që më ngarkojnë mu sikurse edhe vetë shteti i Kosovës, prandaj kjo është edhe një arsye më shumë që ne të gjithë ta përkrahim formimin e ligjit të veçantë sipas modeleve që do të diskutohet dhe ku fjalën kryesore do ta kenë profesionistët. Ju faleminderit!

(Drejtimin e seancës e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: E ka fjalën zoti Kurti.

ALBIN KURTI: Faleminderit, kryesues!

Deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Qysh para shpalljes së pavarësisë së Kosovës, minatorët e “Trepçës” e patën propozuar një ide shumë të vlefshme që “Trepça” të bëhet ndërmarrje publike, edhe për ta mbrojtur në vijim por edhe për ta shpëtuar nga UNMIK-u dhe Agjencia Kosovare e Mirëbesimit. Kjo nuk u bë atëherë, nuk është bërë as sot e kësaj dite për më shumë se pesë vjet më vonë, por mund të bëhet qysh nesër.

Kuvendi i Serbisë në vitin 1990 i ka vendosur masat e dhunshme në “Trepçë” dhe i përjashtoi mbi 12.000 punëtorë dhe ekspertë shqiptarë nga puna. Gjersa Jugosllavia e Serbia ishin në luftë dhe nën sanksione të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, lidhen kontrata në dëm të “Trepçës” dhe eksploatohet ajo. Prandaj, shteti i Kosovës duhet ta thotë zëshëm dhe qartë se Serbia duhet t’i marrë përsipër borxhet e “Trepçës” dhe të paguajë për dëmtimet e saj të shkaktuara aty.

Shfrytëzimi i “Trepçës” pas luftës nuk ka qenë më pak i egër se para luftës. “Trepça” nuk e pati as 10% të punëtorëve krahasuar me një çerek shekulli më parë dhe nuk prodhonte metale të përpunuara, por vetëm koncentrat kryesisht të plumbit e zinkut.

Sa është kujdesur Qeveria për “Trepçën” si organizatë e punëtorëve më së miri e dëshmon fakti se në “Trepçë” instalohen njerëz të SHIK-ut me në krye menaxherin Ferat Shala, prej vitit 2009, drejtor ky i përgjithshëm i SHIK-ut, që nuk ka punuar në asnjë ndërmarrje përpara, dhe që në SHIK ka qenë i ngarkuar për kontakte dhe bashkëpunim me bashkëpunëtorë të Serbisë sipas gazetës “Koha Ditore”, faqe 5, më 1 shtator 2011.

Goditjeve në formë të padive të padrejta, “Trepça” iu qëndronte vetë meqë Qeveria e Kosovës asnjëherë nuk kishte qasje zhvillimore për “Trepçën”, por vetëm bënte përgatitje për kënaqje të atyre që thoshin se “Trepça” u ka borxh. Prej kompanisë greke Mytilineos që bashkëpunonte me regjimin e Milosheviqit, e deri te Duka Michael i Kentit. (Para tre vjetëve, ky i fundit e vizitoi Kosovën, i takoi Presidentin e Kryeministrin e Kosovës asokohe, dhe në fund shkoi në “Trepçë”, ku e prezantoi një tapi të moçme të paraardhësve të tij, e në të cilën, merreni me mend, thuhej se ata e paskan blerë “Trepçën” në vitin 1926 nga djali i Nikola Pashiqit, ndërsa ia paskan shitur në vitin 1940 dorës së djathtë të Hitlerit, Herman Geringut, i cili, siç dihet, bëri mandej vetëvrasje një natë para se të ekzekutohej atëherë kur u dënua në procesin e Nyrnbergut).

Siç e ka shpjeguar Nazmi Mikullovc, i cili ka qenë 14 vjet gjithsej drejtor i “Trepçës”, problemi i “Trepçës” nuk është gjendja teknike dhe teknologjike, por ndërhyrjet politike nga Qeveria nëpërmjet AKP-së. Këto ndërhyrje bëhen me orientimin themelor, i cili në fund shpie te likuidimi i “Trepçës” për t’i paguar borxhet.

Siç thotë sërish Nazmi Mikullovc, është vështirë të përcaktohet nëse është ndarë Kosova për shkak të “Trepçës”, apo është ndarë “Trepça”, sepse është ndarë Kosova. Pikërisht “Trepça”, që ka degë e pasuri minerare e prodhuese gjithandej nëpër Kosovë, mund dhe duhet të kontribuojë aq shumë në integritetin territorial dhe në unitetin e vendit tonë. Për më tepër, kur regjistrohet kombinati “Trepça” në vitin 1974, atëherë përbëhej prej 20 subjekteve që shtriheshin edhe jashtë Kosovës, si në Plevle të Malit të Zi, në Medvegjë, në Rudnik e Vranjë të Serbisë e deri në Sombor të Vojvodinës.

Kosova ka traditë dhe përvojë në përpunimin e metaleve me ngjyra, ka fuqi punëtore të kualifikuar dhe më të lirën në regjion. Shteti me pako të ligjeve duhet t’i stimulojë investimet në kapacitete përpunuese dhe do të garantonte furnizim të sigurt me metale për këto kapacitete. “Trepça”, përveçse histori e zhvillimit ekonomik, profesional e politik të Kosovës, është shans i madh për zhvillim industrial dhe zhvillimin e qëndrueshëm të Kosovës. Nëpërmjet “Trepçës” mundësohen edhe ndërrime cilësore strukturore të ekonomisë, edhe kushte të përshtatshme për investim të kapitalit privat në ngritjen e kapaciteteve prodhuese, edhe hapësirë për zhvillim teknik, teknologjik dhe shkencor.

Nëse e ndihmojmë pak “Trepçën”, ashtu qysh shpjegoi Glauku, ajo do të na ndihmonte shumë neve. Mirëpo, para së gjithash, duhet të ndërpriten vendimet arbitrare dhe ndërhyrjet politike zhvatëse aty.

Ligji për “Trepçën” sigurisht që nevojitet, por edhe më e rëndësishme se kaq është përcaktimi se çfarë ligji. Sigurisht që këtu do të dallojnë shumë, tepër shumë me Qeverinë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Dibra e ka fjalën.

VALBONA DIBRA: Faleminderit, i nderuari kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Pa dyshim që “Trepça” është njëra nga pasuritë më të mëdha natyrore që ka Kosova. Dokumentet e para mbi aktivitetin e minierës “Trepça” datojnë që nga viti 1303, fazë e cila është e njohur me punimet minerare me argjend, plumb dhe hekur. Në fillim të viteve të ‘70-ta, “Trepça” ishte në vitet më të mira të zhvillimit të saj, kur shtoi shumë fabrika dhe asete. Punësimi i rrit, nga 8000, në vitin 1960, me 22 885 të punësuar në vitin 1988. Implikimet fillojnë gjatë viteve të ‘80-ta, ku ndikimi i Beogradit mbi menaxhmentin e “Trepçës” vinte duke u shtuar.

Që nga vitet 1988-1989, në “Trepçë” filloi të ushtrohet politika në bazë të ligjeve diskriminuese që solli dëbimin e 12 800 punëtorëve shqiptarë. Si përgjigje ndaj këtyre veprimeve pasuan rebelimet e punëtorëve, me ç’rast në fillim të viteve të ‘90-ta shumë fabrika prodhuese u mbyllën. Pas dëbimit të shqiptarëve, në “Trepçë” u sollën minatorë nga Serbia, Bullgaria, Çekia dhe Polonia.

Në dhjetor të vitit 1999, UNMIK-u dhe Sindikata e Trepçës lidhën marrëveshje për të lejuar që 214 punëtorë të hyjnë në Stan-Tërg për ta rehabilituar minierën për prodhim. Në vitin 2000, fillon periudha e tranzicionit të “Trepçës” me financim nga Buxheti i Republikës së Kosovës, që për qëllim kishte përkrahjen e afarizmit të “Trepçës”. Por, ku është sot “Trepça”?

“Trepça” po ashtu është ndërmarrja më e madhe shoqërore, e administruar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit. Në nëntor të vitit 2011, ky Kuvend ka aprovuar ligje për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre që përcakton rregullat dhe procedurat për riorganizimin dhe likuidimin e ndërmarrjeve të caktuara nën autoritetin administrativ të Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Një nga këto ndërmarrje, është edhe “Trepça”.

Aktualisht, “Trepça” ka mbi 2 500 të punësuar aktivë dhe kjo rritje e numrit të punëtorëve është bërë pikërisht nga viti 2009, kur me “Trepçën” ka menaxhuar profesor doktor zotëri Shala, të cilin parafolësi e kualifikoi si njeri të SHIK-ut. Unë dua t’u rikujtoj kolegëve deputetë se zotëriu Shala është një njeri i ndershëm, i çmuar, një ish-luftëtar i UÇK-së dhe e ka kryer detyrën me shumë përgjegjësi në menaxhimin e “Trepçës” dhe nga udhëheqja e tij në “Trepçë” është rritur numri i punëtorëve, kur aktualisht janë 2 500 sish; në kohën kur ai e ka marrë në menaxhim është rritur numri i pensionistëve të parakohshëm. Dhe, zotëriu Shala me menaxhimin e “Trepçës” punëtorëve ua ka dhënë të drejtën nëse duan të pensionohen në formën e parakohshme, ta kenë mundësinë që të zëvendësohen me një familjar të tyre, që është një vepër e mirë në të mirë të punëtorëve.

Numri i përfituesve të ‘stipendive’ është 200, të cilët i marrin nga 50 euro nga Buxheti i Kosovës. Po ashtu, që nga viti 2009, “Trepça” e ka rritur prodhimin e xehes në mbi 1 700 000 tonë xehe. Për këtë janë faktet, të cilat mund t’i shikojnë të gjithë kolegët dhe është

mirë që të informohet opinioni i gjerë dhe ta shohin trendin e rritjes së prodhimit të xeheve nga viti 2009, 2010, 2011 dhe 2012. Këtë e bëj për arsye të informimit të drejtë të qytetarëve se jo gjithçka zi duhet të reflektohet te qytetarët. Ne e dimë që gjiganti “Trepça” është pasuria më e madhe që e ka Kosova dhe të gjithë e dëshirojmë atë më të mirën, mirëpo dihen pak edhe rrethanat e pasluftës si kanë qenë dhe jemi ku jemi.

Po ashtu, “Trepça” si gjigant operon me fitim, por konkretisht nga të hyrat e koncentratit të zinkut, të cilat shiten me një çmim të favorshëm në tregjet evropiane. Që nga janari i vitit 2011, AKP-ja e ka filluar planin e procesit të riorganizimit të “Trepçës”, ndërsa në mars të vitit 2012 e ka nënshkruar kontratën për ndihmë me Ministrinë Federale të Financave të Gjermanisë për procesin e riorganizimit të “Trepçës”. Plani i riorganizimit është dokument i cili duhet ta shpjegojë në mënyrë të detajuar rrugën që “Trepça” do ta marrë në të ardhmen.

“Trepça”, si gjiganti më i madh në Republikën e Kosovës, krahasuar me vitet e pasluftës, është në gjendje shumë më të mirë, mirëpo asses kjo nuk do të thotë që të ndalemi së insistuari që ky gjigant ekonomik të funksionalizohet në tërësi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Deshishku e ka fjalën.

HASHIM DESHISHKU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Të nderuar deputetë dhe deputete,

Duke e analizuar punën e deritashme të Qeverisë së Kosovës dhe Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, në veçanti, e kam përshtypjen se që të dyja janë frikësuar të merren me problemin e madh të “Trepçës”. Ato janë pajtuar me faktin se këtë problem ia kanë bartur Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe deklarohen se nuk kanë kurrfarë përgjegjësie për këtë kompleks, i cili duhet të jetë, por edhe ka mundur të jetë njëri nga bartësit e zhvillimit ekonomik të vendit.

Qeveria e Kosovës, prej vitit në vit, ka bërë gabime të vazhdueshme kur është në pyetje ky kompleks. Asnjë premtim që u është dhënë minatorëve nuk e ka realizuar, pos pensioneve për ta. Do të thotë që “Trepçën” e ka trajtuar kryesisht si çështje sociale, asnjëherë si potencial ekonomik. Gabimi më i madh ka ndodhur kur ajo është lënë nën mëshirën e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, duke e ditur se ajo nuk ka resurse për të menaxhuar me të. Krejt çka ka ndodhur më tutje është miratimi i ligjit, i cili nuk sjell asgjë të re, por që sërish i jep jetë moratoriumit dhe e legjitimon rrezikun se në një të ardhme të afërt “Trepça” të mbetet në duart e kreditorëve.

Ndërkaq, dihet kush janë kreditorët dhe si erdhën ata. Ata janë të një kohe, e cila në Kosovë mbahet mend si periudha më e rëndë në histori. Ata erdhën jo për ta ndihmuar “Trepçën”, por për ta financuar luftën e Milosheviqit dhe për ta fituar pronësinë ndaj saj. Nisur nga ky fakt, atëherë pse “Trepça” është dashur të jetë rast i veçantë dhe të mos trajtohet sikur të gjitha ndërmarrjet e tjera shoqërore. Në anën tjetër, është e qartë se nuk është i pranueshëm asnjë transformim, i cili ka ndodhur pas marsit të vitit 1989. Ndërkaq secili kreditor mund ta kërkojë të drejtën e vet nëpërmjet Odës së Veçantë, apo gjatë procesit të likuidimit të ndërmarrjes shoqërore.

Pra, “Trepça” si ndërmarrje shoqërore është dashur të trajtohet sipas këtij ligji, e jo që pasuria e saj të ruhet për pretendentët, të cilët Kosova as që i ka parë, e as që ka përfituar diçka prej tyre. Për më keq, pretendente janë edhe strukturat apo agjencitë e ndryshme që pikërisht Milosheviqi i kishte krijuar që t’i zhvatnin e t’i zhduknin ndërmarrjet në Kosovë. Të tillët, sipas Ligjit për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre kanë mundësi që të kenë ndikime kryesore për fatin e mëtejshëm të “Trepçës”. Gabimi tjetër, të cilin në vazhdimësi është duke u bërë nga Qeveria e Kosovës, është mosaktivizimi i minierave të “Trepçës”, nëse kompleksi përpunues, si metalurgjia, elektroliza apo segmentet e tjera përcjellëse kërkojnë kapital, investime dhe intervenime të mëdha financiare. Atëherë ka qenë e mundur që të ofrohet një program atraktiv për minierat.

Për fat të keq, edhe strategjia për minierat 2012-2025 nuk merret me këtë problem. Aty është vetëm një fjali që tregon se çfarë është përkushtimi i Qeverisë për “Trepçën”. Thuhet: “Kujdesi i veçantë do t’i kushtohet riorganizimit të ‘Trepçës’, në harmoni me interesat e qytetarëve dhe shtetit të Kosovës”. Kjo fjali nuk tregon asgjë konkrete apo nëpërmjet saj duhet të kuptohet fakti që Qeveria e Kosovës nuk është fare e interesuar për “Trepçën”. Gabimet e vazhdueshme, por edhe mosdashja, apo edhe mungesa e guximit të Qeverisë, kanë ndikuar që gjendja e “Trepçës” të jetë e mjerueshme.

Aktualisht, prodhimi i saj në miniera dhe në flotacione nuk e arrin as 1/5 e asaj që prodhohej dikur, apo të potencialit prodhues që ka aktualisht “Trepça”. Gjendja është duke u përkeqësuar edhe më tutje, meqenëse sipas raportit të Komisionit për Miniera dhe Minerale, vjet u nxorën vetëm 165 mijë tonë xehe, apo rreth 79% të sasisë së planifikuar. Nëse kjo çështje vështirësohet në një periudhë më të gjatë, atëherë del se “Trepça” vjet e ka pasur prodhimin më të ulët që nga viti 2008, pra është duke vazhduar degradimi i saj, krejt për shkak të mungesës së përkujdesjes dhe pritjes se çfarë do të ndodhë, çfarë do të thonë kreditorët. Do ta zhvatin pasurinë e saj, apo do ta çojnë deri në falimentim?

Rruga drejt shkatërrimit duket e qartë, kur kemi parasysh strukturën e prodhimit. Si produkt final, këtu është koncentratit. Vjet nga shitja e koncentratit të prodhuar në flotacionin në Tunel të Parë dhe në Kishnicë janë realizuar mbi 16 milionë euro, derisa po të përpunohej në metal, pas mbulimit të gjitha shpenzimeve, si fitim do të mbeteshin mbi 4 milionë dollarë, ndërsa në vitin 2013, mbi 5 milionë dollarë.

Nëse vërtet nuk ka pasur zgjidhje për kapacitete përpunuese, për çka unë dyshoj, atëherë është dashur të gjendet zgjidhje më e mirë për minierat si pasuri kombëtare. Gjendja ka mundur të duket kryesisht ndryshe, por Qeveria është dashur të sillte ndryshe. Nën një, ajo nëpërmjet Kuvendit të Kosovës të kërkojë nga Agjencia Kosovare e Privatizimit që “Trepçën” ta trajtojë njësoj sikur të gjitha ndërmarrjet e tjera shoqërore, pra që disa pretendime ndaj saj të shikohen në Odën e Veçantë dhe atje të presin derisa të përmbyllet procesi i privatizimit apo të rikonstruimit të saj.

Nën dy, të ndryshohet dhe të plotësohet Ligji për riorganizimin e ndërmarrjeve të veçanta, ashtu që “Trepça” të mos mbetet peng i kreditorëve të kohës së Milosheviqit.

Nën tre, nëse Qeveria nuk ka fuqi që t'i bëjë këto ndryshime, atëherë të nisë procedurën që "Trepçën" ta shpallë ndërmarrje publike dhe t'i pranojë të gjitha obligimet që ajo i ka. Ky variant ishte i pranueshëm dhe i papërballueshëm, meqenëse sipas disa studimeve që i kanë bërë ekspertët e "Trepçës", nuk duhen shumë para për aktivizimin e saj, ndoshta sa gjysma e buxhetit që ka Ministria e Infrastrukturës. Në anën tjetër, me pretendentët duhet të hyjë në procesin e riprogramimit të borxheve, të cilat mund të shlyhen në një periudhë më të gjatë kohore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Izmaqi e ka fjalën.

XHEVAHIRE IZMAKI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë do ta përfshij në fjalën time kontestin e çështjeve sociale. Pra, ndërmarrjes "Trepça", pas çlirimit të vendit, përveç tjerash, iu desh të ballafaqohet me shumë probleme sociale. Mijëra punëtorë të "Trepçës", që u larguan dhunshëm nga puna në vitet e '90-ta nuk kanë mundur të kthehen në punë shumica prej tyre deri më sot. Arsytet dihen, shkatërrimi i vazhdueshëm që iu bë "Trepçës" që nga vendosja e masave të dhunshme e deri në periudhën e keqmenaxhimit nga UNMIK-u. Më së rëndi e pësoi industria përpunuese e metaleve dhe ajo kimike, e cila, për shkak të dëmtimeve, nuk po mund ta marrë veten edhe tani. Po ashtu, u humb edhe tregu dhe partnerët strategjikë. Mbi 2 500 punëtorë të këtij gjiganti industrial mbetën pa punë.

Me një udhëzim administrativ, Qeveria e atëhershme e Kosovës do t'i fusë ata në skemat e pensioneve të parakohshme, duke ndarë mjete nga buxheti dhe një pjesë nga vetë ndërmarrja.

Edhe pse kjo ishte një shumë tepër e vogël, megjithatë punëtorët e "Trepçës" ishin ata dhe të vetmit që e përfitojnë këtë lloj ndihme nga shteti prej të gjithë punëtorëve të ish-ndërmarrjeve shoqërore e publike që mbetën pa punë. Në vitin 2010, ata do ta kenë një rritje lineare prej 20 eurosh për të gjithë përfituesit e këtyre skemave sociale, por edhe ata që patën fatin të rikthehen në punë, deri në fund të vitit 2008, do të marrin paga shumë të ulëta. Kështu, në vitin 2008, mesatarja neto e pagave në nivel të gjithë ndërmarrjeve, "Trepça" ishte me vetëm 218 euro, ndërkaq aktualisht mesatarja e këtyre pagave është afërsisht 500 euro.

Nga viti 2009 deri në vitin 2012, në "Trepçë" janë punësuar 439 punëtorë të rinj, përfshirë 112 të tjerë, të rinj pra, që u zëvendësuan me prindërit e tyre të vjetër. Këta punëtorë do ta ulin ndjeshëm moshën e punëtorëve të "Trepçës", që dikur kishte arritur në 55 vjeç. Punëtorët e rinj që erdhën në "Trepçë", të cilët paraprakisht u trajnuan, ishin kryesisht nga komuna e Mitrovicës, por edhe të komunave përreth, si: Vushtrria, Skenderaj, Artana e Prishtina. Konkretisht deri në vitet e '90-ta, për shembull, komuna e Vushtrrisë kishte 700 të punësuar, ndërsa sot ka vetëm 120 punëtorë të rinj, por janë edhe 300 pensionistë dhe mund të them se, përveç ngritjes së pagave, punëtorëve të "Trepçës" u janë përmirësuar dukshëm edhe kushtet e tjera, si: ushqimi, transporti, kujdesi mjekësor dhe mjetet e punës.

Të nderuar kolegë deputetë,

Prodhimi në minierën e “Trepçës” filloi në verën e vitit 2005. Deri në vitin 2008, kjo ndërmarrje punoi me humbje, me gjithë grantet dhe subvencionet që ndante Qeveria e Kosovës. Vitin 2008, kjo ndërmarrje e kishte përmbyllur me mbi 3,5 milionë euro humbje, me borxhe të shumta ndaj operatorëve dhe partnerëve ekonomikë, të cilët nuk arrijnë pra t’i paguajnë as faturat e rrymës, ujit, telefonit e për tatimet ndaj shtetit as që bëhet fjalë.

Me një fjalë, ndërmarrja ndodhej buzë greminës, por e them e bindur, edhe në bazë të informacioneve që kam marrë nga inxhinierët e Komunës së Vushtrisë, të cilët punojnë aty, që në krye të saj e deshi fati që më 15 dhjetor të vijë inxhinieri dhe doktori i gjeologjisë, zoti Ferat Shala, i cili për një kohë të shkurtër, me shumë përgjegjësi, arriti që në kulmin e krizës ta ndryshoj gjendjen rrënjësisht për të mirë. Pas një viti, nënë drejtimin e tij, ndërmarrja arriti që humbjet nga 3,5 milionë euro t’i zvogëloj në 100 000 euro. Ndërkaq, ndërmarrja, pasi filloi të këndellet, fillo t’i kthente borxhet e grumbulluara me vite, me një dinamikë të programuar, në marrëveshje me partnerët e saj.

Nga viti 2008, ndërmarrja e mori veten sërish dhe deri më tani punon me afarizëm pozitiv. Të gjitha këto po ndodhnin si rezultat i menaxhimit të shkathtë, të bazuar në parametra shkencorë, por edhe ekonomikë. Prodhimi u rrit për rreth 20% në vit, duke u rritur në këtë mënyrë edhe të hyrat e ndërmarrjes. Kështu, përderisa në vitin 2008 u prodhuan mbi 90 mijë tonë xehe, në vitin 2012 u nxorën mbi 1 milion e 600 mijë tonë xehe të plumb-zinkut, apo rreth 80% më shumë. Ndërkaq, të hyrat vetjake të “Trepçës” në vitin 2008 ishin mbi 4,2 milionë, kurse pas tre vjetësh ato gati u katërfishuan, duke arritur në 15 milionë euro.

Kështu, “Trepça” u bë njëri nga eksportuesit më të mëdhenj të vendit tonë, dhe për këtë në vitin 2011, nga Ministra e Tregtisë dhe Industrisë, do ta fitojë çmimin si eksportuesi më i mirë i vitit. Ndërmarrja arriti të koepërojë me partnerë të fuqishëm afarist, si ‘Glencore’, ‘Atlas Kopko’, duke e rikthyer imazhin e vet, por edhe imazhin e shtetit tonë. U modernizua administrata e ndërmarrjes, duke u digjitalizuar dhe u vunë bazat e një bashkëpunimi të fuqishëm, si me partnerët afarist, po ashtu edhe me institucione dhe mekanizma ndërkombëtarë, siç janë: Oda Ekonomike Amerikane, USAID, JIKA, NDP dhe të tjera.

Një rëndësi të veçantë, menaxhmenti i kësaj ndërmarrjeje i ka kushtuar trajnimit të stafit inxhinierik dhe menaxhues, si në vend, po ashtu edhe jashtë vendit, në Itali, për shembull, në Çeki, Gjermani, Austri dhe vende tjera. Dhe, nuk është lënë anash as marketingu dhe promovimi i potencialeve ekonomike të kësaj ndërmarrjeje nëpërmjet botimeve të shumta, revistave, medieve vendore, por edhe ndërkombëtare. Aktualisht, “Trepça” ndodhet në pozitë shumë më të mirë se sa ka qenë ndonjëherë pas luftës, për t’i hyrë një procesi të ristrukturimit të saj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Zemaj, nuk është këtu. Zoti Idrizi e ka fjalën.

NIJAZI IDRIZI: I nderuari kryesues, unë fjalën time do ta dorëzoj me shkrim në Sekretarisë. Faleminderit!

Pjesë e diskutimit me shkrim

Gjatë gjithë kohës së pushtimit, “Trepça” ka qenë shpresa dhe dëshpërimi ynë dhe ka rënduar në ndërgjegjen tonë, bashkë me pushtimin si dy robëri. Edhe sot në kohën e lirisë, sa herë që asaj i dalin probleme, ne ato i përjetojmë rëndë dhe arsyeja na mjegullohet nga ndjenja.

“Trepça” i ka 83 vjet jetë. Për shumë vite, falë potencialit të madh dhe kualitetit të mineraleve është zhvilluar një industri e rëndë, e cila i ka përpunuar metalet deri në finalizim.

Qeveria serbe në vitet e ‘90-ta, në kohën e Milosheviqit, disa asete të “Trepçës” ua ka dhënë me koncesion disa kompanive të huaja, të cilat edhe sot janë pretendente ndaj tyre.

Megjithatë, Qeveria e Kosovës mbetet pretendentja më e madhe. Pretendent janë edhe punëtorët, bankat etj.

Sot “Trepça” nuk është ndërmarrje me të cilën ne mund të krenohemi.

Ajo po mbijeton vetëm nga nxjerrja e mineraleve, të cilat po shiten si koncentre, me vlerën e tyre të ulët.

Me të hyrat nga kjo shitje, po mirëmbahen disa objekte dhe po u shpërndahen rrogat punëtorëve.

Ajo nuk po funksionon si e integruar, por me 2 (dy) menaxherë, (një në jug, e tjetri në veri), të cilët lëre që nuk bashkëpunojnë, por as nuk shihen me njëri-tjetrin kurrë. Madje, menaxheri Jovan Dimkiq, i cili e ushtron këtë funksion që nga koha e luftës, si duket me vendim të përjetshëm, nuk i jep kurrë llogari AKP-së, edhe pse me ligj është vartës i saj, por i raporton UNMIK-ut, sipas rregulloreve, me të cilat ende punon.

Atje pa marrëveshje me AKP-në janë shpallur tenderët për shfrytëzimin e aseteve. Ajo është jashtë kontrollit e paeksploatuar, madje edhe po subvencionohet, megjithëse në raportin e Auditorit të Përgjithshëm për pjesën veriore të “Trepçës” nuk ka asnjë shënim konkret.

Tash kemi filluar edhe subvencionimin e “Trepçës” (këtë vit 5 milion/€) për rroga dhe nxjerrje të mineraleve, edhe pse është folur vazhdimisht për fitime që po bëhen nga “Trepça”. Nëse është kështu, atëherë shtrohet pyetja: Pse duhet të subvencionohet afarizmi me fitim?

Nga përvoja e disa ndërmarrjeve, e kemi vërejtur se:

Sa herë që menaxhmenti i tyre kishte komoditet në manaxhimin e ndërmarrjeve, ata i ankoheshin Qeverisë për humbje dhe kërkonin mbështetje. Por, kur ndodhte që të flitej negativisht në opinion për punën e tyre, atëherë të njëjtit flisnin për suksese e fitime.

Kjo gjendje nuk duhet të vazhdojë. Ne nuk na duhen ndërmarrje që janë barrë të buxhetit të shtetit dhe që i zvogëlojnë resurset e paripërtëritshme, të cilat janë pasuri edhe e brezave pas nesh.

Zgjidhja:

1. Të zgjidhen kontestet e pretendentëve 1milyard/\$,
2. Të ndërmerren hapa për ristrukturimin e saj në proces,

Trepça duhet të transformohet dhe të menaxhohet me PPP, si njëra nga metodat më të mira të shfrytëzimit të këtyre resurseve.

Shfrytëzimi i këtyre resurseve nga investitorët e huaj është një mundësi reale, sepse, sipas njohurive tona, ka interesim nga ata që të investojnë në këtë fushë.

Për më mirë, tash edhe Ligji për miniera dhe minerale ka hyrë në fuqi, sepse disa paqartësi në të qenë bërë pengesë për investime të huaja.

Një tjetër problem është ndotja e madhe e tokës me grimca të metaleve të rënda, nga mbeturinat e trashëguara industriale. Sasia e tyre arrin në 60 M/t.

Duhet të hartohen strategji për trajtimin e tyre. Për ta zbatuar atë, na duhet që ta miratojmë Ligjin për mbeturinat industriale, të cilin ende nuk e kemi.

Sa i përket rekomandimit, më duhet të jua kujtoj se në vitin 2011 e kemi miratuar Ligjin për riorganizimin e ndërmarrjeve të veçanta, i cili në të vërtetë është Ligji për “Trepçën”.

Ne edhe po të duam ta specifikojmë krejt këtë ligj, një gjë të tillë nuk mund ta bëjmë pa e ndryshuar dhe plotësuar:

1. Ligjin për AKP-në,
2. Ligjin për Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme,
3. Ligjin për riorganizimin e ndërmarrjeve të veçanta.

Pjesa e përshkrimit nuk përputhet me rekomandimet e kërkuara!

Ne i kemi 5 nivele hierarkike të menaxhimit të “Trepçës”, që janë çudi. Nuk thonë kot: Shumë gjyshe e lënë fëmijën ‘hudum’.

Nijazi Idrizi, d.v.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Vataj e ka fjalën.

RAMË VATAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,
Kolegë deputetë,

Unë po e shfrytëzoj rastin të kontribuoj në diskutimin tim lidhur me ndërmarrjen “Trepça”, që lirisht mund të themi se është gjigant në nivel regjional në nxjerrjen dhe përpunimin e xehes, plumbit, zinkut, argjendit, arit e të tjera.

Unë do të diskutoj për tri aspekte të ndryshme të ndërmarrjes “Trepça” në investimet kapitale që janë bërë aty, aspektin e mjedisit dhe anën e bukurive natyrore që reflektojnë kristalet e “Trepçës” dhe karakterit shkencor të tyre.

Që nga paslufta, ndërmarrja “Trepça” është subvencionuar nga shteti dhe me mbi 100 milionë euro, ndërsa vetëm nga viti 2008 deri në vitin 2013, kuptohet pjesa jugore është ndihmuar nga buxheti i shtetit me 23 450 000 euro. Nga kjo shumë mjetesh, 11 662 000 euro janë shpenzuar për investime kapitale, kurse pjesa tjetër është shfrytëzuar për paga dhe ‘stipendi’. Me mjetet e investimeve kapitale, të ndara nga buxheti i shtetit, së bashku me mjetet vetjake të ndërmarrjes “Trepça”, janë blerë makineri dhe pajisje moderne, të cilat kanë ndikuar në rritjen e produktivitetit në miniera dhe në siguri në punë dhe rentabilitet. Po ashtu, një pjesë e mirë e këtyre mjeteve janë shpenzuar për hapjen dhe përgatitjen e punishteve të reja në miniera dhe rinovimin e fabrikave të pasurimit, përkatësisht në flotacion.

Një investim tjetër kapital nga Komisioni Evropian është zbatuar nga inxhinierët dhe teknikët e minierës së Stan-Tërgut dhe është bërë për ndërtimin e impiantit të hidrombushjes. Ky investim, në vlerë prej 700 000 eurosh, që përdor hirin e freskët të termocentraleve tona për hidrombushje, është nga më modernit në botë dhe ka përparësi të shumta, sepse e ul shkallën e varfërimit të xeherorit dhe mbush çarjet e shkëmbinjve, duke krijuar stabilitet në horizontet e minierës.

Gjatë punës së vet mbi 80-vjeçare, ndërmarrja “Trepça”, përveç dobisë ekonomike, ka shkaktuar edhe ndotje të shumta të mjedisit. Kështu, në rrethinat e Mitrovicës, Prishtinës, Artanës, Leposaviqit janë depozituar rreth 60 milionë tonë mbetje industriale, të cilat janë të grumbulluara përgjatë luginave dhe afër lumenjve. Këto mbetje që përmbajnë metale të rënda dhe helmuese kanë ndikim të lartë në ndotjen e mjedisit, përfshirë ujin, ajrin dhe tokën.

Megjithëse menaxhmenti i “Trepçës” në vitet e fundit ka bërë disa përpjekje për t’i zbutur këto probleme të mprehta mjedisore, prapëseprapë çështja mbetet serioze. Ky është një problem i madh mjedisor që nuk mund ta zgjedhë vetëm ndërmarrja “Trepça”, pa ndihmën e shtetit dhe bashkësisë ndërkombëtare. Me ndihmën e NDP-së, Qeverisë çeke, asaj holandeze, janë bërë disa studime për nivelin e ndotjes dhe rehabilitimin e disa deponive, megjithatë do të duhen edhe disa dhjetëvjeçarë për t’i zgjedhur në tërësi këto standarde sipas standardeve ndërkombëtare problemet e mjedisit.

Sipas disa analizave që janë bërë, disa nga këto mbetje kanë vlerë ekonomike dhe do të mund të ricikloheshin. Në këtë mënyrë, duke e pastruar mjedisin do të përfitonim edhe ekonomikisht nga ato. Kjo është kështu, sepse teknologjia përpunuese ka ecur shumë, kërkesa në tregun ndërkombëtar për metale me ngjyra është e madhe dhe çmimi i tyre është shumë i lartë.

Në kuadër të ndërmarrjes “Trepça” është muzeu mineralogjik, për të cilën pasuri të eksponateve na e kanë lakmi edhe shumë vende tjera. Duke e parë gjendjen e muzeut të vjetër të kristaleve, ku po rrezikoheshin mijëra eksponate me vlera të paçmuara, menaxhmenti i “Trepçës”, në vitin 2010, ka marrë nismën për ndërtimin e një muzeu të ri. Nismën e “Trepçës” e përkrahën dhe ndanë mjete për të Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe ajo e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor. Kështu, është ndërtuar muzeu i ri, duke u shndërruar në muze shtetëror të kristaleve. Njëkohësisht kristalet u vlerësuan si pasuri kombëtare dhe janë të mbrojtura me ligj.

Objekti i ri, që ka kushtuar mbi gjysmë milion euro, është i standardeve moderne dhe në të janë të ekspozuara rreth 1 800 eksponate me vlera të padiskutueshme muzeore. Të gjitha kristalet e kanë kodin e tyre të sigurisë dhe janë të digjitalizuara. Ky muze, përveç karakterit kulturor dhe turistik, ka edhe karakter shkencor dhe mund t’u shërbejë nxënësve të shkollave tona dhe studentëve të drejtimit të gjeo-shkencave për thellimin e njohurive të tyre në këtë fushë dhe për njohjen e pasurive kombëtare që i kemi në atë regjion.

Përveç këtyre investimeve të rëndësishme, që i përmenda, në këtë pasuri të madhe që natyra i dha Kosovës, duhet të vazhdojmë edhe më tutje me veprime konkrete në ristrukturimin, riaktivizimin dhe zgjerimin e punëve të “Trepçës”, duke gjetur investitorë nga sektori publiko-privat dhe nga mjetet e siguruara nëpërmjet bankave zhvillimore ndërkombëtare. Ristrukturimi dhe funksionimi më i mirë i ndërmarrjes “Trepça” duhet të jetë përkushtim i të gjithëve, pa dallim partiak dhe të rregullohet me ligj të veçantë, e që do të ishte së pari në dobi të Kosovës, popullit të saj dhe në fund edhe të punëtorëve të “Trepçës”. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Krasniqi e ka fjalën.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryesues!

Përsëritje për ministrat,

Deputetë të Parlamentit të Kosovës,

Unë për veten time e kam përgatitur një fjalë, të cilën tani jam në dilemë a ta them të tërën, sepse nga gjithë ajo që dëgjuam, nuk mund të them diçka të veçantë, sepse nga përbërja e deputetëve që diskutuan është një pjesë e tyre më kompetentë dhe më të përgatitur për këtë fushë për ta trajtuar këtë temë, dhe unë nga përmbajtja që kam në fjalën time nuk mund të them diçka të re. E kam vetëm një nostalgji, ndoshta edhe atë dilemën që e ka pasur një ministër, kur i kanë ofruar dorëheqjen, ma kujtoj një miku imi këtu. I thanë: tërhiqe dorëheqjen. Mirë, tha, unë po e tërheq dorëheqjen, por çka t’i bëj fjalimit, që e kam qëndisur. Nuk i dhimbsej dorëheqja, por i dhimbsej fjala që kishte përgatitur. Në këtë dilemë jam, por, megjithatë, kam respekt për durimin dhe kohën e çmuar që kemi përpara në pikat tjera, kështu që fjalën time unë do ta dorëzoj me shkrim në Sekretari. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! I fundit është zoti Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,
Të nderuar kolegë deputetë,
Këtë debat për “Trepçën” e konsideroj të qëlluar, ndoshta paksa edhe të vonuar. Ky Kuvend, qysh në legjislaturën e parë do të duhej ta trajtonte Trepçën si aset nacional dhe zhvillimor të saj. Atëherë do të duhej të ndërtohej strategjia zhvillimore e “Trepçës” nga këta deputetë që sot janë edhe udhëheqës të Kuvendit dhe të cilët sot po mbajnë fjalime moralizuese, ndërsa në kohën e UNMIK-ut bëheshin të dëgjueshëm për disa pozita lakmitare. U thanë shumë çështje dhe nuk dua të ju lodh shumë me historikun e “Trepçës”, se nga e ka marrë emrin dhe për parullat e për mitet për të, sepse ato sot i dinë edhe fëmijët e Kosovës, dhe mund të sigurohet edhe internet.

Dihet botërisht se në fillim të viteve të ‘90-ta, shumica dërmuese e punëtorëve të “Trepçës” u larguan nga puna dhe se në këtë kohë ajo u eksploatua pamëshirshëm nga regjimi okupues i Milosheviqit. Dëshiroj të besoj shumë se ky debat është iniciuar me qëllim për ta zhvilluar “Trepçën”, e nuk është bërë për qëllim politik, sepse nga përplasjet politike ajo ka pësuar mjaft.

Ju kujtohet se menjëherë pas luftës kanë dy menaxhmente në “Trepçë”, të cilët pretendonin se janë udhëheqës legjitimë. Njëri menaxhment, i mbështetur në atë kohë nga Lidhja Demokratike e Kosovës, dhe tjetri nga partitë e dala nga lufta. Menxhmenti që mbështetej në atë kohë nga Lidhja Demokratike thirrej në të drejtën e kthimit në pozicionet që kanë pasur në atë kohë në ish-Jugosllavi, duke e mohuar kështu realitetin e ri të krijuar dhe për kërkonin pozicionet e ish-Jugosllavisë, para masave të dhunshme të Milosheviqit. Ky menaxhment që atëherë mbështetej nga Lidhja Demokratike e Kosovës dhe propozuesi i këtij debati u kishte premtuar punëtorëve të “Trepçës”, minatorëve të saj paga nga 1 000 marka dhe pagesë retroaktive për 10 vjet, derisa ata nuk ishin në marrëdhënie pune. Minatorët shumë shpejt e kuptuan se ishin edhe në lajthitje nga ky menaxhment që mbështetej nga Lidhja Demokratike në atë kohë, andaj edhe e braktisën atë dhe iu rrekën punës për riaktivizimin e “Trepçës”, bashkë me menaxherin e atëhershëm, Safet Merovci.

Këto shtyrje të shqiptarëve se kush do të jetë menaxher i “Trepçës” i shfrytëzoj administrata e UNMIK-ut në atë kohë për ta futur atë nën ombrellën e vet dhe për ta ndarë në dy menaxhmente, të jugut dhe të veriut, ndërsa Serbia dhe pretendentët për pronësi në “Trepçë” e shfrytëzuan këtë periudhë këtë grindjeve ndërmjet shqiptarëve për të ngrehur padi kundër “Trepçës”, duke i bllokuar kështu prodhimet e saj në arenën ndërkombëtare.

Strategjia e dytë e Serbisë kishte të bëjë me plaçkitje të “Trepçës” menjëherë pas luftës, kur nga punëtorët serbë, të cilit ishin organizuar në atë kohë dhe punonin aty kishin organizuar makineri për plaçkitjen e saj dhe me anë të transportit u provua që makineria për prodhimin e baterive me rimbushje, aparaturë e cila ishte blerë një kohë më parë, të transportohej me kamionë nga jugu - parku industrial në veri. Ky qëllim i punëtorëve të organizuar nga Serbia u kuptua qytetarët e Mitrovicës, të cilët e bllokuan këtë vjedhje apo plaçkitje të makinerisë së “Trepçës” dhe kjo makineri nuk u lejua të plaçketej dhe sërish u kthye në parkun industrial, dhe asnjëherë nuk u vu në funksion.

Unë sot dua t'i falënderoj të gjithë ata qytetarë të Mitrovicës, të cilët e ruajtën "Trepçën" pas luftës. Dua t'i falënderoj pjesëtarët e TMK-së, duke mos harruar se "Trepça" një kohë është mbrojtur dhe ruajtur nga pjesëtarët e TMK-së, pa asnjë kompensim; dua t'i çmoj të gjithë ata minatorë dhe ekspertë të "Trepçës"; t'i falënderoj të gjithë ata të cilët e mbrojtën "Trepçën" nga fundosja dhe përmytja, duke rrezikuar kështu edhe jetën e tyre për ta shpëtuar një aset nacional dhe të gjithë ata minatorë, të cilët kontribuan edhe në ruajtjen, por edhe në mbajtjen gjallë dhe mospërmytjen e saj. Ata sot kërkojnë një falënderim të veçantë. Ata kërkojnë ë që ne të krijojmë kushte për zhvillimin e "Trepçës" dhe kjo është detyrë jona.

Minatorët dhe ekspertët e "Trepçës" nuk kanë shumë iluzione për të, por bazohen në parametra realë, sepse parametrat realë tregojnë se në kohën e okupimit në "Trepçë", trupat më të mirë xehorë janë eksploatuar në mënyrë të pamëshirshme dhe në këtë formë janë krijuar edhe dëme kolaterale, prandaj gjatë zhvillimit të procesit të "Trepçës" duhet pasur parasysh edhe këto fakte. Në "Trepçë" duhet pasur parasysh faktin se nuk është investuar për 40 vjet dhe teknologjia e prodhimit të saj është po ajo e para 40 vjetëve dhe nuk ka ndonjë avancim në teknologjinë e saj, si në atë të flotimit apo pasurimit të mineraleve. Prandaj, këto fakte duhet pasur parasysh kur të bëhet strategjia zhvillimore dhe kur të flasin për "Trepçën", duke mos pasur shumë iluzione për të, mirëpo duke u bazuar në parametra realë, investivë dhe zhvillimorë.

Trajtimi i "Trepçës" me ligj të veçantë është më se i domosdoshëm dhe është më se i mirëseardhur për zhvillimin e saj. Ne, një kohë më parë si Kuvend e kemi miratuar Ligjin për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara, mirëpo në atë kohë atij ligji nuk ia kemi vënë emrin Ligji për "Trepçën", mirëpo në konceptin e tij, në përmbajtjen e tij ai është ligji për Trepçën dhe mund të propozojmë që edhe ky Ligj për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara të bëjë plotësim-ndryshimin e tij dhe edhe me plotësim-ndryshimin e tij, duke parë që në këtë ligj janë inkorporuar të gjitha problematikat e "Trepçës", ta bëjmë Ligjin për Trepçën, dhe ky ligj për riorganizimin dhe ndërmarrjet e caktuara pastaj të quhet Ligji për Trepçën. Dhe, ajo që më së paku ne si Kuvend mund të bëjmë është ta njohim stazhin dhe trajtimin me ligj të minatorëve të pensionuar, sepse më së paku kjo që mund të bëjmë ne për ta dhe besoj që këtë ua kemi obligim minatorëve për arsye se ata ishin bartës të shumë proceseve nacionale dhe kombëtare për çlirimin e vendit dhe ata do të jenë dhe "Trepça" do të jetë bartëse zhvillimore e Kosovës. Faleminderit!

(Mbledhjen e merr nën drejtim kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi.)

KRYETARI: Diskutimet janë kryer. Fjala përfundimtare për përfaqësuesin që e ka kërkuar debatin, deputetin Sadri Ferati.

SADRI FERATI: Faleminderit, kryetar!

Do ta keqpërdor këtë mundësi që m'u dha në fjalën përfundimtare. Para kësaj të them që nuk do të nxitohem të diskutoj se cila ishte LDK-ja, e cila PDK-ja dje; cila ishte "Trepça", cili është kontributi, cilat janë premtimet, realizimet dhe mosrealizimet, por unë me diskutuesin e fundit, kolegun Bekim pajtohem që duhet t'i ndihmohet "Trepçës"

dhe duhet të nxirret ligji i veçantë për “Trepçën”, ndërsa në pjesën tjetër e rezervoj të drejtën time që në një rast tjetër të hapim debat të kësaj natyre, bash të kënaqemi deri në fund, por sot po them se ishte jashtë teme dhe, përkundrazi, në kohën kur ti po e thua për LDK-në, kryeministër ka qenë Bajram Rexhepi, e pastaj tjera prapa. Faleminderit!

Prandaj, i nderuar kryetar, pas gjithë debatit, bazuar pra në iniciativën që të diskutohet, të hapet një debat në lidhje me situatën e krijuar në “Trepçë” dhe domosdonë që Parlamenti, në kuadër të përgjegjësisë të veta, ta luajë rolin e vet pozitiv, në mënyrë që të krijohen kushte dhe mundësi që “Trepça” të punojë e papenguar me kompetencë të plotë në vendimmarrje, me qëllim që të shfrytëzohen të gjitha resurset dhe kapacitetet, të cilat do të gjenerojnë zhvillim dhe vende të reja të punës dhe i gjithë debati, thuaja pa përjashtim, e ka ushqyer gjatë gjithë kohës këtë ide.

Prandaj, duke i falënderuar të gjithë deputetët që dhanë kontribut në këtë çështje dhe kishte një pajtueshmëri të plotë se Kuvendi duhet t’i nxjerrë dhe t’i miratojë konkluzionet që do të çojnë në realizimin e këtij qëllimi.

Prandaj, e thërras Kuvendin që të votohen rekomandimet, pra që Qeveria të autorizohet që në afat prej 3 muaj ta hartojë ligjin në bashkëpunim me krejt aktorët e tjerë të involvuar në këtë çështje dhe ta sjellë në Kuvend për miratim, me çka nuk do të cenohen, edhe një herë po e theksoj, kompetencat e Gjykatës së Veçantë, nuk do të cenohet natyra e pronës, por do të krijohen kushtet për punë dhe zhvillim. Faleminderit!

KRYETARI: Diskutime tjera nuk ka. Fjala e fundit është 5 minuta, diskutimet janë harxhuar. Është rregull, është mirë ta mësoni dhe ta dini. Lexojeni Rregulloren! Rregullorja është e drejta e kërkuesit t’i ketë 5 minuta. Dhe, u krye. A i keni harmonizuar...?

(Reagime nga salla)

Ju lutem, është puna se është mbyllur debatit. Jo, fjalën nuk ia jap askujt. Është kryer, fjala e tij është e fundit. Ky rend është. Kur ta ndryshoni Rregulloren, mund ta ndryshojmë këtë çështje, por Rregullorja kështu thotë.

(Reagime)

Propozim, për çka? Fjalën e ka Adem Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar, sa e dëgjuam të gjithë deputetët, të gjithë pothuaj se i kemi qëndrimet e përafërta, por Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës kërkon nga propozuesi që t’i harmonizojmë qëndrimet bashkërisht të gjitha grupet parlamentare dhe pas harmonizimit, me qëllim që të dalim me një qëndrim unik, unë kërkoj nga propozuesi që votimi të mbetet pas harmonizimit për një seancë tjetër të votohet.

KRYETARI: Në emër të LDK-së, deputeti Arben Gashi e ka fjalën.

ARBEN GASHI: Faleminderit, kryetar!

Ne mendojmë se duhet të procedojmë, sepse është vetëm një rekomandim që i rekomandohet Qeverisë në afat prej 3 muajsh ta nxjerrë një ligj për “Trepçën”. Ne nuk po e detyrojmë çfarë do të ketë ai ligj, thjesht po kërkojmë të trajtohet me ligj dhe fryma që ekzistoi Kuvend, është që “Trepça” të trajtohet me ligj të veçantë dhe kërkojmë që të procedohet dhe të votohet. Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, urdhëro!

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit, kryetar!

Unë mendoj që është mirë të harmonizohem. Sigurisht që ne e kemi një ligj, i cili është Ligj për ndërmarrjet me interes të veçantë. E kemi thënë më herët. Ndoshta, fundi i fundit, t’i ndërrohet emri i atij ligji, apo diçka tjetër. Kuvendi mund të vendosë sigurisht, por do të ishte mirë që të harmonizohen edhe me grupin parlamentar dhe të mos marrim vendime të tilla, sepse konsideroj sigurisht që Kuvendi prapë do të vendosë për një ligj të tillë. Por, ju bëj ftesë që lidhur me këto gjëra të harmonizohemi, sepse nuk është ligj i cili nuk është diskutuar. Ne e kemi sjellë para pak muajsh një ligj të tillë, i cili e trajton çështjen e “Trepçës” dhe ka nevojë ende për t’u harmonizuar. Do të ishte mirë që të harmonizohet, e jo të marrim tash një vendim, i cili mund të sjellë probleme. Fundi i fundit, nëse veç do, Kuvendi mund të marrë edhe vetë nismë legjislative, por do të ishte mirë që të harmonizohemi, e jo të marrim qëndrime të tilla.

KRYETARI: Urdhëro, nënkryetari Sabri Hamiti e ka fjalën i fundit.

SABRI HAMITI: Zoti kryetar!

Unë mendoj që dy diskutimet e fundit janë jashtë Rregullores, por meqë e dhe shansin që të flitet, po e them veç një fjalë. Edhe këta i dëgjova dhe s’ka çfarë harmonizohet. Ne s’po votojmë ligj për “Trepçën” sot, por është kërkesë që të hartohet ligj. Askush s’po e voton ligjin për “Trepçën” sot, por nevojën që ky kompleks, ky aset, të trajtohet me ligj, mandej vjen ligji, mandej e shohim e plotësojmë, e harmonizojmë ligjin. Sot votojmë për nevojën që të hartohet një ligj për “Trepçën”, edhe 10 ditë nëse bëjmë mbledhjen, ne vijmë në këtë propozim. Prandaj, ju lus hidheni kërkesën në votim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Do të thotë, kërkuesi e ka bërë mocionin, kërkesën për debat, kërkohet të hidhet në votim. Të pranishëm janë 73 deputetë. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. E votojmë rekomandimin që ka dalë nga debati dhe nga kërkesa e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se me 49 vota për, 17 kundër dhe 3 abstenime miratohet rekomandimi.

(Duartrokitje)

Të nderuar deputetë,

E kalojmë pikën e parafundit, dalim te pika e fundit, pasi ashtu ka kërkuar ministri, meqë është i zënë, që ta prezantojë së pari.

A jeni dakord. Mirë, faleminderit!

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Avokatinë

Urdhëro, ministër, e ke fjalën.

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Faleminderit!

I nderuar kryetar i Kuvendit,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që ta paraqes para jush për miratim Projektligjin për Avokatinë, i cili është aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, më 27.2.2013.

Miratimi i këtij projektligji do të mundësojë plotësimin e infrastrukturës ligjore në fushën e drejtësisë në Republikën e Kosovës, si dhe eliminimin e zbrazëtirave dhe mangësive ligjore në fushën e Avokatisë.

Ministria e Drejtësisë e ka përgatitur këtë projektligj në koordinim me Odën e Avokatëve të Kosovës, duke marrë parasysh propozimet dhe sugjerimet e saj, si dhe ndryshimet e nevojshme në legjislacionin e Kosovës.

Me këtë projektligj do të rregullohen dhe përcaktohen kushtet për ushtrimin e Avokatisë, mënyrat dhe format e punës, të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e avokatëve dhe praktikantëve, avokatëve të huaj, organizimi dhe puna e Odës së Avokatëve të Kosovës, si dhe çështje tjera të rëndësime për ushtrimin e Avokatisë.

Ndryshimet e bëra në këtë ligj janë në frymën e harmonizimit të legjislacionit vendor me legjislacionin e vendeve të Bashkimit Evropian, në kuadër të proceseve të përgjithshme të hartimit të legjislacionit në sistemin e drejtësisë.

Me këtë projektligj, Avokatia përcaktohet si profesion i lirë dhe i pavarur që merret me dhënien e ndihmës juridike personave fizikë dhe juridikë, për mbrojtjen e lirive të të drejtave dhe të interesave të tyre, në pajtim me rendin juridik.

Ky projektligj i përcakton kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen nga kandidatët që synojnë profesionin e avokatit në Republikën e Kosovës, duke i përcaktuar edhe kushtet dhe procedurat për ushtrimin e Avokatisë nga avokatët e shteteve tjera.

Me qëllim të mbrojtjes dhe personave fizikë dhe juridikë me rastin e ofrimit të ndihmës juridike nga avokati, me këtë Projektligj të gjithë avokatët janë të detyruar që të sigurohen ndaj përgjegjësisë profesionale në institucionin që është i regjistruar për këtë lloj të sigurimit.

Me këtë projektligj përcaktohen mënyrat e bashkëpunimit, koordinimit dhe mbikëqyrjes së punës së Odës së Avokatëve me institucione tjera, në radhë të parë me Kuvendin, Qeverinë dhe Ministrinë e Drejtësisë.

I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar deputetë,

Duke marrë parasysh rëndësinë e këtij projektligji për rregullimin dhe plotësimin e infrastrukturës ligjore në fushën e drejtësisë, eliminimit të zbrazëtirave dhe mangësive të ligjit ekzistues, si dhe me qëllim të avancimit të standardeve më të larta në ofrimin e shërbimeve sa më cilësore nga avokatët, ju ftoj që ta miratojmë Projektligjin për Avokatinë në parim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Kryetari i Komisionit për Legjislacion, deputeti Arben Gashi e ka fjalën.

ARBEN GASHI: Faleminderit!

Unë po flas në emër të Komisionit, dhe pastaj në emër të Grupit, për arsye të kohës, nëse më lejohet.

Komisioni për Legjislacion e ka shqyrtuar këtë projektligj me prioritet dhe e ka dhënë mundësinë që seanca ta shqyrtojë.

Sa i përket Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, unë dua të përmend këtu se e ka shqyrtuar me kujdes dhe e thekson një realitet, se edhe vitin e kaluar ka qenë në procedurë i njëjti ligj dhe me kërkesë të mazhoransës së sotme dhe të atëhershme, shumicës së sotshme dhe atëhershme parlamentare, ka hyrë që avokatët të huaj nuk mund të ushtrojnë profesionin në Kosovë.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, edhe atëherë, edhe sot, ka qenë i mendimit se përderisa ka gjykata dhe gjykatës ndërkombëtarë, ka prokurorë ndërkombëtarë, duhet të ketë edhe avokat ndërkombëtarë, që të krijohen kushte të barabarta për mbrojtje.

Në këtë kuptim, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike e përkrah për shqyrtim të parë këtë projektligj dhe jep mundësinë që të trajtohet më tutje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Partisë Demokratike, deputeti Halit Krasniqi e ka kërkuar fjalën.

HALIT KRASNIQI: Edhe në Grupin Parlamentar të Partisë Demokratike është shqyrtuar ky projektligj dhe është përkrahur unanimisht. Është e vërtetë se unë personalisht në emër të Grupit i kam parashtruar pyetje ministrit për mundësinë e ndryshimit të këtij ligji dhe në koordinim me Odën e Avokatëve ka ardhur një koncept i ri dhe tash e kemi projektligjin e ri, të cilin Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e përkrah në tërësi.

Dhe, gjatë punës deri në leximin e dytë nëpër komisione do ta japim kontributin tonë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të “Vetëvendosjes”, deputetja Albulena Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Meqë është projektligj shumë i rëndësishëm sigurisht që do të marr pak më shumë kohë se grupet tjera parlamentare për t’i thënë vërejtjet tona sa i përket këtij projektligji.

Pra, pa dyshim që Projektligji për Avokatinë është akt shumë i rëndësishëm ligjor, ngase ky projektligj ndërlidhet në rend të parë edhe me të drejtat e palëve në procedurën gjyqësore, si dhe është i ndërlidhur me sferën e ushtrimit të lirë të profesionit.

Në këtë drejtim, mendoj se është tejet e nevojshme që të kihet kujdes lidhur me përmbajtjen e këtij projektligji, sidomos kur kemi parasysh ekzistimin e shërbimit noterial.

Në këtë aspekt, në vijim janë disa sugjerime që duhet kihen kujdes të veçantë në shqyrtimin e dytë.

Në nenin 10, paragrafi 4 të Ligjit, në të cilin janë përfshirë kushtet për regjistrimin e avokatëve në Odë, është paraparë se profesorëve dhe profesorëve inordinarë, në kuadër të së drejtës së dhënies së mendimit dhe këshillave profesionale, nuk u njihet e drejta e përpilimit të shkresave, siç janë përfshirë në përkufizimin e këtij ligji, ku përfshihen ankesat, kërkesat, paditë, kontratat dhe shkresat tjera formale.

Kjo praktikë nuk vjen në zbatim fare, ngase vetë këto shkresa në të shumtën e rasteve nuk kërkohet ta kenë një formë të sanksionuar me ligj.

Tek neni 21, paragrafi 3, është përkufizuar një terminologji lidhur me dokumentin, i cili ka karakter ekzekutiv në procedurën përmbartimore, e që në këtë paragraf është emëruar si dokument autentik, e që më korrekte do të ishte të titullohej si dokument ekzekutiv, apo titull ekzekutiv.

Në nenin 23, paragrafi 1.5, dhe paragrafi 1.6, ku janë të përfshira kushtet për regjistrimin e avokatëve dhe praktikantëve, është përfshirë kushti i kryerjes së veprës penale, i cili është kusht përjashtues tek e drejta e fitimit në regjistrim si avokat, apo si praktikant.

Këtyre kritikave me theks të veçantë duhet t’u vihet kushti që u është vënë praktikantëve, ngase me këtë kusht i abstraktojnë personat që e kanë vuajtur dënimin për veprën e caktuar penale dhe në këtë mënyrë drejtpërdrejt e cenojmë qëllimin e dënimit si instrument për parandalimin dhe luftimin e kriminalitetit, e që sipas shkencës bashkëkohore të penologjisë qëllimi parësor është risocializimi i të dënuarit dhe parandalimi i recidivizmit penal. Ky kusht duhet të fshihet, sidomos te kushtet e praktikantëve.

Në nenin 36 të ligjit është paraparë heqja e lirisë së avokatit dhe bastisjes së zyrës së tij. Kjo është një çështje mjaft e ndjeshme, sidomos kur kihet parasysh fakti se avokatët gjithmonë paraqiten në kategorinë e dëshmitarëve që përjashtohen nga detyrimi për të dëshmuar, apo dëshmitarët e privilegjuar, siç edhe quhen ndryshe.

Është e domosdoshme që në këtë nen të shtohet një paragraf, se zyra e avokatit nuk mund asnjëherë të bastiset, e në rast se kjo bastisje i shërben procedurës në të cilën avokati është përfaqësues i palës në procedurë.

Edhe pse në dispozitat e paragrafit 5 është thënë se nuk mund të shfrytëzohen kundër palës së avokatit gjësendet që merren gjatë bastisjes, mendoj se më mirë është që edhe avokati të kursehet nga çfarëdo ngarkese që mund të ketë lidhur me procedurën në të cilën është përfaqësues.

Çështja e cila i përket mbrojtjes së palës nga avokati i shtetit të huaj bie në kategorinë e të drejtave kushtetuese, e cila është po ashtu kategori e të drejtave të njeriut, që është e sanksionuar në nenin 30 të Kushtetutës së Kosovës.

Në përgjithësi, pa e specifikuar nënshtetësinë e mbrojtësit të të akuzuarit sipas paragrafit 5 të nenit 30 të Kushtetutës, është paraparë e drejta e zgjedhjes së mbrojtësit nga i akuzuari, apo në kuptim të gjerë është e drejtë e palës të zgjedhë se kush do t'i ofrojë ndihmë juridike në procedurë gjyqësore.

Duke qenë e drejtë e njeriut, është e vërtetë se Kushtetuta ka paraparë që të drejtat e njeriut mund të kufizohen në raste të veçanta, e kur për këtë ka një arsyeshmëri të caktuar, e sipas kuptimit të Kushtetutës së sanksionuar me dispozita kushtetuese të nenit 55, kjo mund të bëhet vetëm për arsye të sigurisë së përgjithshme dhe mbrojtjes së rendit shoqëror.

Pra, mendoj që projektligji aktual duhet të harmonizohet me Kushtetutën, meqë në projektligj përmendet reciprociteti, mirëpo kjo bie ndesh me Kushtetutën, meqë të akuzuarit kanë të drejtë ta angazhojnë këdo për avokat.

Nëse e analizojmë strukturën e legjislacionit të vendeve të rajonit, e shohim që edhe Kroacia e ka kështu si po e them të drejtën e angazhimit të avokatëve të huaj. Edhe Bosnjë-Hercegovina, edhe Mali i Zi i kanë kështu të rregulluara.

Dhe nuk e di se pse e kanë futur në paragrafin 2 se shtetasit amerikanë kanë të drejtë ta ushtrojnë profesionin e avokatit, kur Amerika bie nën sistemin anglosankson, ndërsa sistemi i së drejtës sonë është kontinental. Pra, mendoj që këto janë probleme kryesore sa i përket këtij projektligji.

Meqë kemi shumë probleme, si teknike, ashtu edhe përmbajtjesore, ne si subjekt politik në këtë fazë nuk do ta mbështetim këtë projektligj dhe do të insistojmë që në shqyrtimin e dytë të bëjmë amendamente konkrete. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Aleancës, kryetari Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Aleanca do ta mbështesë këtë projektligj në lexim të parë do të thotë në parim. Mendojmë se gjatë shqyrtimit të dytë duhet që në procedurë të shqyrtimit të kyçen edhe Oda e avokatëve edhe institucione tjera të cilat do të mund të ndihmonin që ky ligj të jetë sa më i mirë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, deputeti Jeton Svirca e ka fjalën.

JETON SVIRCA: Faleminderit, kryetar!

Edhe Koalicioni për Kosovë të Re e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe në parim e përkrahim. Kontributin tonë do ta japim në komisionet funksionale. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nga grupet tjera s'ka. SLS-ja nuk është lajmëruar. Atëherë fjalën e ka deputetja Aurora Bakalli.

AURORA BAKALLI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Disa avokatë që i kam konsultuar shprehen se drafti final, të cilin e kemi përpara vetes sot, si duket, pas komenteve të pranuar nga avokatët e Odës së Avokatëve të Kosovës ka pësuar mjaft ndryshime në aspektin pozitiv nga forma e mëhershme dhe shumica e dispozitave që kanë qenë shqetësuese për ta tani më janë rregulluar në përputhshmëri edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Ndërsa vërejtjet që i kam nga konsultimet me ekspertët e fushës janë:

Neni 26, pika 6 e këtij ligji ia njeh avokatit imunitetin nga ndjekja penale, paditë civile dhe në të njëjtën kohë nuk e lejon Odën e Avokatëve të Kosovës që t'ia marrë licencën avokatit për mendimin e shprehur dhe veprimet e ndërmarra brenda fushëveprimit të detyrave dhe përgjegjësisë të avokatit.

Nga ky përkufizim lind pyetja se kush ka të drejtë t'ia marrë imunitetin avokatit, i cili imunitet po i jepet me këtë draftligj, ose nëse avokati gjatë ushtrimit të profesionit të tij për dhe në emër të një pale e këshillon të njëjtin gabimisht, ose ndërmerr ndonjë veprim, i cili është i gabueshëm dhe rezulton me humbjen e rastit, apo kontestit për të cilin pala paditëse, apo e paditur ka pasur të drejtë. Atëherë lind pyetja se si pala, e cila është përfaqësuar nga avokati që ka gabuar, nuk ka të drejtë në shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga avokati? I tërë ky përkufizim është në kundërshtim me institutin e shpërblimit të dëmit, i paraparë me dispozita të veçanta në Ligjin mbi marrëdhëniet e detyrimeve, pasi ai që i shkakton tjetrit dëm është i detyruar që të dëmtuarin ta shpërblejë me dëmin, nëse nuk dëshmohej e kundërta.

Pastaj lind pyetja se nëse avokati ka imunitet nga paditë civile, pse ligjdhënësi e ka paraparë nëpërmjet këtij draftligji sigurimin e detyrueshëm ndaj përgjegjësisë

profesionale? E që arsyeja e këtij detyrimi për avokatët do të duhej të ishte që në rast të gabimeve profesionale, avokati ta ketë mbulesën siguruese për dëmet e shkaktuara ndaj klientëve të tij.

Ndërkohë që ekziston edhe mundësia e ‘acsio direkta’, që është e lejuar me Ligjin për marrëdhëniet e detyrimeve, ku i dëmtuari mund të zgjedhë ta padisë dëmtuesin, e jo siguruesin.

Neni 42, pika 1.1 parasheh që ushtrimi i avokatisë ndërpritet në rastin kur kundër avokatit është iniciuar procedurë penale për vepër penale, e cila, sipas natyrës, është e atillë që e bën të padenjë për ushtrimin e avokatisë.

Një dispozitë e tillë është në kundërshtim me dispozitën 31.5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, pasi çdokush i akuzuar për vepër penale prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij, apo e saj, në pajtim me ligjin.

Ky shqetësim rrjedh gjithmonë duke pasur parasysh faktin që deri në plotfuqishmërinë e aktgjyqimit të gjykatës kompetente i akuzuari është i pafajshëm, pastaj mund të vijmë në një situatë kur në përfundimin e procedurës penale, e cila mund të zgjasë me vite të tëra, avokati, ndaj të cilit është iniciuar procedura penale, shpallet i pafajshëm dhe me këtë rast Oda e Avokatëve të Kosovës do të jetë përgjegjëse që këtij avokati t’ia shpërblejë fitimin e munguar gjatë tërë këtyre viteve që i është ndërprerë ushtrimi i profesionit të avokatisë.

Sipas nenit 31.2, që ka të bëjë me Shoqërinë e Avokatëve, një shoqërie të avokatisë i lejohet që të punësojë vetëm avokat pa status të anëtarit të shoqërisë.

Sipas një interpretimi të thjeshtë të kësaj dispozite, rezulton se në një Shoqëri Avokatie mund të punësohen vetëm personat që e kanë titullin avokat dhe në të njëjtën kohë u mohon avokatëve themelues të shoqërisë të hyjnë në marrëdhënie kontraktuale të punës me shoqërinë që e ka themeluar.

Kjo dispozitë është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për shoqëri tregtare, që rregullon organizimin e një shërbimi me përgjegjësi të kufizuara, sepse po që se një shoqëri avokatie themelohet dhe organizohet si SHPK, atëherë pa marrë parasysh faktin që përgjegjësia e tyre është e kufizuar ndaj të drejtave dhe detyrimeve të shoqërisë, të njëjtave nuk u lejohet themelimi i marrëdhënies së punës në shoqërinë e tyre. Nga kjo rezulton se avokatët themelues të shoqërisë nuk do të trajtojnë çështje që kanë të bëjnë me ligjin, por duhet të merren vetëm me menaxhimin e saj.

Një çështje tjetër që duhet ngrehur është se në çfarë cilësie do të angazhohen avokatët në Avokaturën Shtetërore, ku sipas ligjit për të, avokatët do të emërohen në pajtim me dispozitat për emërimin për pozita të larta drejtuese në shërbimin civil të Kosovës, që domethënë se do të kenë një kontratë pune, e në të njëjtën kohë, sipas këtij draftligji, avokatët nuk kanë të drejtë që të jenë në marrëdhënie pune, përveç se në Shoqatën e Avokatëve. Faleminderit!

KRYETARI: Nuk kemi të lajmëruar më për diskutim. Atëherë shkojmë në procedurën e votimit. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Të pranishëm 63 deputetë, me kartela 90. Votojmë tash!

Me 53 vota për, 9 kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për Avokatinë.

Kërkohet nga Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin me rekomandime.

Vazhdojmë pikën e gjashtë të rendit të ditës:

6. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për shërbimin civil të Republikës së Kosovës

Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media e ka mbikëqyrur zbatimin e Ligjit numër 03/L-149 për shërbimin civil të Republikës së Kosovës dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

Raportuesja e Komisionit për arsyetimin e raportit me rekomandime, deputetja Xhevahire Izmaku e ka fjalën.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Duke u bazuar në nenin 73 të Rregullores së Kuvendit të Kosovës, Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media i Kuvendit të Kosovës ka kompetencë ta mbikëqyrë zbatimin e ligjeve.

Komisioni ynë i ka kryer obligimet e parapara me këtë rregullore, duke e monitoruar zbatimin e Ligjit për shërbimin civil në Republikën e Kosovës.

Qëllimi i monitorimit të zbatimit të Ligjit për shërbimin civil është vlerësimi i zbatueshmërisë së tij në praktikë.

Me anë të monitorimit është synuar që nga vizitat në institucionet të mblidhen të dhënat lidhur me zbatimin e këtij ligji, si dhe të vlerësohet nëse Qeveria, përkatësisht Ministria e Administratës Publike është duke i përmbushur obligimet që dalin nga ky ligj.

Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, në mbledhjen e mbajtur më 5 nëntor 2012, e formoi grupin punues, i cili në mënyrë të drejtpërdrejtë do të merrej me monitorimin e ligjit.

Në këtë rast do të përmend emrat dhe do të falënderoj kolegët e mi, Sadri Ferati, Teuta Haxhiu, Jeton Svirca, të cilët së bashku me koordinatorët e Komisionit e bënë të mundur që monitorimi të shkojë sipas procedurave.

Grupi punues, bazuar në autorizimet e tij, ka arritur me sukses t'i përmbyllë aktivitetet e planifikuara në monitorimin e zbatimit të Ligjit për shërbimin civil.

Gjatë periudhës nëntor-dhjetor 2012, grupi punues ka realizuar nëntë takime. Vizitat dhe takimet e grupit punues në terren janë përqendruar në këto institucione: Ministria e Administratës Publike, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Avokati i Popullit, Kuvendi Komunal Prishtinë, Kuvendi Komunal Vushtrri, Zyra Administrative në pjesën veriore të Mitrovicës dhe po ashtu në takimet e ndara me Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës dhe punëtori, të cilat janë zhvilluar, si punëtori njëditore më 20.11.2012, pastaj takime me OSBE-në, po ashtu edhe konsultimet që i kemi pasur me organizata dhe shoqëri civile.

Të arriturat që ne i kemi vërejtur si komision lidhur me zbatueshmërinë e Ligjit për shërbimin civil janë miratimi i Ligjit për shërbimin civil, i cili ka kontribuar në krijimin e një shërbimi civil profesional dhe të qëndrueshëm, duke e respektuar parimin e mundësive të barabarta për komunitete, si dhe parimin në baza gjinore.

Me Ligjin për shërbimin civil definohet qartë që merita dhe kompetenca janë parime themelore të regrutimit dhe avancimit të nëpunësive civilë.

Me Ligjin për shërbimin civil është përcaktuar nxjerrja e akteve nënligjore me të cilat në mënyrë të detajuar janë të përcaktuara rregullat, obligimet dhe përgjegjësitë e nëpunësve në shërbimin civil.

Ndërsa problemet, të cilat komisioni i ka vërejtur gjatë monitorimit janë këto në vazhdim:

Si problem kryesor në zbatimin e plotë të Ligjit për shërbimin civil është kolizioni i ligjeve dhe për këtë arsye Ministria e Administratës Publike, me strategjinë legislative të vitit 2013, e ka paraparë si prioritet plotësim-ndryshimin e këtij ligji.

Aktet nënligjore të nxjerra për zbatimin e këtij ligji nuk janë në përputhshmëri me Ligjin për shërbimin civil.

Gjithashtu lidhur me të dhënat rreth tejkalimit të të punësuarve në shërbimin civil, Ministria e ka nxjerrë rregulloren për nëpunësit civilë tepricë, e cila ka paraparë veprimet që do të ndërmerren ndaj institucionit në rastet kur nëpunësve civilë u shuhet vendi i tyre i punës.

Për shkak të disa paqartësive në dispozitat e Ligjit në fuqi, nga të cilat paqartësi dalin probleme dhe zbatueshmërinë e ligjit, mbi këtë bazë rrjedhin edhe ankesat e nëpunësit civilë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil. Pra, si pasojë e krejt këtyre është moszbatimi i vendimeve të këtij këshilli.

Problem tjetër është konfuzioni lidhur me ligjshmëritë e rregulloreve të nxjerra nga institucionet për shqyrtimin dhe miratimin e të cilave është kompetente Ministria e Administratës Publike.

Problem tjetër, sipas opinionit të Ministrisë së Administratës Publike, është se kjo ministri vlerëson që komunat nuk janë të obliguara të nxjerrin rregullore për organizimin, kompetencat dhe përgjegjësitë e komunave, pasi komunat nuk janë të obliguara të nxjerrin rregullore konform Ligjit për Administratën Shtetërore, si dhe rregullores për standardet e organizimit të brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Administratën Shtetërore.

Problem tjetër është mungesa e procedurave për zbatimin e programeve të veçanta për ngritjen e kapaciteteve dhe ngritjen në karrierë.

Problem tjetër është paqartësia lidhur me statusin e drejtorëve të shkollave, ngase Ligji për arsimin përcakton procedura ndryshe nga Ligji për shërbimin civil lidhur me procedimin e regrutimit të drejtorëve të shkollave. Për këtë arsye, DASHC i Ministrisë së Administratës Publike konsideron që drejtorët e shkollave të mos trajtohen sipas Ligjit për shërbimin civil.

Ndërsa sa u përket zjarrfikësve, statusi i tyre rregullohet sipas Ligjit për shërbimin civil.

Në vazhdim, do t'i them rekomandimet, të cilat janë të unifikuara në grupin tonë punues.

Pra, rekomandimet janë si në vijim:

1. Qeveria, Ministria e Administratës Publike t'i nxjerrë aktet nënligjore të parapara me Ligjin për shërbimin civil, veçanërisht në lidhje me mundësitë e barabarta për pranim në shërbimin civil;
2. Gjatë fazave të rekrutimit dhe avancimit në të gjitha pozitat të respektohet parimi i mosdiskriminimit dhe Ligjit për barazi gjinore;
3. Ministria e Administratës Publike t'i rishikojë të gjitha dosjet e të punësuarve dhe për këtë ta krijojë regjistrin qendrorë konform nenit 8 të Ligjit për shërbimin civil;
4. Të gjithë nëpunësve civilë në institucionet e nivelit lokal dhe qendror, të cilët i plotësojnë kushtet e përcaktuara me nenin 96 të Ligjit për shërbimin civil, t'u ofrohen shkresat për emërim konform ligjit;
5. Të formohen njësi për menaxhimin e personelit në nivelin lokal, aty ku ky proces nuk ka përfunduar akoma;
6. Rekrutimi i nëpunësve civilë nga radhët e komunitetit rom, egjiptian dhe ashkali të bëhet në pajtim me nenin 11, paragrafi 3 dhe 4 të Ligjit për shërbimin civil;
7. Qeveria në përputhje me nenin 13.3 të Ligjit për shërbimin civil t'i përcaktojë pozitat që nuk mund të plotësohen nga të huaj;

8. Institucionet e nivelit lokal dhe qendror t'i zbatojnë vendimet e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil.

Në këtë rast po e shfrytëzoj kohën që të flas edhe në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike. Ne i përkrahim rekomandimet dhe normalisht që e kemi vetëdijen që Administrata Publike në Kosovë ka nevojë që të ketë më shumë profesionalitet dhe ka nevojë të reformohet.

Mirëpo, do ta përmend edhe faktin që Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike është komod me faktin se kjo qeveri që nga themelimi nuk e ka lëvizur asnjë nëpunës civil, i cili ishte atakuar më parë nga qeveritë e tjera për arsye të qëndrimit të tij në ndonjë subjekt politik. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të LDK-së, deputeti Sadri Ferati e ka fjalën.

SADRI FERATI: Faleminderit, kryetar!

Edhe unë, përveç njohurive paraprake, isha pjesë e grupit gjatë të gjitha kontakteve dhe pjesë e votimit në komision. Unë pajtohem me të gjitha të gjeturat dhe të gjitha ato të gjetura dëshmojnë se ne në Kosovë kemi akoma shumë për të bërë për reformimin e Administratës. Dhe, njëkohësisht pajtohem me rekomandimet dhe propozoj që si të tilla të votohen.

Ndërsa veçanërisht duhet të ndalem te rekomandimi numër 8, që lidhet me zbatimin e vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil.

E kemi thënë sa herë në Parlament, e jemi të detyruar ta themi prapë, ngase nuk kemi rezultate. Edhe një herë bëj thirrje që, përveç votimit në rekomandim, që ka mund edhe të mos jetë, sepse ai është një detyrim.

E kemi një numër të madh të shërbyesve civilë, të cilët janë larguar nga puna. I kanë fituar të gjitha procedurat administrative, ka prej të tillëve që kanë ngrehur edhe procedura të veçanta nëpër gjykata dhe i kanë fituar ato lëndë, por ata mbeten në shtëpi, e dikush i jep vetes të drejtë që të mos i kthen nëpër vendet e punës, gjë që vërtet është tepër e dëmshme. Për këtë arsye ne në komision kemi dhënë iniciativë që të fillohet me draftimin e ligjit, me të cilin do të parashikohen sanksione konkrete për individët dhe institucione që nuk i zbatojnë këto vendime.

Ndërsa për sot, edhe një herë e përsëndes punën e grupit dhe të komisionit, dhe jemi të pajtimit si grup që t'i votojmë të gjeturat dhe rekomandimet. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të "Vetëvendosjes", deputeti Afrim Kasolli.

AFRIM KASOLLI: Faleminderit, i nderuar kryetar!
Të nderuar deputetë,

Edhe Lëvizja “Vetëvendosje” e ka shqyrtuar raportin për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për shërbimin civil, të përgatitur nga komisioni përgjegjës parlamentar, dhe si e tillë kjo lëvizje pajtohet me këto rekomandime që dalin nga ky raport.

Natyrisht, Lëvizja “Vetëvendosje” konsideron se ky raport nuk arrin aq sa duhet që t’i përfshijë disa nga sfidat tjera themelore me të cilat përballet aktualisht sfera e shërbimit civil. Për këtë arsye, ne konsiderojmë që të jetë pasqyra sa më e qartë, ky raport është dashur të jetë më gjithëpërfshirës. Mirëpo, i pranojmë edhe këto rekomandime. Bie fjala, ndër sfidat kryesore që përmenden në sferën e shërbimit civil është kolizioni i ligjeve. Po ashtu, sfidë tjetër përmendet se aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji nuk janë në përputhshmëri me Ligjin për shërbimin civil.

Prandaj, nëse qëndrojnë këto dy konstatime, atëherë situata është shumë e thjeshtë. Dihet se ligjet i miraton Kuvendi, natyrisht të sponsoruara nga Qeveria, kurse aktet nënligjore nxirren nga Qeveria, përkatësisht ministritë përkatëse që mbulojnë sfera të caktuara.

Logjikisht, kjo shpërputhje ndërmjet këtyre dy sferave i bie që Qeveria, përkatësisht ministritë e caktuara e shkelin ligjin në mënyrë shumë të sofistikuar nëpërmjet akteve nënligjore, të cilat i nxjerrin, e që janë në kundërshtim me parimet bazike të ligjit.

Si sfidë tjetër përmendet fakti se për shkak të disa paqartësive në dispozitat e ligjit në fuqi, nga të cilat dalin paqartësi, dalin probleme në zbatueshmërinë e ligjit. Mbi këtë bazë rrjedhin edhe ankesat e nëpunësve civilë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil dhe pasoj e kësaj është moszbatimi i vendimeve të kështillit.

Mirëpo, ky formulim si i tillë qëndron një kontradiktë me një formulim tjetër të këtij dokumenti, i cili thotë se miratimi i Ligjit për shërbimin civil ka kontribuar në krijimin e një shërbimi civil profesional dhe të qëndrueshëm, duke e respektuar parimin e mundësive të barabarta për komunitete, si dhe parimin e baza gjinore.

Me Ligjin për shërbimin civil, në këtë raport thuhet se definohet qartë që merita dhe kompetenca janë parime themelore të rekrutimit dhe avancimit të nëpunësve civilë.

Pra, nëse me ligj definohet qartë meritokracia dhe avancimi si attribute të këtij segmenti të organizimit të Administratës, atëherë si është e mundur që dispozitat e ligjit të jenë të paqarta, sepse, në fund të fundit, ligji nuk është ndonjë entitet i veçantë, i shkëputur nga dispozitat ligjore, por vetë dispozitat ligjore e përbëjnë ligjin në tërësi dhe nuk ka mundësi që ligji të jetë i qartë, kurse dispozitat ligjore të jenë të paqarta në këtë segment.

Problem tjetër kryesor përmendet mungesa e procedurave për zbatimin e programeve të veçanta për ngritjen e kapaciteteve dhe ngritjen në karrierë. Me të vërtetë, që nga miratimi i Ligjit për shërbimin civil, Qeveria ka miratuar një numër aktesh nënligjore, që lidhen me performansën dhe promovimin e nëpunësve civilë.

Problem kryesor në këtë dimension mbetet pikërisht karakteri i këtyre rregulloreve, i cili shpeshherë krijon bazën për vlerësime subjektive dhe krijon mundësinë e interferimeve politike në vlerësimet për shërbimin civil.

Unë tash nuk do të ju marrë kohë deputetëve që t'i përmend të gjitha këto rregullore, që e krijojnë këtë kolizion. Mirëpo, këto rregullore si të tilla e krijojnë bazën që të rrezikohet objektiviteti i procesit dhe mundësinë për subjektivizëm dhe për mundësinë për dominim politik mbi Administratën Shtetërore, kryesisht mbi shërbimin civil. Dhe, kjo është arsye e cila ka ndikuar për kundërthënie ndërmjet institucioneve shtetërore dhe Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës Civil, ku gjatë gjithë kohës thuajse janë injoruar dhe nuk janë zbatuar vendimet e këtij këshilli, kur kanë vendosur në favor të atyre palëve, të cilat janë ankuar.

Por, në tërësi, ne do t'i përkrahim këto rekomandime që dalin nga ky raport. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Aleancës, deputetja Time Kadriaj.

TIME KADRIAJ: Faleminderit, kryetar!

Edhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës e ka shqyrtuar këtë raport të monitorimit dhe gjatë shqyrtimit ka hasur se nuk janë përfshirë të gjitha të gjeturat në raport nga vizitat monitoruese nëpër ministritë përkatëse, por edhe nëpër komuna të caktuar dhe në fakt nëse nuk janë përfshirë të gjitha të gjeturat, edhe rekomandimet janë të mangëta.

Problem, siç e cekën edhe kolegët e tjerë, janë kolizioni ndërmjet ligjeve përkatëse, e këtë e kemi te Ligji i shërbimit civil dhe ligjet tjera dhe udhëheqjet në këto raste nuk i kanë zbatuar vendimet e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, duke u bazuar mu në këtë kolizion dhe në këtë rast i kanë interpretuar ligjet ashtu siç kanë pasur dëshirë dhe ashtu siç u kanë konvnuar.

E kemi rastin e zgjedhjes së drejtorëve në Qendrën Klinike Universitare, ku konkursi është hapur dhe është anuluar prapë për shkak të parregullsive gjatë hapjes së tij për drejtorë të klinikave. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës e ka anuluar këtë konkurs dhe ka dhënë vendim që brenda një afati të shkurtër kohor të rihapet konkursi, mirëpo kjo nuk është respektuar nga ministria përkatëse.

Andaj, rekomandojmë që në të ardhmen të respektohen edhe vendimet e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës. Në fakt, edhe pse të mangëta, ne do t'i përkrahim këto rekomandime nga komisioni.

KRYETARI: Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, deputeti Jeton Svirca.

JETON SVIRCA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Koalicioni për Kosovë të re e ka shqyrtuar këtë raport të Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media dhe personalisht kam qenë edhe pjesë e grupit, i cili ka bërë monitorimin e këtij ligji.

Qëllimi ka qenë që të bëhet një vlerësim për vetë ligjin, për zbatimin e tij, për vlerësimin e përmbushjes së obligimeve që duhet t'i bëjë ministria për nxjerrjen dhe zbatimin e akteve nënligjore dhe të tjera.

Ne gjatë punës sonë kemi vërejtur një varg problemesh. Ndër to po cek disa, siç janë ato aktet nënligjore të nxjerra, të cilat nuk janë në përputhshmëri me Ligjin për shërbimin civil, ka paqartësi ndërmjet dispozitave të ligjit dhe si rrjedhojë ka probleme në zbatimin e tij.

Ka paqartësi gjithashtu edhe lidhur me statusin e drejtorëve të shkollave, ku në Ligjin për arsim dhe Ligjin për shërbyesit civil parashihen procedura të ndryshe lidhur me rekrutimin e drejtorëve nëpër shkolla.

Ne si Koalicion për Kosovë të Re i përkrahim të gjitha rekomandimet e dala nga ky monitorim dhe me theks të veçantë duke kërkuar nga ministria që t'i marrë parasysh të gjitha rekomandimet gjatë plotësimit-ndryshimit të ligjit, të cilën e presim këtë vit të vijë për shqyrtim në Kuvend. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! I kemi 67 deputetë të pranishëm. Diskutime tjera nuk kemi, shkojmë në votim. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatoj se me 62 vota për, 2 kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi raportin me rekomandime të Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit numër 03/L-149 për shërbimin civil të Republikës së Kosovës.

Mirupafshim në seancën e radhës!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*